



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Raport Auditimi Performance

“Mbrojtja e vlerave dhe pasurive të vendit tonë në UNESCO”

TIRANË 2025

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje.....	4
2. Problemi social dhe rëndësia e auditimit	7
2.1 Konteksti i Problemit Social.....	7
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës	8
3. Subjektet në auditim.....	9
3.1 Hyrje në subjektet në auditim	9
3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen në auditim.....	15
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	18
3.4 Peshat në buxhet.....	19
3.5 Përkufizimet dhe terminologjia	21
3.6 Feedback-u i subjekteve në fazën e terrenit	22
4. Detajet e auditimit.....	23
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve.....	23
4.2 Objektivat e auditimit.....	24
4.3 Pyetjet e auditimit	25
4.4 Fushëveprimi i auditimit	25
5. Shtjellimi i pyetjeve të auditimit.....	26
Pyetja kryesore - A sigurojnë institucionet përgjegjëse ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë me rëndësi universale?	26
Mesazhi i auditimit	26
5.1 A ekzistojnë mekanizmat e duhur për të ruajtur pasuritë kombëtare me rëndësi universale të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore?	27
5.1.1 A sigurojnë politikat ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore me rëndësi universale?	27
5.1.2 A kanë siguruar institucionet përgjegjëse mbështetjen e duhur dhe bashkëpunimin për ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë?	44
5.2 A janë marrë masa që synojnë përfshirjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s?	59
5.2.1 A janë marrë masat e duhura për përfshirjen në Listën e Trashëgimisë Botërore të pasurive që janë në Listën Tentative?	60
5.2.2 A janë hartuar listat e elementëve për përfshirjen e pasurive kombëtare kulturore në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s?.....	67
6. Aneks	74

Lista e Shkurtimeve

UNESCO	Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
IKTK	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
NJAKPA	Njësitë e Administrimit dhe të Koordinimit të Parqeve Arkeologjike
DRTK	Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore
KKTKM	Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale
KKR	Këshilli Kombëtar i Restaurimeve
SKK	Strategjia Kombëtare për Kulturën
LTB	Lista e Trashëgimisë Botërore (World Heritage List)
VJU	Vlerat e Jashtëzakonshme Universale (OUV - Outstanding Universal Value)
VNT	Vlerësim i Ndikimit në Trashëgimi (HIA - Heritage Impact Assessment)
QKVT	Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale
RKPK	Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore
KKTKJ	Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale
IKRTK	Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
DON	Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare
QTB	Qendra e Trashëgimisë Botërore
IMP	Plani i Menaxhimit të Integruar (Integrated Management Plan)
SRP	Strategic Recovery Plan

1. Përmbledhje

Auditimi me temë “Mbrotjtja e vlerave dhe pasurive të vendit tonë në UNESCO” ka patur si objektiv kryesor të vlerësojë masat e marra dhe efektivitetin e tyre në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore materiale dhe trashëgimisë kulturore jomateriale me vlera të jashtëzakonshme universale. Auditimi u zhvillua në institucionet përgjegjëse për administrimin, menaxhimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave dhe trashëgimisë kulturore të vendit tonë, konkretisht, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec. Periudha nën auditim ka qenë 2020-2024.

Vendi ynë duke njohur rëndësinë që ka ruajtja, mbrojtja apo konservimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore materiale dhe jo materiale me vlerë të jashtëzakonshme universale, si dhe duke marrë parasysh ndërvarësinë midis tyre si përmbledhëse të diversitetit kulturor, ka ratifikuar dy konventa ndërkombëtare:

1. *Konventa lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore*, e cila ka si objektiv ruajtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të klasifikuara si të një interesi të jashtëzakonshëm.
2. *Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale*, e cila ka si objektiv, ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe sensibilizimin në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe të vlerësimit të saj të ndërsjellë.

🚩 Shqipëria në Listën e Trashëgimisë Botërore (World Heritage List) përfaqësohet me 4 (katër) pasuri të regjistruara, të grupuara si vijon¹:

2 - Pasuri Kulturore

- Parku Kombëtar i Butrintit
- Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës

1 - Pasuri Natyrore

- Pyjet e lashta të Ahut, Rrajca dhe Lumi i Gashit

1 - Pasuri Mikse

- Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Liqenit të Ohrit

🚩 Në listën e Trashëgimisë Botërore Kulturore Jomateriale vendi ynë përfaqësohet me 5 (pesë) elementë:

- Iso-Polifonia
- Xhubleta
- Shtegtimi i bagëtive
- Kujtesa Botërore - Kodikët e Purpurt të Beratit
- “K’cimi i Tropojës”, **regjistruar në dhjetor 2024**².

Gjithashtu, vendi ynë ka të regjistruara në Listën Tentative të UNESCO-s 4 (katër) pasuri, ku 3 (tre) janë pasuri kulturore dhe 1 (një) është pasuri mikse (kulturore-natyrore):

- Kalaja e Bashtovës – 22.05.2017
- Qyteti Antik i Apollonisë – 03.04.2014
- Varret Ilire të Selcës – 11.10.1996

¹ <https://whc.unesco.org/en/statesparties/al>

² <https://meki.gov.al/>

- Amfiteatri i Durrësit – 11.10.1996

Ndërsa në listat përfaqësuese të Trashëgimisë Botërore Kulturore Jomateriale deri në muajin nëntor 2024 ishin 2 (dy) elementë:

- “K’cimi i Tropojës” (25 shtator 2023), **regjistruar në dhjetor 2024**.
- “Arti i të luajturit, të kënduarit dhe bërjes së lahutës” (28 mars 2024).

Për çdo vend është e rëndësishme që të regjistrojë pasuritë e tij kulturore/kulturore natyrore, vlerat, ritet etj., në listat e UNESCO-s, kjo pasi në momentin që një pasuri kulturore ose natyrore materiale ose jo materiale regjistrohet në Listën e Trashëgimisë Botërore, si fillim ndihmon në ndërgjegjësimin e institucioneve dhe të qytetarëve për rëndësinë që ka ruajtja e vlerave universale të kësaj trashëgimie kombëtare. Ndërgjegjësimi i strukturave shtetërore dhe i komunitetit, do të ndikonte në rritjen e përgjithshme të nivelit të mbrojtjes dhe ruajtjes së pasurisë. Gjithashtu, do të sillte një rritje të ndihmës financiare edhe nga organizmat ndërkombëtare. Ky zinxhir përfitimesh do të vijonte me një rritje të numrit të turistëve në këto rajone dhe me një rritje të ekonomisë së komunitetit përkatës. Të vlerësosh trashëgiminë me vlera të jashtëzakonshme universale nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e saj por, lidhet edhe me konservimin e kësaj trashëgimie për njohje nga brezat e ardhshëm me qëllim që ato ta njohin, të krenohen dhe ta mbrojnë atë.

Për sa më sipër ky auditim, u fokusua kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë për realizimin e objektivave të tyre institucionale dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në drejtim të vlerësimit të:

- masave të marra për të ruajtur pasuritë dhe vlerat kombëtare me rëndësi universale të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore;
- bashkëpunimit midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor në kuadër të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale;
- masave që synojnë përfshirjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore.

Në përfundim të auditimit disa nga problematikat kryesore që rezultuan paraqiten të përmbledhura në vijim.

Në vitin 2018 është miratuar ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, ku në nenet 263-277 përcaktohen të gjitha aktet nënligjore që duhet të miratohen në zbatim të tij, si dhe strukturat përkatëse propozuese apo miratuese të tyre. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si institucioni kryesor përgjegjës për trashëgiminë kulturore, **nuk ka hartuar apo propozuar për tu miratuar ende rreth 46% të akteve nënligjore edhe pse afatet kanë kaluar me 3 deri në 4 vite**. Gjithashtu, nuk evidentohet asnjë angazhim serioz nga kjo ministri për të nxitur edhe hallkat apo strukturat e tjera qendrore apo vendore për të përmbushur të gjitha kërkesat ligjore në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore. Mos miratimi i akteve nënligjore ka sjellë paqartësi dhe pengesa në realizimin e detyrave për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kombëtare me rëndësi universale nga institucionet përgjegjëse.

Në strukturën organizative të MEKI-t për periudhën objekt auditimi, **nuk ka një njësi apo sektor që të jetë përgjegjës për koordinim e të gjithë punës midis institucioneve në nivel qendror dhe nivel vendor**, që lidhet me hartimin e dokumentacionit të dosjeve të kandidimit deri në përcjelljen e tyre në UNESCO, për zbatimin e rekomandime, përkthimin e materialeve në mënyrë sa më profesionale, arkivimin e dosjeve etj. Institucionet përgjithësisht ngarkojnë me përgjegjësi njëri-tjetrin, lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve të konventave,

me dërgimin e informacionit pranë Komitetit në Gjuhën Shqipe ndërkohë që çdo material duhet të jetë i përkthyer në një nga gjuhët zyrtare Anglisht ose Frëngjisht, apo për mos zbatimin e rekomandimeve të lëna nga misionet e UNESCO-s.

Shtetet palë sikurse është dhe Shqipëria duhet të sigurojnë zbatimin e plotë dhe efektiv të këtyre masave të sugjeruara nga Komiteti, me qëllim mbrojtjen e pasurisë nga ndryshimet sociale, ekonomike dhe të tjera që mund të ndikojnë negativisht në vlerën e jashtëzakonshme universale, duke përfshirë integritetin dhe/ose autenticitetin e saj.

Me rëndësi të veçantë misionet e UNESCO-s kanë theksuar çdo vit në raportet e tyre për periudhën 2019-2024, që **çdo projekt që kryhet në sitet e trashëgimisë kulturore duhet të marrë më parë “Vlerësim të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)”**. Konkretisht, konstatohet se Shteti Shqiptar ka anashkaluar rekomandimin e misioneve të Komitetit për projektin infrastrukturor të **Bypass-it të Gjirokastrës i cili ka vijuar zbatimin pa bërë “Vlerësimin e Ndikimit në Trashëgimi”**. Për më tepër Shqipëria edhe pse nënshkruese e konventës për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore / kulturore natyrore jomateriale, nuk ka të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi detyrimin që çdo projekt që kryhet në sitet e trashëgimisë kulturore duhet të marrë më parë “Vlerësim të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)”, detyrim ky i përcaktuar në Udhëzuesin e UNESCO-s.

Lidhur me pasurinë natyrore kulturore të Liqenit të Ohrit, **Shqipëria në vijimësi ka shpërfillur rekomandimet e Komitetit të UNESCO-s**, ku duke filluar që nga viti 2019 theksohet se janë një sërë risqesh që duhet të adresohen me qëllim ruajtjen e Vlerave të Jashtëzakonshme Universale të Liqenit të Ohrit. Konkretisht, **projekti i Parkut Ujor Drilon – Tushemisht është konsideruar si i pa përshtatshëm nga Komiteti** dhe përsëri është miratuar pas disa ndryshimeve të vogla të cilat kanë qenë të pamjaftueshme dhe kanë dështuar në marrjen në konsideratë të Vlerave të Jashtëzakonshme Universale të Liqenit të Ohrit.

Çdo vit Komiteti publikon raportet për pasuritë e regjistruara në listat e trashëgimisë botërore duke lënë edhe rekomandimet që shteti palë duhet të zbatojë në zbatim të përcaktimeve të konventave dhe udhëzuesve. Konstatohet se, **MEKI nuk merr asnjë masë konkrete për të adresuar zbatimin e rekomandimeve që lënë misionet e UNESCO-s**, si dhe nuk ka informacion se çfarë bën apo duhet të bëjë secila strukturë. Bashkitë objekt auditimi përgjithësisht nuk kanë fare informacion lidhur me rekomandimet e UNESCO-s apo çështje të tjera që prekin pasuritë kulturore / kulturore natyrore në territorin e tyre.

Fondi Kombëtar i Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale që duhej të krijohet pranë MEKI-t në vitin 2019, është krijuar në vitin 2022 dhe MEKI nuk ka të dhëna lidhur me vlerën e zërave përbërës të Fondit. Në buxhetin e MEKI-t apo bashkive objekt auditimit për periudhën 2020 – 2024, **nuk rezultojnë të planifikuara fonde** për mbrojtjen e pasurive dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të regjistruara në UNESCO dhe pasurive në listën tentative.

Bazuar në përcaktimet e rregullave të UNESCO-s, që një pasuri të regjistrohet në Listat e Trashëgimisë Botërore duhet të kalojë në disa faza, duke filluar që me regjistrimin në Listën Tentative, përgatitjen e dosjes së nominimit etj. Regjistrimi i pasurive kulturore materiale kombëtare në Listën Tentative të UNESCO-s është një hap i rëndësishëm i procesit të regjistrimit në Listën e Trashëgimisë Botërore, por është vetëm fillimi. Sikurse theksohet më sipër Shqipëria ka 4 (katër) pasuri të regjistruara në Listën Tentative të UNESCO-s konkretisht, Varret Ilire të Selcës (1996), Amfiteatri i Durrësit (1996), Qyteti Antik i Apollonisë (2014) dhe Kalaja e Bashtovës (2017). Lidhur me këto pasuri **nuk rezultojnë të jetë marrë asnjë masë konkrete për plotësimin e kriterëve për regjistrimin në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s**, si dhe për asnjërën nuk ka filluar puna për përgatitjen e dosjes së nominimit edhe pse kanë kaluar vite dhe dekada që kur janë futur në listën tentative.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit / Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore **nuk ka hartuar “Listën e elementëve” me të cilët mund të kandidohet në Listat**

e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të UNESCO-s, listë e cila shërben si bazë që në bashkëpunim me ekspertët e fushës të hartohen dosjet e kandidimit. Gjithashtu, **Shqipëria nuk ka një listë/regjistr të pasurive kulturore dhe natyrore materiale të klasifikuara si të një interesi të jashtëzakonshëm.**

Në përfundim për të gjithë problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime specifike shoqëruar me afatet kohore konkrete për zbatimin e tyre.

2. Problemi social dhe rëndësia e auditimit

2.1 Konteksti i Problemit Social

Rëndësia e trashëgimisë kulturore është thelbësore për ruajtjen e identitetit dhe diversitetit kulturor të një shoqërie. Ajo përfshin traditat, zakonet, artin, arkitekturën dhe historinë e një populli, duke kontribuar në ndjenjën e përkatësisë dhe të vazhdimësisë ndër breza.

Në qoftë se flitet për trashëgimi kulturore shpesh kemi në mendje artefakte, monumente dhe ndërtesa historike, si dhe vendndodhje arkeologjike, kur në fakt koncepti i trashëgimisë kulturore është edhe më i gjerë se kaq dhe është zgjeruar gradualisht për të përfshirë dëshmi të krijimtarisë njerëzore si fotografi, dokumente, libra, instrumente dhe më shumë, qoftë si objekte individuale, qoftë si koleksione. Për më tepër, trashëgimia kulturore nuk kufizohet vetëm në objekte që ne mund t'i shohim dhe prekim. Ajo gjithashtu përbëhet nga elemente të paprekshëm si: traditat, historia gojore, artet skenike, muzika, polifonia, praktikat shoqërore, zanatet tradicionale, ritualet, njohuritë dhe aftësitë e përcjella nga një brez në tjetrin brenda një komuniteti. Sot, qytetet, peizazhet nënujore dhe mjedisi natyror konsiderohen gjithashtu pjesë e trashëgimisë kulturore/kulturore natyrore, pasi komunitetet e identifikojnë veten me rrethinën e tyre. Të gjitha kombet kontribuojnë në kulturën botërore. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të respektohet dhe të mbrohet e gjithë trashëgimia kulturore, përmes ligjeve vendore dhe traktateve ndërkombëtare.

Në një epokë globalizimi, trashëgimia kulturore na ndihmon të kujtojmë diversitetin tonë kulturor dhe të kuptuarit e saj zhvillon respektin reciprok dhe rivendosjen e dialogut midis kulturave të ndryshme. Trashëgimia kulturore ndihmon gjithashtu në promovimin e turizmit, duke tërhequr vizitorë që janë të interesuar të eksplorojnë kulturën dhe historinë e një vendi. Sidoqoftë, sot ballafaqohemi me kërcënime të ndryshme ndaj trashëgimisë kulturore/kulturore natyrore, përfshirë urbanizimin, globalizimin dhe ndryshimet klimatike, të cilat e bëjnë edhe më të rëndësishme përpjekjen për ta mbrojtur dhe promovuar atë. Kjo është një përgjegjësi e përbashkët e individëve, komuniteteve dhe institucioneve.

Përsa më lartë, parë nga konteksti global, më 16 nëntor 1945 Kombet e Bashkuara themeluan Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO). Qëllimi i kësaj organizate është të kontribuojë për paqen dhe sigurinë në Botë duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar përmes arsimit, shkencës, dhe kulturës.

UNESCO, ka miratuar konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore për të promovuar mirëkuptimin ndërkulturor, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Për këtë qëllim, UNESCO ka krijuar Listën e Vendeve të Trashëgimisë Botërore dhe Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale.

Lista e parë i kushtohet mbrojtjes ligjore të zonave ose monumenteve që UNESCO-ja i konsideron me vlerë të jashtëzakonshme për njerëzimin, ndërsa lista e dytë mbron trashëgiminë jomateriale, si zakonet, muzikën, ritualet dhe të tjera.

UNESCO (Konventa e Parisit) bazohet në parimin e pasurisë botërore të njerëzimit si një e tërë, në bazë të të cilit ekzistojnë pjesë të pasurisë kulturore dhe natyrore, që për shkak të karakteristikave të tyre të jashtëzakonshme dhe domethënies që mbartin kanë një rëndësi të tillë që shtyn komunitetin ndërkombëtar të bashkëpunojë për të garantuar mbrojtjen dhe

ruajtjen në interes jo vetëm të shtetit palë të cilit i përkasin, por të të gjithë njerëzimit. Përmes nënshkrimit të kësaj konvente shtetet palë marrin përsipër jo vetëm të ruajnë sitet e pasurisë botërore që ndodhen në territorin e tyre, por edhe që të mbrojnë pasurinë kombëtare.

Termi trashëgimi kulturore në thelb krijon konceptin e një shoqërie të vetme dhe komunikimin ndërmjet anëtarëve të saj, ku kufijtë kulturorë nuk përfundojnë tek kufijtë shtetërorë.

Shqipëria si një vend natyralisht i pasur, ku nga veriu në jug, gjen qytete historike, mrekulli natyrore dhe forma arti që bëjnë jehonë nga lashtësia është anëtarësuar në UNESCO, në 16 tetor 1985. UNESCO ndjek objektivat e saj nëpërmjet pesë programeve të mëdha: arsim, kulturë, shkenca natyrore, shkenca sociale dhe shkenca e njeriut, komunikimi dhe informacioni. Si një partner afatgjatë i UNESCO-s, Shqipëria është një mbështetëse e multilateralizmit efektiv duke ndarë synimet e UNESCO-s për promovimin e paqes dhe sigurisë përmes bashkëpunimit në katër fushat kryesore të Organizatës (Arsim, Shkencë, Kulturë, Informacion).

Shqipëria ndër vite është zgjedhur në organe të ndryshme të UNESCO-s. Gjithashtu, është anëtare e Grupit të Bashkuar të Miqve për Trashëgiminë, për barazinë gjinore, për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm përmes arsimit dhe sigurisë së gazetarëve.

Ne si një vend i vogël, krenohemi me gjashtë vende mbresëlënëse të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe një formë arti të lashtë me rëndësi të thellë si iso-polifoninë, e konsideruar si një kryevepër e Trashëgimisë Kulturore Orale dhe Jomateriale të Njerëzimit, konkretisht:.

Shqipëria është e pranishme në Listën e Trashëgimisë Botërore me Butrintin (1992) dhe Qendrat Historike të Gjirokastrës (2005) dhe Beratit (2008), me Pyjet e Lashta të Ahut (Rajca dhe Lumi i Gashit (2017), me Iso – polifoninë (2005) në Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, me Kodikët e Purpurt të Beratit në Kujtesën e Listës Botërore (2005); në Rezervat e Biosferës të Burimeve Njerëzore dhe Biosferës, Shqipëria ka regjistruar Prespën – Pellgun e Ohrit, si një rezervë ndërkufitare e biosferës (së bashku me Maqedoninë e Veriut); në Listën e Mbrotjtjes Urgjente në 2022 ka regjistruar mjeshtërinë e Xhubletës.

Në vitin 2019, Shqipëria u bashkua me Maqedoninë e Veriut për të regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore pjesën e territorit të saj të Liqenit të Ohrit, si pjesë e “Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Rajonit të Liqenit të Ohrit”.

Trashëgimia kulturore e trashëguar nga të parët tanë duhet të ruhet për të mirën e të gjithëve pasi ajo përfaqëson lidhjen tone me të shkuarën, tashmen dhe të ardhmen.

Trashëgimia kulturore e secilit vend del nga kultura, traditat, zakonet dhe historia e banorëve të atij vendi, prandaj duhet ruajtur dhe mbrojtur për gjeneratat e ardhshme. Përmes trashëgimisë kulturore, procesi historik i formimit dhe jetës së një populli shprehet dhe përfaqësohet, sepse është sinteza e dukshme dhe e prekshme e elementeve që e karakterizojnë atë. Përmes kësaj trashëgimie përforcohet identiteti rajonal ose kombëtar dhe ndjenja e përkatësisë ndaj një populli. Meqenëse trashëgimia kulturore është produkt dhe shprehje e krijimtarisë njerëzore, ajo transmetohet, rikrijohet dhe modifikohet duke kaluar nga brezi në brez, prandaj duhen bërë disa përpjekje të veçanta për të rivendosur ekuilibrin ndërmjet nevojave tona dhe mbrojtjes së këtij burimi.

2.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfytes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente

përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, nëpërmjet auditimit të performancës jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023 - 2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, si dhe në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, KLSH ka ndërmarrë këtë auditim performance duke e konsideruar mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare si të një rëndësie të veçantë për një shoqëri e cila vlerëson maksimalisht vlerat e saj kombëtare dhe i mbron ato, në veçanti në drejtim të identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transferimit të brezat e ardhshëm të pasurisë të konsideruar me vlera universale.

KLSH, nëpërmjet këtij auditimi, synon të paraqesë një pamje të qartë të veprimtarisë, procedurave dhe iniciativave të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe çfarë mekanizmash janë krijuar për të garantuar mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore në rëndësinë e trashëgimisë në botën aktuale të globalizmit, konflikteve, presioneve të zhvillimit dhe migrimit duke identifikuar mangësitë, shpërdorimet dhe shkeljet në përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e zyrtarëve publikë, dhe duke i shoqëruar ato me rekomandimet përkatëse.

3. Subjektet nën auditim


3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Auditimi i Performancës me temë “*Mbrojtja e vlerave dhe pasurive të vendit tonë në UNESCO*” u zhvillua në institucionet që kanë përgjegjësinë ligjore për administrimin, menaxhimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave dhe trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Sistemi kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore përfshin autoritetet shtetërore qendrore, autoritetet e vetëqeverisjes vendore, për pronat që ato kanë në pronësi dhe administrim, institucionet e specializuara, si dhe bashkësitë fetare të regjistruara me ligj³. Autoritetet përgjegjëse e kryejnë aktivitetin e tyre në përputhje me objektivat e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe me Strategjinë Kombëtare të Kulturës.

Konkretisht auditimi u shtri në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec.

³ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë, neni 26.

Skema e subjekteve nën auditim



Punoi: Grupi i auditimit

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të pasurive kulturore në përputhje me dispozitat ligjore. Këto funksione ushtrohen në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera shtetërore dhe privatët, në bazë të marrëveshjeve apo formave të bashkëpunimit, të parashikuara në ligj dhe në akte të tjera ligjore⁴.

Ministria ushtron funksionet e mbrojtjes për pasuritë kulturore në pronësi shtetërore edhe pse ato mund t'u jenë huazuar apo dhënë në përdorim subjekteve juridike të ndryshme nga ministria. Në ushtrim të këtij funksioni, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore monitoron dhe vlerëson periodikisht veprimet e subjekteve në administrim të pasurive kulturore dhe i rekomandon autoritetit kontraktues vazhdimin apo ndërprerjen e marrëdhënies juridike me subjektin privat apo publik. MEKI në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse, merr masa dhe krijon kushte lehtësuese për promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale jashtë kufijve të vendit, të grupeve apo bartësve popullorë, për pjesëmarrje në turne, festivale apo takime ndërkombëtare të kësaj fushe⁵.

Gjithashtu, MEKI ndërmerr nisma për njohjen në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale, si dhe për regjistrimin, ndryshimin e emërtesave të këtyre vlerave në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të propozimeve për regjistrimin e këtyre dukurive, mbështetur në kriteret e parashikuara nga konventa "Për ruajtjen e vlerave kulturore jomateriale"⁶.

⁴ Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", neni 12.

⁵ Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", neni 12.

⁶ Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", neni 17.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të jashtme, drejtimin politik të procesit të integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimin e dialogut politik me institucionet e Bashkimit Evropian, zhvillimin dhe fuqizimin e diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit⁷.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në disa fusha përgjegjësie shtetërore⁸ ku ndër të tjera, promovon dhe ndihmon në rritjen e zhvillimin e vlerave dhe të traditave më të mira shqiptare të bashkëkombësit jashtë kufijve shtetërorë.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, ka për mision gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore materiale në vendin tonë⁹.

IKTK-ja ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e vendit, në fushat e trashëgimisë kulturore materiale, të pasurisë e peizazhit natyror, si dhe të arkeologjisë parandaluese të shpëtimit nëntokësor dhe nënujor.

Në përmbushje të funksioneve të veta IKTK-ja bashkërendon punën me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Njësitë e Administrimit dhe të Koordinimit të Parqeve Arkeologjike, si dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore¹⁰.

IKTK funksionon si Sekretaria Teknike dhe Sporteli Unik për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe zbaton detyrimet që rrjedhin në kuadër të Konventës së Trashëgimisë Botërore për sitet e trashëgimisë botërore në Shqipëri.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, (Bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec) në fushën e kulturës ndër të tjera janë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve që lidhen me, zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve¹¹. Gjithashtu, duhet të organizojnë aktivitetet kulturore për promovimin e identitetit kombëtar e lokal. Duke iu referuar temës tonë të auditimit përveç përgjegjësisë së përgjithshme që kanë të gjitha NJQV-të, secila bashki objekt i auditimit tonë ka përgjegjësi dhe funksione specifike në menaxhimin, ruajtjen, promovimin etj., të vlerave dhe pasurive kombëtare që administrohen në territorin e tyre.

Konkretisht, NJQV-të në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore¹²:

- Bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- Kryejnë funksionet e ruajtjes e të mbrojtjes, të parashikuara në ligjin për trashëgiminë kulturore, të cilat nuk i përkasin pushtetit qendror, në bazë të marrëveshjeve specifike me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.
- Kryejnë funksionet administrative dhe të mbrojtjes së pasurive kulturore të peizazhit në bashkëpunim me pushtetin qendror, në zbatim të parashikimeve të ligjit për trashëgiminë kulturore, duke siguruar një qeverisje uniforme dhe të përshtatshme me synimet që kërkohen të arrihen.

⁷ <https://punetejashtme.gov.al/funksionet-dhe-detyrat-e-mepj/>

⁸ VKM nr.81, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”.

⁹ Rregullore e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të IKTK-së.

¹⁰ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, neni 29.

¹¹ Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 25.

¹² Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, neni 14.

Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025

Shqipëria ka një Strategji Kombëtare për Kulturën e cila mbulon periudhën 2019-2025. Strategjia Kombëtare për Kulturën është e përqendruar në pesë qëllime politike dhe objektiva strategjike që lidhen me, trashëgiminë materiale dhe jomateriale kulturore, me përfaqësimin e vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë në aktivitete ndërkombëtare, mbështetjen e veprimtarive kulturore dhe artistike, etj., konkretisht objektivat strategjike janë¹³:

1. Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit, krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës.
2. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore, rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara.
3. Nxitja, përfaqësimi dhe promovimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave më të mira.
4. Mbështetje e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike, rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, produkteve si dhe cilësisë artistike.
5. Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar, edukimi përmes kulturës.

Më konkretisht, në qëllimet dy dhe tre të SKK përcaktohen, zbatimi i projekteve të rijetëzimit të qendrave historike dhe qendrave muze, inventarizimi, katalogimi, digjitalizimi etj., i pasurive kulturore të luajtshme apo të paluajtshme, përfshirja e pasurive kombëtare kulturore në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Lista e pasurive kombëtare pjesë e UNESCO-s.

Në Listën e Trashëgimisë Botërore (World Heritage List) vendi ynë përfaqësohet me 4 (katër) pasuri të regjistruara, të grupuara si vijon¹⁴:

Pasuri Kulturore 2

- Parku Kombëtar i Butrintit (1992)
- Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës (2005, 2008)

Pasuri Natyrore 1

- Pyjet e lashta të Ahut, Rrajca dhe Lumi i Gashit (2017)

Pasuri Mikse 1

- Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Liqenit të Ohrit (2019)

1. Parku Kombëtar i Butrintit, Vlerat e Jashtëzakonshme Universale

Parku Kombëtar i Butrintit¹⁵ është një mikrokozmos i historisë mesdhetare, me pushtim që në dëshmitë më të hershme daton nga 50,000 vjet para Krishtit, deri në shekullin e 19-të pas Krishtit. Vende prehistorike janë identifikuar brenda bërthamës së Butrintit, kodrës së vogël të rrethuar nga ujërat e liqenit të Butrintit dhe Kanalit të Vivarit, si dhe në territorin e tij më të gjerë. Në shekullin e V pas Krishtit, Butrinti u bë qendër peshkopale, ishte fortifikuar dhe u ndërtuan struktura të konsiderueshme të hershme të krishtera. Pas një periudhe braktisjeje, Butrinti u rindërtua nën kontrollin bizantin në shekullin e IX. Butrinti dhe territori i tij ranë nën kontrollin e Anzhuinës dhe më pas të Venedikut në shekullin e 14-të. Në fillim të shekullit XIX sistemit mbrojtës të Butrintit iu shtua një kala e re në grykëderdhjen e Kanalit të Vivarit.

¹³ Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025.

¹⁴ <https://whc.unesco.org/en/statesparties/al>

¹⁵ <https://whc.unesco.org/en/list/570>

Parku Kombëtar i Butrintit¹⁶ është një nga zonat më të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore, arkeologjike, mjedisore dhe turistike të vendit. Zemra e Parkut Kombëtar është qyteti Antik i Butrintit, ekzistenca e të cilit vazhdoi pa ndërprerje, që prej periudhës së prehistorisë e deri në mesjetë, duke ofruar kështu një shumëllojshmëri kulturash dhe periudhash historike. Në saj të vlerave të larta historiko-kulturore qyteti antik i Butrintit u përzgjedh fillimisht si Monument Kulture në vitin 1948, në ligjin e monumenteve të Kulturës së Shqipërisë. Në vitin 1992 Butrinti u pranua si vendbanimi i parë arkeologjik i Republikës së Shqipërisë në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Në korrik të vitit 1999 Ministria e Kulturës aplikon në UNESCO për zgjerimin e sipërfaqes së sitit, i cili miratohet në fund të vitit nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore ku përfshihet dhe gjiri i Butrintit. Në vitin 2000 Butrinti shpallet Park Kombëtar në mbrojtje të shtetit të zonës arkeologjike të Butrintit dhe UNESCO zyrtarisht zgjeroi sipërfaqen nga 20 ha që kishte qenë më parë në 29 km². Emërtimi si Park Kombëtar u bë me qëllim për mbrojtjen dhe konservimin e monumenteve historike dhe trashëgiminë e pasur mjedisore. Me ngritjen e Parkut Kombëtar, në vitin 2000, UNESCO siguroi fonde për zhvillimin e programeve për komunitetet e zonës, Banka Botërore mbështeti me një financim thelbësor zhvillimin institucional të Parkut etj. Në nëntor të viti 2005 Këshilli i Ministrave vendosi zgjerimin e Parkut Kombëtar të Butrintit në 86 km².

3. Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës

Qendra historike e Beratit¹⁷ u regjistrua në Listën e UNESCO-s në korrik të vitit 2008, duke u vlerësuar si një shembull i rrallë i arkitekturës tipike Osmane. Berati, është dëshmitar i bashkëjetesës së komuniteteve të ndryshme fetare dhe kulturore përgjatë shekujve. Qendra historike përmban një kala, pjesa më e madhe e së cilës është ndërtuar në shekullin e 13-të, megjithëse origjina e saj daton në shekullin e IV para Krishtit. Zona e kalasë numëron shumë kisha bizantine, kryesisht nga shekulli i 13-të, si dhe disa xhami të ndërtuara nën epokën osmane që filloi në 1417¹⁸.

Qendra historike e Gjirokastrës¹⁹ u regjistrua në Listën e UNESCO-s në korrik të vitit 2005, ajo përmban një sërë shtëpish të jashtëzakonshme dykatëshe të cilat u ndërtuan në shekullin e 17-të. Qyteti ruan gjithashtu një pazar, një xhami të shekullit të 18-të dhe dy kisha të së njëjtës periudhë.

Berati dhe Gjirokastra²⁰ janë një dëshmi e shquar e diversitetit të shoqërive urbane në Ballkan, dhe të jetëgjatësisë së mënyrave të jetës të cilat sot pothuajse janë zhdukur. Berati dhe Gjirokastra janë dëshmi e jashtëzakonshme për llojet e ndryshme të monumenteve dhe banesave popullore urbane gjatë periudhës Klasike Osmane, në vazhdimësi me kulturat Mesjetare që e paraprinë atë.

4. Pyjet e lashta të Ahut në Rrajcë dhe Lumin e Gashit²¹

Kjo pronë transnacionale përfshin 93 pjesë përbërëse në 18 vende. Që nga fundi i Epokës së fundit të Akullnajave, Ahu Evropian u përhap nga disa zona të izoluara strehimi në Alpe, Karpate, Dinaride, Mesdhe dhe Pirenej gjatë një periudhe të shkurtër prej disa mijëra vjetësh në një proces që është ende në vazhdim. Pas Epokës së fundit të Akullnajave, rreth 11,000 vjet më parë, ah u filloi të zgjeronte gamën e saj nga këto zona strehimi jugore për të mbuluar përfundimisht pjesë të mëdha të kontinentit evropian. Gjatë këtij procesi të zgjerimit, i cili është ende në vazhdim, ahu formoi lloje të ndryshme të bashkësive bimore duke zënë mjedise kryesisht të ndryshme. Këto pyje përmbajnë një popullatë të paçmuar pemësh të vjetra dhe një

¹⁶ <https://butrint.al/>

¹⁷ <https://bashkiaberat.gov.al/berati-ne-unesco/>

¹⁸ <https://whc.unesco.org/en/list/569>

¹⁹ <https://whc.unesco.org/en/list/569>

²⁰ <https://whc.unesco.org/en/list/569>

²¹ <https://whc.unesco.org/en/list/1133>

rezervuar gjenetik të ahut dhe shumë specieve të tjera, të cilat janë të lidhura dhe varen nga këto habitate pyjore të vjetra.

Pyjet e lashta të ahut në Rrajcë, përfshin pyjet e ahut të lumit të Gashit në Parkun Kombëtar të Luginës së Valbonës dhe Rajcës në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Ato formojnë një seksion integral të lokacionit të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s të Pyjeve të Lashtë dhe primare të Ahut të Karpateve për shkak të vlerës së tyre të jashtëzakonshme natyraliste dhe biodiversitetit të larmishëm.

5. *Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit*²²

Liqeni i Ohrit ofron një strehë për lloje të shumta endemike të faunës dhe florës së ujërave të ëmbla që datojnë nga periudha terciare. Në ujërat e cekëta pranë brigjeve të liqenit, tre vende dëshmojnë për praninë e banesave parahistorike me pirgje, dhe Gadishulli i vogël i Linit është vendi i mbetjeve të një kishe të hershme të krishterë të themeluar në mesin e shekullit të 6-të. Rajoni i Liqenit të Ohrit, është një pronë e përzier e Trashëgimisë Botërore që mbulon 94,729 ha, u regjistrua për herë të parë për vlerat e ruajtjes së natyrës në vitin 1979 dhe për vlerat e trashëgimisë kulturore një vit më vonë. Këto mbishkrime kanë të bëjnë me pjesën e liqenit që ndodhet në Maqedoninë e Veriut. Prona u zgjerua për të përfshirë pjesën tjetër të Liqenit të Ohrit, që ndodhet në Shqipëri, në vitin 2019.

Si një liqen i thellë dhe i lashtë me origjinë tektonike, Liqeni i Ohrit ka ekzistuar vazhdimisht për rreth dy deri në tre milionë vjet. Ujërat e tij oligotrofikë ruajnë mbi 200 lloje bimësh dhe kafshësh unike për liqenin, duke përfshirë algat, krimbat e sheshtë turbelar, kërmijtë, krustacet dhe 17 lloje endemike peshqish, duke përfshirë dy lloje troftash, si dhe një jetë të pasur shpendësh.

Trashëgimia Kulturore Jomateriale²³

*Iso-Polifonia (2008)*²⁴, shqiptare karakterizohet nga këngët e përbërë nga dy pjesë solo, një melodi dhe një kundërmelodi, ndërtohet mbi parimin e këndimit të një apo disa zërave të ndryshëm solistikë, mbi një shtrat isoje të kënduar nga grup këngëtarësh. Struktura e pjesëve solo ndryshon sipas mënyrave të ndryshme të interpretimit, ka një larmi të madhe strukturash, veçanërisht në stilin popullor të adoptuar nga të gjitha grupet që performojnë këtë muzikë. Gjatë dekadave të fundit, rritja modeste e turizmit kulturor dhe interesi në rritje i komunitetit studiues për këtë traditë unike popullore kanë kontribuar në ringjalljen e iso-polifonisë shqiptare. Megjithatë, tradita ndikohet negativisht nga mungesa e mbrojtjes ligjore dhe mungesa e mbështetjes financiare për praktikuesit, duke kërcënuar transmetimin e repertorit të gjerë të këngëve dhe teknikave.

*Xhubleta (2022)*²⁵, është një veshje e punuar me dorë e veshur nga gratë dhe vajzat malësore në Shqipërinë e Veriut, e karakterizuar nga forma e ziles së valëzuar. Predominon ngjyra e zezë me motive të qëndisura shumëngjyrëshe. Procesi i përpunimit përfshin përgatitjen e shajakut, prerjen, qepjen dhe qëndisjen e figurave simbolike. Xhubleta dikur përdorej në jetën e përditshme që nga mosha e pubertetit, duke treguar statusin social dhe ekonomik të mbajtësit. Sot, pak gra posedojnë njohuri për të gjithë procesin dhe transmetimi tradicional i bazuar në familje është i rrallë. Megjithatë, veshja ka ruajtur domethënien e saj shoqërore dhe shpirtërore dhe ende konsiderohet pjesë përbërëse e identitetit malësor.

*Shtegtimi i bagëtive (2023)*²⁶ (Transhumance) i referohet lëvizjes sezonale të njerëzve me bagëtinë e tyre midis rajoneve gjeografike ose klimatike. Çdo vit, në pranverë dhe në vjeshtë, barinjtë burra dhe gra organizojnë lëvizjen e mijëra kafshëve përgjatë shtigjeve tradicionale

²² <https://whc.unesco.org/en/list/99>

²³ [https://ich.unesco.org/en/lists?text=&country\[\]=00003&multinational=3#tabs](https://ich.unesco.org/en/lists?text=&country[]=00003&multinational=3#tabs)

²⁴ <https://ich.unesco.org/en/RL/albanian-folk-iso-polyphony-00155>

²⁵ <https://ich.unesco.org/en/USL/xhubleta-skills-craftsmanship-and-forms-of-usage-01880>

²⁶ <https://ich.unesco.org/en/RL/transhumance-the-seasonal-droving-of-livestock-01964>

baritore. Kjo praktikë stërgjyshore, transhumance rrjedh nga një njohuri e thellë për mjedisin dhe përfshin praktika dhe rituale sociale që lidhen me kujdesin, mbarështimin dhe trajnimin e kafshëve dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Transhumance kontribuon kështu në përfshirjen sociale, duke forcuar identitetin kulturor dhe lidhjet ndërmjet familjeve, komuniteteve dhe territoreve, ndërkohë që kundërshton efektet e shpopullimit rural.

Kujtesa Botërore - Kodikët e Purpurt të Beratit (2005)²⁷.

Kodikët e Purpurt të Beratit janë dy Ungjij (kodikë) shumë të vjetër të gjetur në Berat “Beratinus 1”, që daton nga shekulli i gjashtë, dhe “Beratinus-2” nga shekulli i nëntë. Të dy janë pjesë e shtatë “Kodikëve të purpurt” që mbijetojnë sot. Dy nga “Kodikët e purpurt” ruhen në Shqipëri, dy në Itali dhe një në Francë, Angli dhe Greqi.

Lista tentative²⁸

Referuar Konventës për *Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore*, aktualisht vendi ynë ka të regjistruara në Listën Tentative të UNESCO-s 4 (katër) pasuri, përkatësisht:

*Varret Ilire të Selcës (1996)*²⁹ janë zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike të kryera në vitet 1964-1972, në një kodër ngjitur me fshatin Selcë në Mokër të Pogradecit. Ky habitat është projektuar gjatë periudhës së bronzit dhe ka vazhduar të jetë i tillë pa ndërprerje, edhe gjatë periudhës së hekurit.

*Amfiteatri i Durrësit (1996)*³⁰, është amfiteatri më i madh dhe më i rëndësishëm në Ballkan i ndërtuar në fillim të shekullit I-rë, i cili përmban vlera të shquara arkitekturore funksionale dhe konstruktive, i vetmi i këtij lloji i zbuluar në Shqipëri.

*Apollonia (2014)*³¹, përfaqëson një nga qytetet më të rëndësishme të botës mesdhetare dhe të pellgut të Adriatikut, i ruajtur në një gjendje jashtëzakonisht të paprekur. Qyteti u themelua nga kolonistët grekë nga Korfuzi dhe Korinti, të cilët gjetën në territorin e tij një vendbanim të mëparshëm lokal me elementet e veta unike kulturore.

*Kalaja e Bashtovës (2017)*³², është shumë e veçantë sepse nga ajo jo vetëm që kontrollohej bregdeti i Adriatikut të Shqipërisë qendrore, por edhe lugina e Lumit Shkumbin.

Referuar Konventës për “*Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale*”, vendi ynë ka të regjistruar në listat përfaqësuese të UNESCO-s 2 (dy) elementë të trashëgimisë kulturore jomateriale:

“*K’cimi i Tropojës*”³³ (K’cimi Dancing of Tropojë), propozuar për regjistrim në Listat Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit, më 25 shtator 2023, **regjistruar në dhjetor 2024**³⁴.

“*Arti i të luajturit, të kënduarit dhe bërjes së lahutës*”³⁵, propozuar për regjistrim në Listat e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Nevojë Urgjente për Ruajtje, më 28 mars 2024.

3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjektit lidhur me çështjen nën auditim që do të jetë burimi i kriterëve të auditimit.

²⁷ <https://www.unesco.org/en/memory-world/codex-purpureus-beratinus>

²⁸ <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/?action=listtentative&state=al&order=states>

²⁹ <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/909/>

³⁰ <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/910/>

³¹ <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/5885/>

³² <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/6259/>

³³ <https://ich.unesco.org/en/files-2024-under-process-01303>

³⁴ <https://meki.gov.al/>

³⁵ <https://ich.unesco.org/en/files-2025-under-process-01347>

Kriteret politike

- Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023.

Kriteret teknike

- Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”;
 - Ligji nr. 9490, datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e konventës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, Paris 2003”;
 - Ligji nr. 9613, datë 21.09.2006 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Larmisë së Shprehjeve të Kulturave”;
 - Ligji nr. 8523, datë 09.09.1999 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për mjetet e ndalimit dhe te parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore”.
-
- VKM nr. 364, datë 29.5.2019 “Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
 - VKM nr. 764, datë 20.12.2023 “Për deklarimin e Qendrës Historike të një zone në qytetin e Gjirokastrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”;
 - VKM nr. 827, datë 28.12.2023 “Për deklarimin e Qendrës Historike të një zone në qytetin-muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”;
 - VKM nr. 637, datë 15.11.2023 “Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme e zonës arkeologjike “a” të Gradishtës së Selcës, Bashkia Pogradec, miratimin e zonimit dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”;
 - VKM nr. 554, datë 18.06.2015 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj”;
 - VKM nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;
 - VKM nr. 399, datë 13.05.2020 “Për përcaktimin e kufijve të parkut arkeologjik Durrës”;
 - VKM nr. 329 datë 2.06.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 792, datë 07.10.2020, të KM “Për caktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategoritë e licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionin vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”;
 - VKM nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, i ndryshuar me VKM nr. 329, datë 02.06.2021;
 - VKM nr. 793, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kriterëve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”;
 - VKM nr. 831, datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit të menaxhimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit 2023-2030”;
 - VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 “Për projektimin, zbatimin e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre”;
 - VKM nr. 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”;

- VKM nr. 169, datë 20.02.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”;
- VKM nr. 560, datë 15.07.2020 “Procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje apo kolaudim në pasuritë kulturore”;
- VKM nr. 737, datë 17.09.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, e ndryshuar me VKM nr. 61, datë 26.1.2022;
- VKM nr. 464, datë 26.7.2023 për “Funksionimin, organizimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim”;
- VKM nr.81, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”;
- Etj.

Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Urdhër 179, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në Urdhrin 66, datë 7.4.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Kulturës”;
- Urdhër nr. 37, datë 19.02.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”;
- Raport Monitorimi Zbatimi i Planit të Integritetit të Ministrisë së Kulturës 2022³⁶.

Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- Rregullore e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të IKTK-së³⁷;
- Strategjia e Menaxhimit të Riskut - IKTK³⁸;
- Statuti i IKTK-së³⁹;
- Raporte vjetore të IKTK-së (vitet 2020 – 2023)⁴⁰;
- Plani i Menaxhimit të Zonës Arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit, miratuar me VKM nr. 831, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Zonës Arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit 2021-2028”⁴¹;
- Suplementi i Trashëgimisë Botërore i Planit të Menaxhimit për Peizazhin e Mbrojtur të Pogradecit 2017-2027⁴²;
- Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention;
- Report on the joint whc/icomos/iccrom reactive monitoring mission to the world heritage property “Historic centres of Berat and Gjirokastra”;
- Report on the ICOMOS Advisory mission to the Natural and Cultural Heritage of the Ohrid region;
- Plani i Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar Butrint miratuar me VKM nr. 583, datë 22.07.2020 botuar në Fletoren Zyrtare nr. 14, datë 03/08/2020;
- Plani i Menaxhimit të zonave arkeologjike A dhe B të Durrësit, miratuar me VKM nr. 831, datë 28.12.2023;
- Termat e Referencës për Planin e Menaxhimit të kalasë së Bashtovës, në përgatitje në kuadër të projektit EU4Culture financuar nga BE i cili zbatohet nga UNOPS Shqipëri në bashkëpunim me MEKI;

³⁶ <https://meki.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/RAPORT-MONITORIMI-NE-ZBATIM-TE-PI-PER-VITIN-2022.pdf>

³⁷ https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2021/05/Rregullore-IKTK_compressed.pdf

³⁸ <https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2023/09/7-Strategjia-e-Menaxhimit-te-Riskut-IKTK-2023.pdf>

³⁹ <https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2021/05/Statuti-IKTK.pdf>

⁴⁰ <https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2021/05/Raport-Vjetor-IKTK-2020.pdf>

<https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2024/04/Raport-vjetor-IKTK-2021.pdf>

<https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2023/11/Raport-vjetor-2022.pdf>

<https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2024/04/Raport-vjetor-IKTK-2023.pdf>

⁴¹ <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/28/831>

⁴² https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Suplementi_PM_Ohrit_shqip-final_10.8.2017-clear.pdf

- Drafti i Planit të Menaxhimit të Integruar të Qendrave Historike Berat dhe Gjirokastrë;
- Drafti i Planit të Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë për Kalanë e Bashtovës.
- Raportet e gjendjes së konservimit janë të publikuara në faqen zyrtare web të Konventës së Trashëgimisë Botërore, seksioni i pasurive kulturore:
 - o Qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë⁴³;
 - o Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit⁴⁴.

→ Raporte të hartuara nga Komitetet e mbikëqyrjes së Qendrës së Trashëgimisë Botërore:

- Raport i Misionit të përbashkët të Monitorimit Reaktiv Qendra e Përbashkët e Trashëgimisë Botërore / ICOMOS / IUCN për pasurinë e Trashëgimisë Botërore “*Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e rajonit të Ohrit*” (Maqedonia e Veriut / Shqipëria), 27 - 31 janar 2020⁴⁵.
- Raport i Misionit të përbashkët të Monitorimit Reaktiv Qendra e Përbashkët e Trashëgimisë Botërore / ICOMOS/ICCROM për pasurinë e trashëgimisë botërore “Qendra historike e Beratit dhe Gjirokastrës” 13 - 17 dhjetor 2021⁴⁶.

3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Trashëgimia kulturore është e lidhur me zhvillimin ekonomik, social kulturor të shoqërisë, vlerat dhe kërkesat e saj për integrimin drejt BE. Ajo si një dëshmi e qytetërimeve të së kaluarës, vetëm nëse mbrohet nga shteti dhe institucionet e tjera publike dhe private, do të ruhet në shekuj dhe do të vihet në shërbim të zhvillimit të shoqërisë dhe edukimit të brezit të ri me ndjenja kombëtare. Parimet në trashëgiminë kulturore duhet të bazohen në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, të politikave të qëndrueshme të zhvillimit të saj dhe sigurimin e qasjeve të barabarta të qytetarët për vlerat kulturore, duke respektuar:

- Trajtim të barabartë të tipologjive të ndryshme të trashëgimisë kulturore në rrjedhën e mbrojtjes së saj.
- Transparencë në menaxhimin e aktiviteteve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.
- Decentralizim të administrimit dhe financimit të veprimtarive, me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

E drejta për akses në trashëgiminë kulturore përbën një mundësi për të përdorur vlerat kulturore, duke siguruar akses fizik ose intelektual ndaj tyre, pa i dëmtuar apo ekspozuar ato ndaj çdo rreziku. Strukturat e qeverisjes qendrore e vendore dhe subjektet private duhet të krijojnë kushte për garantimin e aksesit të barabartë të publikut te vlerat kulturore.

Trashëgimia kulturore përfshin pasurinë kulturore materiale dhe jomateriale, si një tërësi vlerash kulturore, mbartëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar, që kanë rëndësi shkencore ose kulturore. Ruajtja e pasurive kulturore është proces sistematik i kërkimit, studimit, identifikimit, dokumentimit, regjistrimit, konservimit, restaurimit dhe përshtatjes.

Mbrojtja e pasurive kulturore realizohet nëpërmjet masave të ndërmarra, përfshirë iniciativat ligjore, të cilat synojnë harmonizimin e praktikave të vlefshme për sigurimin e ruajtjes së këtyre pasurive për shfrytëzim me interes publik.

Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit është institucioni përgjegjës, për realizimin e programit politik të qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në programin e Qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore ajo harton strategjinë kombëtare të kulturës, harton planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore, ndjek zbatimin e kontratave të rijetëzimit,

⁴³ <https://whc.unesco.org/en/list/569/documents/>

⁴⁴ <https://whc.unesco.org/en/list/99/documents/>

⁴⁵ <https://whc.unesco.org/en/list/99/documents/>

⁴⁶ <https://whc.unesco.org/en/list/569/documents/>

ushtron veprimtarinë e saj bazuar në legjislacionin përkatës për trashëgiminë kulturore, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore materiale si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e saj. Kjo ministri mbetet përgjegjëse dhe ruan rolin e saj kryesor në menaxhimin e trashëgimisë botërore të Shqipërisë, si dhe vepron si pika qendrore për raportimin në UNESCO.

MEKI nëpërmjet hartimit të politikave për të mbrojtur trashëgiminë kulturore materiale dhe jo materiale të vendit tonë jep kontributin e saj në konsolidimin e identitetit kulturor shqiptar në rang botëror, si një identitet i veçantë, i larmishëm që përfaqëson dhe karakterizon në totalitet vetëm kombin shqiptar dhe asnjë tjetër. Hartimi i këtyre politikave merr një rendësi të veçantë në këtë moment specifik historik në vendin tonë, pasi identiteti kulturor i vendit është ndërthurur në shekuj dhe vijon të ndërthuret me atë evropian. Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, misionin e saj MEKI e realizon në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qendrore publike që merren me mbrojtjen dhe menaxhimin e siteve arkeologjike apo kulturore.

IKTK, i cili është institucion kombëtar i specializuar shkencor, ka vlera si në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, ashtu edhe në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, në shërbim të planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunimi i ndërsjellë midis institucioneve politikbërëse dhe institucioneve vendore në territorin e të cilave ndodhet trashëgimia kulturore materiale apo jo materiale është thelbësor pasi nëpërmjet këtij bashkëpunimi garantohej mbrojtja dhe autenticiteti i identitetit kombëtar dhe kulturor të vendit tonë.

Angazhimi i përbashkët i këtyre institucioneve për të promovuar dhe për të sjellë në vëmendjen botërore objekte të tjera të trashëgimisë kulturore materiale apo jo materiale është shumë i rëndësishëm pasi pikërisht këto institucione kanë detyrimin që jo vetëm ti identifikojnë dhe ruajnë, por ato duhet të kërkojnë me ngulm njohjen dhe vlerësimin ndërkombëtar të vlerave të tyre.

Për këto arsye përgatitja e dokumentacionit për përfaqësim në UNESCO dhe njohje si trashëgimi me vlera universale, duhet të reflektojë shkallën më të lartë të vërtetësisë dhe teknikitetit të argumentimeve duke evidentuar kështu vlerën e shtuar që kultura shqiptare jep në rang botëror.

3.4 Pesha në buxhet

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është krijuar një fond me emërtimin “Bonusi i rijetëzimit”, pjesë e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale. Ky bonus është një nisëm e përvitshme e Ministrisë së Kulturës / Qeverisë Shqiptare për restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve në qendra historike në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin. Kjo nismë është një ndihmë në formë granti, për të gjithë ata individë që janë pronar të një objekti në qendrat historike të qyteteve dhe kanë iniciativën për ta zhvilluar më tej atë duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal.

Bonusi i rijetëzimit për periudhën 2022 – 2023 është përfituar nga individët që janë pronarë të objekteve në qendrat historike të Beratit, Gjirokastrës dhe Pogradecit, me qëllim restaurimin dhe jetëzimin e këtyre banesave. Ky bonus është përfituar i ndarë në tre faza, sipas përqindjeve 30% si parafinancim për fillimin e punimeve jo më vonë se 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës, 40% të vlerës së financimit me paraqitjen e situacionit që provon kryerjen e 70% të punimeve dhe 30% të vlerës së financimit me paraqitjen e situacionit që provon kryerjen 100% të punimeve. Plani i bonusit të rijetëzimit për periudhën 2022 – 2023 ka qenë në vlerën prej 100,000,000 lekë, nga të cilat realizimi faktik rezulton në vlerën 44,935,048 lekë.

Për periudhën 2023 – 2024 rezultojnë 28 persona përfitues me vlerë totale 99,758,079 lekë.

Për periudhën 2023 – 2024 ka qenë në vlerën prej 144,000,000 lekë, nga të cilat, realizimi faktik rezulton në vlerën 29,927,423 lekë, kjo pasi është paguar vetëm kësti i parë prej 30%.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

Viti	Llogaria	Vlera / lekë	Shënime
2020	230	190,174,800	Hartim Planesh Konservimi, hartim projektesh, hartim raportesh
2021	230	31,600,000	Hartim Planesh Konservimi, hartim projektesh, hartim raportesh
	231	4,981,953	Restaurime
2022	602	1,025,570	Plani i menaxhimit Berat, Gjirokastrë
2023	231	30,141,670	Projekte restaurimi

Viti 2022: Vlera totale prej **1,025,570** lekë e cilësuar si “Shpenzime nga sponsorizimet donacionet” pjesë e llogarisë 602 është detajuar duke përcaktuar përdorimin e këtij fondi.

Viti 2023: Vlera totale faktike prej **30,141,670** lekë e cilësuar si “Investime gjithsej” pjesë e llogarisë së investimeve 231 “Për Aktive Afatgjata materiale” është detajuar duke përcaktuar përdorimin e këtij fondi konkretisht si vijon:

1. Projekt restaurimi “Kisha e Ungjillëzimit në Kozare” në vlerën **6,691,621** lekë.
2. Projekt restaurimi “Shën Kolli Shelcan” (faza e parë) në vlerën **3,762,000** lekë.
3. Projekt restaurimi “Shën Mëhilli, Mingul” Lunxhëri, Gjirokastrë në vlerën **8,594,004** lekë.
4. Projekt restaurimi “Kisha e Shën Mërisë”, Barmash, Ersekë në vlerën **6,092,580** lekë.
5. Projekt restaurimi “Ura në fshatin Postenan” në vlerën **1,255,254** lekë.
6. Projekt konservimi dhe restaurimi i kullave dhe kurtinave midis tyre, Kalaja e Beratit (segmenti 12 – 12) në vlerën **3,746,211** lekë.

Bashkia Berat

Viti	Zëri	Vlera mijë lekë	Realizimi mijë lekë	Realizimi %	% ndaj vlerës totale të realizimit të buxhetit
2020	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	40,085	24,541	61%	3%
2021	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	45,646	23,680	52%	2.4%
2022	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	58,553	36,761	63%	3.6%
2023	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	57,036	46,905	82%	3.9%

Për vitin 2024 ka vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Turizmi, Kultura dhe Sportet” prej 101,566,920 lekë. Vlera totale e planifikimit të buxhetit për këtë vit rezulton 812,805,959 lekë. Zëri “Turizmi, Kultura dhe Sportet” përbëjnë 12.5% të vlerës totale të planifikimit buxhetor për vitin 2024.

Bashkia Gjirokastrë

Për periudhën 2020-2022 nga të dhënat që grupi i auditimit ka marrë nga Bashkia Gjirokastrë nuk është e mundur të identifikohet sa janë vlerat që lidhen me objektin tonë të auditimit.

Për vitin 2023 ka pasur vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Turizmi, trashëgimia, arti, kultura dhe sportet” prej 190,859,124 lekë, nga të cilat totali i realizimit ka rezultuar në vlerën prej 111,300,655 lekë. Përqindja e realizimit për këtë zë ka qenë në vlerën 58% krahasuar me planifikimin. Ndërkohë që vlera e realizimit faktik të buxhetit për këtë zë ndaj vlerës totale të realizimit të buxhetit, ka rezultuar në vlerën 9.6%.

Për vitin 2024 ka vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Turizmi, trashëgimia, arti, kultura dhe sportet” prej 73,847 mijë lekë. Vlera totale e planifikimit të buxhetit për këtë vit rezulton 809,275 mijë lekë. Zëri “Turizmi, trashëgimia, arti, kultura dhe sportet” përbëjnë 9.13% të vlerës totale të planifikimit buxhetor për vitin 2024.

Bashkia Pogradec

Bashkia Pogradec në planifikimin buxhetor të vitit 2024 ka vetëm një zë të buxhetit “Trashëgimia kulturore në fokusin e të rinjve” në vlerë prej 120,000 lekë. Vlera totale e planifikimit të buxhetit për vitin 2024 rezulton në vlerën prej 806,190,160 lekë. Zëri “Trashëgimia kulturore në fokusin e të rinjve” përbën vetëm 0.015% të vlerës totale të planifikuar të buxhetit vjetor.

Bashkia Durrës, Rrogozhinë, Fier, për vitet 2020 - 2024 nuk kanë fonde të planifikuara për vlerat dhe pasuritë e vendit tonë pjesë e Listës Tentative.

Në buxhetin e Bashkive Berat/ Gjirokastrë/ dhe Pogradec, për vitet 2020 – 2024, nuk ka pasur fonde të planifikuara për vlerat dhe pasuritë pjesë e trashëgimisë kulturore të regjistruara në UNESCO.

3.5 Përkufizimet dhe terminologjia

“*Katalogu Kombëtar i Pasurive Kulturore*” është baza e të dhënave shtetërore, që mbledh dhe administron, në nivel qendror, të dhënat mbi pasuritë kulturore kombëtare nëpërmjet Sistemit Informatik Kombëtar të Administrimit të Pasurive Kulturore.

“*Kryevlerë e trashëgimisë jomateriale*” është krijimi, praktika ose dukuria e trashëgimisë jomateriale, e cila, për karakteristikat e saj të veçanta, kombëtare dhe më gjerë, gëzon statusin e mbrojtjes ligjore nga ana e shtetit.

“*Listë kombëtare e kryevlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale*” është lista e veprave të trashëgimisë kulturore jomateriale që kanë status ruajtjeje të shpallur zyrtarisht nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore jomateriale, e cila krijohet, mbahet dhe përditësohet pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

“*Listë e kryevlerave të trashëgimisë jomateriale në rrezik*” është lista e veprave të trashëgimisë kulturore jomateriale që kanë nevojë urgjente për ruajtjen dhe transmetimin e tyre.

“*Bazë të dhënash shtetërore e pasurive kulturore*” është grumbullimi i organizuar i informacionit për të gjitha pasuritë kulturore kombëtare, në pronësi publike e private, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administruar.

“*Dëmtimi*” është tërësia e veprimeve, të qëllimta ose jo, në pasuritë kulturore, që cenojnë tërësinë ose elemente të veçanta të këtyre pasurive.

“*Mbrojtja*” është ndërmarrja e një sistemi masash me natyrë administrative, juridike, financiare dhe fizike, me qëllim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në interesin më të mirë të komunitetit.

“*Parandalim*” është tërësia e veprimeve për kufizimin e situatave të rrezikut, të lidhura me pasurinë kulturore në kontekstin e saj.

“*Pasuri kulturore materiale*” është tërësia e pasurive të luajtshme e të paluajtshme që kanë interes artistik, historik, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik, etnografik, arkivistik, bibliofilik, si dhe objekte të tjera, të përcaktuara ose parashikuara nga ligji si bartës të pasurive të qytetërimeve.

“*Pasuri kulturore jomateriale*” janë vlerat kulturore jomateriale, praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë, dijet, veglat, objektet, artefaktet e hapësirat kulturore që i krijojnë dhe bashkëshoqërojnë ato, të cilat, bashkësitë, grupet dhe individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Ato krijohen dhe përcillen brez pas brezi, të ndikuara nga mjedisi e historia, të cilat u japin atyre identitet dhe vazhdimësi biokulturore.

“*Pasuri peizazhi kulturor*” është pjesë territori, karakteri i të cilave është formuar nga veprimi i faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë, si dhe nga ndërveprimi i tyre, që kanë interes historik, kulturor, natyror, morfologjik dhe estetik.

“Regjistri kombëtar i pasurive kulturore” është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e çdo certifikate pasurie kulturore, të krijuara në letër dhe/ose në formë elektronike, në pronësi publike e private, materiale dhe jomateriale në Republikën e Shqipërisë. Përcakton qëndrueshmërinë në terma cilësorë dhe sasiorë të pasurive kulturore kombëtare, si dhe përgjegjësinë e institucioneve që i posedojnë për regjistrim e përditësim.

“Rijetëzimi” është dhënia në përdorim e pasurisë kulturore për funksione administrative e social-kulturore, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore.

“Ruajtja” është proces i vazhdueshëm, sistematik, i koordinuar dhe i programuar hulumtimi, studimi, kërkimi, dokumentimi, regjistrimi, parandalimi, mirëmbajtjeje, konservimi, restaurimi, përshtatjeje dhe vlerësimi të trashëgimisë kulturore.

“Ruajtje të trashëgimisë jomateriale” janë masat që synojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përfshirë këtu identifikimin, dokumentimin, kërkimin, ruajtjen, mbrojtjen, promovimin, vlerësimin, përcjelljen, nëpërmjet edukimit formal e joformal, si dhe rigjallërimin e aspekteve të ndryshme të kësaj trashëgimie.

“Trashëgimi kulturore” është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruan në të tashmen, për t’u përçarur brezave në të ardhmen si pjesë pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.

“Vlerë kulturore” është:

a) Dëshmi materiale e jomateriale e pranisë dhe veprimtarisë njerëzore, fenomene apo peizazhe, të cilat janë të rëndësishme për individin, komunitetin apo shoqërinë si një e tërë dhe kanë vlerë shkencore apo kulturore.

b) Dëshmi materiale ose jomateriale e pranisë dhe veprimtarisë njerëzore, e cila është domethënëse për institucionet fetare të regjistruara.

c) Fragmente të objekteve arkeologjike, etnografike apo objekteve të tjera, që janë të fragmentarizuara, të cilat përbëjnë një pjesë të vogël të autenticitetit të objektit origjinal, që janë dëmtuar në masë të madhe, pa ndonjë vlerë të rëndësishme kulturore, shkencore ose artistike, dhe pjesa më e madhe e tyre mund të përkufizohet si materiale. Këto nuk janë subjekt i identifikimit, por janë të tilla kur janë pjesë e fondeve muzeore.

“Vlerësimi” është ushtrimi i funksioneve dhe veprimtarive që kanë për qëllim promovimin e zhvillimin e trashëgimisë kulturore, si dhe krijimin e kushteve më të mira për përdorimin dhe gëzimin publik të saj. Në lidhje me peizazhin kulturor, vlerësimi përfshin, gjithashtu, rikualifikimin e objekteve të paluajtshme dhe të hapësirave të vendosura në mbrojtje, të dëmtuara ose degraduara.

“Lista tentative” është një inventar i siteve që gjenden në territorin e vendit të cilat Shqipëria i konsideron të përshtatshme për nominim në Listën e Trashëgimisë Botërore.

3.6 Feedback-u i subjekteve në fazën e terrenit

Në fazën e terrenit nga institucionet e përfshira në auditim të cilat merren me garantimin, monitorimin, menaxhimin e subjekteve monument kulture universale, janë hasur vështirësi në mbledhjen dhe përpunimin e dokumentacionit për arsye të shpërndarjes së gjerë të institucioneve, varësisë institucionale në nivel qendror e lokal, ndryshimit të ministrive përgjegjëse, etj. Nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, grupit të auditimit i janë krijuar kushtet bazë për realizimin e tij (*edhe pse janë hasur vështirësi dhe vonesa për shkak të kushteve tranzitore institucionale*), përgjithësisht komunikimi ka qenë i hapur. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, pyetësorëve të dërguar përgjithësisht ju është kthyer brenda afateve, si dhe janë shoqëruar me dokumentacion justifikues. Lidhur me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë, Pogradec grupi i

auditimit përgjithësisht ka hasur vështirësi dhe vonesa në marrjen e përgjigjeve dhe të dokumentacionit të kërkuar.

4. Detajet e auditimit

4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve

Risqet e aktivitetit të subjekteve janë ato risqe me të cilat përballen institucionet e audituara për realizimin e përgjegjësi të tyre që krijohen nga aktiviteti në tërësi duke u fokusuar në politikat, programet, proceset dhe strategjitë që ndjekin këto institucione për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale. Risqet e aktivitetit të subjekteve janë analizuar dhe evidentuar në tabelën në vijim.

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuara	Niveli i riskut	Pyetja e auditimit
Hartimi dhe zbatimi i kuadrit rregullator	Mund të mos ketë një mjedis të qëndrueshëm ligjor dhe institucional për ruajtjen, mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale.	Mungesa e kushteve juridike ndikojnë në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e fushës së kulturës, ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlera të jashtëzakonshme universale.	I mesëm	A sigurojnë politikat ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore me rëndësi universale?
Minimizimi i faktorëve dhe risqeve që ndikojnë që vlerat dhe pasuritë e regjistruara në UNESCO të kalojnë në listën e pasurive me rrisht	Institucionet përgjegjëse mund të mos vlerësojnë sa duhet marrjen e masave për të ulur apo eliminuar faktorët dhe risqet që cenojnë vlerat dhe pasuritë e regjistruara në UNESCO.	Ekspozimi i vlerave dhe pasurive të regjistruara në UNESCO ndaj risqeve dhe mos marrja e masave për zbutjen apo eliminimin e tyre cenon ruajtjen afatgjatë të vlerës së jashtëzakonshme universale dhe forcimin e qëndrueshmërisë së trashëgimisë.	I lartë	
Mbështetja buxhetore, efektiviteti dhe efica e shpenzimit të fondeve të adresuara për trashëgiminë dhe pasuritë kulturore	Fondet për të siguruar mbështetjen e politikave kombëtare të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore mund të mos jenë në nivelin e duhur.	Mungesa e burimeve të financimit, sjell pamundësinë e mbështetjes së politikës kombëtare për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore duke iu referuar drejtimeve kryesore si, ndërhyrjet emergjente për konsolidim, konservim, restaurim, rijetëzim apo dhe realizimin e projekteve.	I lartë	A kanë siguruar institucionet përgjegjëse mbështetjen e duhur dhe bashkëpunimin për ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë?
Bashkëpunim midis institucioneve qendrore dhe vendore	Në përfundim të procesit të decentralizimit dhe delegimit të një sërë kompetencash nga niveli qendror në nivelin vendor përfshirë edhe fushën	Mungesa e bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore, nëse nuk është e koordinuar dhe e programuar,	I lartë	

	e kulturës, trashëgimisë kulturore, mjedisit etj., bashkëpunimi midis institucioneve të niveleve të ndryshme mund të jetë jo efektiv.	cenon efektivitetin e masave që duhet të merren në zbatim të legjislacionit, që synojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale.		
Hartimi i listave tentative për përfaqësim me qëllim regjistrimin në Listën e Trashëgimisë Botërore	Institucionet përgjegjëse mund të mos kenë marrë masat e nevojshme për të hartuar listat me elementët e përfaqësimit në Listën e Trashëgimisë Botërore.	Pasuritë kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale nuk identifikohen, çka sjell humbje të rëndësishme dhe vlerave të tyre në aspektin e ruajtjes së identitetit dhe kulturës tonë.	I lartë	A janë marrë masat e duhura për përfshirjen në Listën e Trashëgimisë Botërore të pasurive që janë në Listën Tentative?
Hartimi i dosjeve të përfaqësimit	Dosjet e përfaqësimit mund të kenë mangësi apo mund të mos jenë të hartuara me qëllim që të justifikojnë vlerën e jashtëzakonshme universale, duke përfshirë integritetin dhe/ose vërtetësinë.	Mos identifikimi i listës së elementeve nga ekspertë të fushës, me të cilat paraqitet kandidatura e çdo pasurie kulturore kombëtare, me qëllim përfshirjen në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO, sjell mangësi në përgatitjen e dosjes së përfaqësimit.	I mesëm	A janë hartuar listat e elementëve për përfshirjen e pasurive kombëtare kulturore në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s?

4.2 Objektivat e auditimit


Auditimi me temë “*Mbrojtja e vlerave dhe pasurive të vendit tonë në UNESCO*” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e masave të marra dhe efektivitetin e tyre në funksion të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale, në interesin më të mirë të komunitetit.

Ky vlerësim u realizua duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë për realizimin e objektivave të tyre institucionale dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni. Në këtë mënyrë grupi i auditimit u përpoq të kryejë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv të institucioneve të përfshira në auditim në drejtim të:

- Vlerësimin të masave të marra për të ruajtur pasuritë kombëtare me rëndësi universale të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore.
- Vlerësimin e kuadrit rregullativ dhe harmonizimi midis akteve dhe planeve të ndryshme.
- Vlerësimin nëse është siguruar nga institucionet përgjegjëse mbështetja e duhur për ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë me rëndësi universale.
- Vlerësimin e bashkëpunimit midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor në kuadër të realizimit të qëllimit kryesor - ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale.
- Vlerësimin e masave që synojnë përfshirjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore.
- Vlerësimin të procesit të hartimit të dosjeve të përfaqësimit dhe dokumentacionit e hartuar me qëllim justifikimin e vlerës së jashtëzakonshme universale, duke përfshirë integritetin dhe/ose vërtetësinë.

- Vlerësimi të minimizimit/eliminimit të faktorëve dhe risqeve që ndikojnë në pasuritë dhe vlerat e regjistruara në UNESCO që ato të mund të klasifikohen në listën e pasurive të rrezikuara.

4.3 Pyetjet e auditimit



4.4 Fushëveprimi i auditimit

Auditimi i Performancës me temë “Mbrotja e vlerave dhe pasurive të vendit tonë në UNESCO” u fokusua në efektivitetin e masave që janë marrë nga institucionet përgjegjëse lidhur me ruajtjen e pasurive kombëtare me rëndësi universale të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Gjithashtu, auditimi vlerësojë punën që është bërë me qëllim përfshirjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Auditimi u zhvillua në institucionet që kanë përgjegjësinë ligjore për administrimin, menaxhimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave dhe trashëgimisë kulturore të vendit tonë,

konkretisht, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec. Periudha nën auditim ishte janar 2020- nëntor 2024.

5. Shtjellimi i pyetjeve të auditimit

Pyetja kryesore - A sigurojnë institucionet përgjegjëse ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë me rëndësi universale?

Figura nr.1: Të dhëna mbi pasuritë e regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore



Mesazhi i auditimit


Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) nuk ka hartuar apo miratuar ende rreth 46% të akteve nënligjore në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, i miratuar që në vitin 2018. Projektet infrastrukturore që zhvillohen në sitet e trashëgimisë kulturore të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore nuk marrin “Vlerësim të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)” para miratimit edhe pse ky është një detyrim i përcaktuar në Udhëzuesin e UNESCO-s. Rekomandimet që lënë misionet e UNESCO-s, nuk merren në shqyrtim nga MEKI, si dhe nuk adresohen për ndjekje dhe zbatim në asnjë institucion publik. Për pasuritë e regjistruara në Listën Tentative duke filluar që nga viti 1996 e në vijim, nuk është marrë asnjë masë, si dhe nuk ka asnjë plan për regjistrimin e tyre në Listën e Trashëgimisë Botërore. Nuk janë hartuar listat e elementëve me të cilët mund të kandidohet në listat përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të UNESCO-s. Mbrojtja e pasurive kulturore të vendit tonë me rëndësi universale nuk mbështetet sa duhet me fonde buxhetore nga MEKI dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Për të siguruar një mbrojtje të pasurive kombëtare me rëndësi universale, si dhe për të mundësuar regjistrimin e pasurive dhe vlerave të reja në listat e UNESCO-s, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe institucionet përgjegjëse, duhet të zbatojnë detyrimet e Konventave dhe

Udhëzuesve, të angazhohen seriozisht në zbatimin e rekomandimeve të misioneve të UNESCO-s, si dhe të rrisin mbështetjen buxhetore dhe bashkëpunimin midis tyre.

5.1 A ekzistojnë mekanizmat e duhur për të ruajtur pasuritë kombëtare me rëndësi universale të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore?

Figura nr.2: Pasuritë e Shqipërisë të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore



Referuar konventës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore me qëllim që të sigurohet ruajtja, zhvillimi dhe prezantimi i trashëgimisë kulturore jomateriale, duhet të hartohet një politikë e përgjithshme, që të synojë vënien në pah të funksionit të trashëgimisë kulturore, të ngrihen një ose disa organizma kompetentë për ruajtjen e saj, si dhe të miratohen masat ligjore, teknike, administrative dhe financiare përkatëse. Gjithashtu çdo Shtet Palë në Konventë, për të garantuar marrjen e masave të vlefshme dhe aktive për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tij, duhet të përshtatë një politikë të përgjithshme e cila ka si synim ti japë trashëgimisë kulturore dhe natyrore një funksion në jetën e komunitetit; të ngrejë brenda territorit të tij, një ose më shumë shërbime për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me një staf të përshtatshëm dhe që ka mundësitë për të kryer funksionet e veta; dhe të përgatisë metoda operative të atilla që do ta bënë shtetin të aftë për t'iu kundër përgjigjur rreziqeve që kërcënojnë trashëgiminë e tij kulturore ose natyrore si dhe të marrë masat e duhura ligjore, shkencore, teknike, administrative dhe financiare të nevojshme për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin e kësaj trashëgimie.

5.1.1 A sigurojnë politikat ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore me rëndësi universale?

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka hartuar jashtë afateve apo nuk ka hartuar fare aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore. Gjithashtu, nuk janë marrë masa për zvogëlimin e faktorëve që ndikojnë në dëmtimin e pasurive pjesë e listave të trashëgimisë botërore.

Masat ligjore dhe rregullatore në nivel kombëtar dhe lokal duhet të sigurojnë mbrojtjen e pasurive kombëtare, pjesë e UNESCO nga ndryshimet sociale, ekonomike dhe të tjera që mund

të ndikojnë negativisht në vlerën e jashtëzakonshme universale, duke përfshirë integritetin dhe/ose autenticitetin e pronës, ku shtetet palë duhet gjithashtu të sigurojnë zbatimin e plotë dhe efektiv të këtyre masave⁴⁷.

Në këtë kontekst Shqipëria si shtet i cili ka nënshkruar dhe ratifikuar konventat në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale⁴⁸, ka parashikuar dhe shprehur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, (SKZHI) 2015 - 2020, drejtimit kryesor të politikës shtetërore në lidhje me Trashëgiminë Kulturore Materiale. Në këtë strategji përcaktohet se Ministria e Kulturës dhe institucionet e specializuara në varësi të saj janë përgjegjësitor kryesor për hartimin e politikave, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e realizimit të tyre. Në lidhje me zbatimin e SKZHI - së (2015 – 2020) me objektiva të njëjta me ato të saj, është hartuar dhe miratuar Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025.

Edhe në relacionin shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”, përshkruhen qëllimet e politikës, objektivat specifike përkatëse, masat dhe rezultatet për çdo objektiv, por nuk ka të përcaktuar ndonjë plan veprimi konkret, me institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe realizimin e tyre, referencën për programin buxhetor, afatet e zbatimit etj.

Kuadri strategjik institucional mbi të cilin ushtron aktivitetin Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe institucionet e saj të varësisë mbështetet në vizionin për artin dhe trashëgiminë kulturore të vendit, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror me mision krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat. Për realizimin e këtij misioni është miratuar ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë⁴⁹, si edhe disa akte nënligjore në zbatim të tij.

Gjatë auditimit konstatohet se një sërë aktesh nënligjore në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë janë hartuar dhe miratuar me vonesë apo ende nuk janë hartuar duke sjellë paqartësi dhe pengesa në realizimin e detyrave nga institucionet përgjegjëse, si p.sh. në rastin e Katalogut Kombëtar të Pasurive Kulturore, si dhe regjistrat kombëtarë të vlerave kulturore materiale e jomateriale nga IKRTK⁵⁰, ku kjo e fundit shprehet se janë ende në pritje të akteve nënligjore për vënien në funksion të tij⁵¹. Referuar ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, konstatohet se numri total i akteve plotësuese në funksion të tij është, gjithsej 109 akte dhe të miratuara (brenda dhe jashtë afateve të përcaktuara nga ky ligj) janë 59 akte, e shprehur në përqindje janë 54 %.

Në lidhje me sa më sipër ka patur një analizë të gjerë nga ku janë dhënë rekomandimet përkatëse edhe nga auditimet e mëparshme të performancës të realizuara nga KLSH për periudhën 2018-2022⁵², në Ministrinë e Kulturës apo institucionet e varësisë, ku konstatohet fakti që Strategjia Kombëtare e Ministrisë së Kulturës është miratuar për vitet 2019 - 2025, (derivat i SKZHI - së) dhe objektivat janë të njëjta me ato të SKZHI 2015 - 2020 i cili tregon për një mosrealizim dhe mos efektivitet të disa prej objektivave të tyre.

⁴⁷ Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention, pika 98, fq.33

⁴⁸ Ligji nr. 9490, datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e konventës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, Paris 2003”; Ligji nr. 9613, datë 21.09.2006 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Larmisë së Shprehjeve të Kulturave”; Ligji nr. 8523, datë 09.09.1999 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për mjetet e ndalimit dhe te parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore”.

⁴⁹ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

⁵⁰ Ligji 27/2018, Neni 56, pika 2.

⁵¹ Përgjigje e pyetësorit dërguar MEKI dhe IKTK, më 29.10.2024.

⁵² Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës “Mbrojtja dhe Administrimi i Monumenteve të Kulturës”, shtator 2022 dhe Raporti i KLSH-së, nr. 646/5 datë 30.04.2021, Vendimi nr.52 datë 26.04.2021 “Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016-2019”.

Ligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është kompleks, voluminoz dhe problematik në disa aspekte, dhe dikton nxjerrjen e një sërë aktesh nënligjore në funksion të zbatimit të objektivave dhe qëllimit të tij. Por, rezulton se edhe pse kanë kaluar rreth 6 (gjashtë) vjet nga miratimi i tij, institucionet përgjegjëse nuk kanë hartuar apo miratuar të gjitha aktet nënligjore në funksion të tij duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e punës dhe mosrealizimin e objektivave strategjik për zhvillimin e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Konkretisht, disa nga aktet nënligjore të cilat ende nuk janë hartuar dhe miratuar, kanë të bëjnë edhe me ruajtjen dhe zhvillimin e pasurisë kombëtare universale në UNESCO. Në përmbushje të Objektivave Strategjik për zhvillimin e artit dhe kulturës⁵³, duhet të hartohen Planet e Menaxhimit të pasurive të vendit tonë në UNESCO dhe të atyre në Tentative List. Rezulton⁵⁴ se me VKM nr. 583, datë 22.07.2020 botuar në Fletore Zyrtare nr. 14, datë 03.08.2020 është miratuar Plan i Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe Suplementi i Trashëgimisë Botërore i Planit të Menaxhimit për Peizazhin e Mbrojtur të Pogradecit 2017-2027. Ndërsa në lidhje qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë **është hartuar një draft plan menaxhimi por, ai është ende i pa miratuar.**

Përsa i përket tentativë listës janë miratuar:

- Plan i Menaxhimit të zonave arkeologjike A dhe B të Durrësit, miratuar me VKM nr. 831, datë 28.12.2023.
- Draft Plan i Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë për Kalanë e Bashtovës.
- Vendim nr. 637, datë 15.11.2023 “Për Deklarimin Pasuri Kulturore e Paluajtshme e Zonës Arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës, Bashkia Pogradec, miratimin e zoonimit dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”.

Planet e menaxhimit apo konservimit të përgatitura nga MEKI lidhur me pasuritë e qendrave historike kulturore si Berat, Gjirokastrë, Butrint, Pogradec, Ohër etj., janë miratuar me:

- Vendim Nr. 827, datë **28.12.2023** për deklarimin si pasuri kulturore e paluajtshme “qendër historike” të një zone në qytetin-muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj
- Vendim Nr. 764, datë **20.12.2023** për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme “qendër historike” të një zone në qytetin e Gjirokastrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj
- Vendim nr. 554, datë 18.6.2015 për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj.

Strukturat përgjegjëse për trashëgiminë kulturore

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e pasurive kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara të fushës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera shtetërore dhe privatët, në bazë të marrëveshjeve apo formave të bashkëpunimit, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

MEKI lidhur me trashëgiminë kulturore ka këto kompetenca⁵⁵:

- Harton Strategjinë Kombëtare të Kulturës;
- Propozon regjistrimin në Listën e Trashëgimisë Botërore të vlerave materiale dhe jomateriale të trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Deklaron “pasuri kulturore” dhe “thesare kombëtare” për vlerat kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme;
- Lëshon licenca për:

⁵³ Objektivi 1 i SKK 2019-2025 – Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës.

⁵⁴ Referuar përgjigjeve të pyetësorëve nga subjekti.


⁵⁵ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, neni 13.

- veprimtaritë arkeologjike në vend
- riprodhimin e vlerave kulturore
- subjektet private për projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim të punimeve të mbrojtjes e ruajtjes, sipas parashikimeve të këtij ligji, në objektet me pasuri kulturore pas deklarimit
- ekspert vlerësues të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme
- subjektet tregtare të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme.
- Harton planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore;
- Ndjek zbatimin e kontratave të rjetëzimit, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- Koordinon, organizon dhe mbikëqyr aktivitetet që lidhen me:
 - kthimin e vlerave kulturore të luajtshme “thesare kombëtare”, të eksportuara në mënyrë të paligjshme;
 - mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, lidhur me historinë shqiptare dhe kulturën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - monitorimin e vlerave të paluajtshme kulturore;
 - metodologjinë dhe përcaktimin e rregullave për ruajtjen e vlerave të paluajtshme kulturore dhe mjedisin e tyre.
- Ka përgjegjësinë e administrimit të pronave publike me vlera kulturore;
- Etj.

Gjithashtu, MEKI ndërmerr nisma për njohjen në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale, si dhe për regjistrimin, ndryshimin e emërtesave të këtyre vlerave në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të propozimeve për regjistrimin e këtyre dukurive, mbështetur në kriteret e parashikuara nga konventa “Për ruajtjen e vlerave kulturore jomateriale”⁵⁶.

Struktura organizative e MEKIT për shkak të gamës së gjerë të aktivitetit të saj mban 8 (tetë) drejtori të përgjithshme, ku një ndër të cilat edhe:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, që ka në varësi “Drejtorinë e Administrimit të Fondit të Trashëgimisë Kulturore, Artit, Kulturës dhe Projekteve”, “Drejtorinë e Politikave për Artin dhe Kulturën” dhe “Drejtorinë e Politikave për Trashëgiminë Kulturore”.



⁵⁶ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, neni 17.

Sa më sipër, në bazë të detyrimeve që lindin nga konventat por, dhe nga ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë rolin kryesor e ka Ministria e Kulturës me institucionet e saj të varësisë për trashëgiminë kulturore dhe pasuritë materiale dhe jo materiale. Por, ajo ç' ka u konstatua gjatë auditimit është se në këtë institucion nuk është ngritur një strukturë e cila të jetë e dedikuar vetëm për menaxhimin dhe koordinimin e programeve apo proceseve që lidhen me UNESCO-n.

Mungesa e një strukture specifike çon në mos rakordim ndërmjet institucioneve si vendore ashtu dhe qendrore, si edhe brenda vet strukturave të Ministrisë. Gjatë auditimit, u hasën vështirësi nga grupi auditimit në lidhje me mbledhjen e dokumentacionit të kërkuar mbi dosjet fizike të pasurive kombëtare të regjistruara tashme në UNESCO, korrespondencat shkresore ndërmjet institucioneve, si dhe me evidentimin e strukturave përgjegjëse përsa i përket çështjeve të ndryshme të trajtuara në auditim. Gjithashtu, evidentohet se nuk ka strukturë të ngarkuar me përgjegjësi për përkthimin e dosjeve përfaqësuese, raporteve apo informacioneve të ndryshme që dërgohen në UNESCO. Informacioni apo materialet sipas rastit përgatiten drejtpërsëdrejti në gjuhën angleze nga punonjësit e MEKI-t. Në rastet kur informacioni përcillet në gjuhën shqipe nga institucione të tjera, përkthehet nga MEPJ në gjuhën angleze (përkthim jozyrtar).

Një institucion tjetër i cili ka rolin e tij të rëndësishëm në marrëdhënie me UNESCO-n është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), e cila ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave të jashtme, drejtimin politik të procesit të integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimin e dialogut politik me institucionet e Bashkimit Evropian, zhvillimin dhe fuqizimin e diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit⁵⁷.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore⁵⁸:

- a) Harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar.
- b) Realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar dhe të shqiptarëve në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.
- c) Promovon dhe ndihmon në rritjen e zhvillimin e vlerave dhe të traditave më të mira shqiptare të bashkëkombësit jashtë kufijve shtetërorë.
- d) Promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuara në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare.
- e) Etj.

Në këtë ministri si pjesë e strukturës është dhe Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare (DON), e cila një ndër detyrat dhe përgjegjësitë e saj në lidhje me ruajtjen e vlerave dhe pasurive të vendit tonë të cilat janë pjesë e listave të UNESCO-s, ka koordinimin e punës midis Misionit të RSH-së pranë UNESCO-s në Paris. Ky i fundit përcjell kërkesat e Sekretariatit të UNESCO-s për çështje të ndryshme në Ministrinë e linjës përgjegjëse për mbrojtjen dhe menaxhimin e pasurive të vendit regjistruar në listat e UNESCO-s, konkretisht me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për pasuritë kulturore dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për pasuritë natyrore.

Referuar përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistës të zhvilluar në MEPJ, Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare luan një rol ndërmjetës në lidhje me kandidimin e vendit tonë në listat përfaqësuese të UNESCO-s, duke përcjell komunikimet midis palëve. Përgatitja e dosjeve

⁵⁷ <https://punetejashtme.gov.al/funksionet-dhe-detyrat-e-mepj/>

⁵⁸ VKM nr.81, datë 09.02.2022 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme".

të kandidimit është përgjegjësi e ministrive të linjës, ku për pasuritë kulturore vendimi për kandidimin e vendit tonë në listat përfaqësuese të UNESCO-s merret nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe për pasuritë natyrore nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Në këtë kuadër, përgjegjësia e DON është roli ndërmjetës dhe përcjelljes së dosjeve të kandidaturave pranë Misionit të RSH-së pranë UNESCO-s, i cili i përcjell më pas në sektorët përkatës të Sekretariatit të UNESCO-s, në varësi të Konventave. Pra, Menaxhimi dhe mbrojtja e vlerave/pasurive të regjistruara si dhe futja e vlerave/pasurive të reja në UNESCO janë kompetencë e ministrive të sipërpërmendura.

Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit midis MEPJ-së dhe MEKI-t lidhur me përfaqësimin e vendit tonë në UNESCO, për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave dhe pasurive kombëtare me vlera të jashtëzakonshme universale, Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare në MEPJ përcjell komunikimet që vijnë nga Misioni i RSH-së pranë UNESCO-s (entitet që ka nën tutelë) dhe ka rolin e ndërlidhësit. DON ka përgjegjësi gjithashtu t'i japë përgjigje, në konsultim me Ministrinë e linjës, pyetjeve që vijnë nga mediat ose shoqëria civile për çështje që lidhen me menaxhimin dhe mbrojtjen e pasurive kulturore dhe natyrore të vendit të regjistruar në listat e UNESCO-s.

MEPJ e përjashton veten nga çdo përgjegjësi në lidhje me përkthimin e dosjeve përfaqësuese, raporteve apo informacioneve të ndryshme që dërgohen nga shteti shqiptar në UNESCO duke sqaruar se për çdo informacion të kërkuar nga UNESCO apo edhe që dokumentacioni në dosjet e kandidimit të jetë në përputhje me përcaktimet e Guidës së UNESCO-s, institucionet përgjegjëse janë Ministria e Ekonomisë, Kulturës e Inovacionit për pasuritë kulturore, dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për pasuritë natyrore.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, (dhe institucionet e varësisë) ka për mision gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore materiale në vendin tonë⁵⁹.

IKTK-ja ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e vendit, në fushat e trashëgimisë kulturore materiale, të pasurisë e peizazhit natyror, si dhe të arkeologjisë parandaluese të shpëtimit nëntokësor dhe nënujor.

Në përmbushje të funksioneve të veta IKTK-ja bashkërendon punën me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Njësitë e Administrimit dhe të Koordinimit të Parqeve Arkeologjike, si dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore⁶⁰.

IKTK funksionon si Sekretaria Teknike dhe Sporteli Unik për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe **zbaton detyrimet që rrjedhin në kuadër të Konventës së Trashëgimisë Botërore për sitet e trashëgimisë botërore në Shqipëri** duke luajtur edhe rolin e pikës fokale në marrëdhënie me UNESCO-n.

IKTK -ja ka këto kompetenca⁶¹:

- Asiston ministrin në ushtrimin e kompetencave të tij për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.
- Propozon ndryshime në legjislacionin për trashëgiminë kulturore materiale.
- Zbaton konventat ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale si dhe propozon mënyrën e implementimit të këtyre konventave në legjislacionin kombëtar.
- Bashkërendon punën për zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore në pasuritë kulturore kombëtare me rëndësi universale.

⁵⁹ Rregullore e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të IKTK-së.

⁶⁰ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, neni 29.

⁶¹ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, neni 30.

- Gjurmim, hulumtim, studion dhe përgatit vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarimin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes.
- Harton dhe propozon standarde e kritere për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale.
- Harton projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi, terma reference, projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe bashkërendon punën për zbatimin e tyre në nivel kombëtar e vendor.
- Harton plane menaxhimi në bashkëpunim me institucione të vetëqeverisjes vendore, partnerë publikë e privatë, vendas dhe të huaj.
- Kryen punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore të luajtshme.
- Mban regjistrin publik të vlerave kulturore materiale.
- Bashkërendon veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të trashëgimisë kulturore për riorganizimin në aspektin muzeor të trashëgimisë arkeologjike, si dhe siguron pasurimin e fondeve për ruajtjen e objekteve arkeologjike të luajtshme.
- Propozon, mbi bazën e vlerësimeve paraprake dhe gjithëpërfshirëse, deklarimin për dhënien e statusit të pasurive kulturore.
- I propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore masat për mbrojtjen e vlerave kulturore.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, (Bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec) në fushën e kulturës ndër të tjera janë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve që lidhen me, zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve⁶². Gjithashtu, duhet të organizojnë aktivitetet kulturore për promovimin e identitetit kombëtar e lokal. Duke iu referuar temës tonë të auditimit përveç përgjegjësisë së përgjithshme që kanë të gjitha NJQV-të, secila bashki objekt i auditimit, ka përgjegjësi dhe funksione specifike në menaxhimin, ruajtjen, promovimin etj., të vlerave dhe pasurive kombëtare që administrohen në territorin e tyre.

Konkretisht, NJQV-të në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore⁶³:

- Bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- Kryejnë funksionet e ruajtjes e të mbrojtjes, të parashikuara në ligjin për trashëgiminë kulturore, të cilat nuk i përkasin pushtetit qendror, në bazë të marrëveshjeve specifike me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- Kryejnë funksionet administrative dhe të mbrojtjes së pasurive kulturore të peizazhit në bashkëpunim me pushtetin qendror, në zbatim të parashikimeve të ligjit për trashëgiminë kulturore, duke siguruar një qeverisje uniforme dhe të përshtatshme me synimet që kërkohen të arrihen.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të shteteve palë ndaj UNESCO-s, për periudhën 2019-2024 janë ftuar disa misione të UNESCO-s në Shqipëri.

Për trashëgiminë natyrore dhe kulturore e Rajonit të Ohrit

- Misioni i monitorimit reaktiv nga Qendra e Përbashkët e Trashëgimisë Botërore / ICOMOS / IUCN në pronën e Trashëgimisë Botërore Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit (Maqedonia e Veriut / Shqipëria) 27 - 31 janar 2020;
- Misioni Reaktiv i Monitorimit në pasurinë botërore "Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore e Rajonit të Ohrit, 25 - 29 Mars 2024;

⁶² Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 25.

⁶³ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, neni 14.

Për Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastrë

- Misioni i Përbashkët Monitorimi Reaktiv whc/Icomos/Iccrom në pronë të Trashëgimisë Botërore “Qendra Historike E Beratit Dhe Gjirokastrës” Nga 13-17 Dhjetor 2021.

Për Butrintin

Misioni Këshillimor QTB/ICOMOS në pasurinë Botërore Butrint, tetor 2022.

Institucionet objekt auditimi nuk kanë përmbushur detyrimet e Konventave Ndërkombëtare të nënshkruara dhe nuk kanë zbatuar rekomandimet e lëna nga misionet e UNESCO-s.

Rekomandimet e misionëve të UNESCO-s, në lidhje me mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë botërore në vendin tonë

Në Listën e Trashëgimisë Botërore (World Heritage List) vendi ynë përfaqësohet me 4 (katër) pasuri materiale: Parku Kombëtar i Butrintit, Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, Pyjet e Lashta të Ahut, Rrajca dhe Lumi i Gashit, Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Liqenit të Ohrit dhe me 5 (pesë) vlera kulturore jomateriale: Kodikët e Purpurit të Beratit, Iso-Polifonia, Xhubleta, Shtegtimi i Bagëtive dhe së fundmi K’cimi i Tropojës.

Koncepti i hapur i trashëgimisë është i mirë përmbledhur në nenin 2 të Konventës Faro 2005: *"trashëgimia kulturore është grup i burimeve të trashëguara nga e kaluara, të cilat njerëzit i identifikojnë, pavarësisht nga pronësia, si pasqyrim dhe shprehje e vlerave, besimeve, njohurive dhe traditave vazhdimisht në evoluim. Ajo përfshin të gjitha aspektet e mjedisit që vijnë nga ndërveprimi midis njerëzve dhe vendeve në raport me kohën"*.

Ky koncept i sanksionuar edhe në ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë⁶⁴ ku përcaktohet se trashëgimia kulturore përfshin pasurinë kulturore materiale dhe jomateriale, si një tërësi vlerash kulturore, mbartëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar, që kanë rëndësi shkencore ose kulturore. Vlerat kulturore janë “pasuri publike” dhe gëzojnë mbrojtje nga strukturat e qeverisjes qendrore e vendore në interesin më të mirë të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Vlerat kulturore mbarten në pasuri, të cilat mund të jenë në pronësi të shtetit, të bashkësive fetare të regjistruara, si dhe personave fizikë ose juridikë privatë. Pasuritë kulturore, sitet arkeologjike dhe objektet që janë me origjinë nga nëntoka dhe hapësira ujore kombëtare e Republikës së Shqipërisë, në kuptimin e ligjit për trashëgiminë kulturore, përbëjnë pronë shtetërore publike.

Zbatimi i Konventës së Trashëgimisë Botërore⁶⁵

Për të siguruar zbatimin efikas të Konventës së Trashëgimisë Botërore, është thelbësore që të gjithë aktorët e përfshirë të kenë akses në njohuritë e përditësuara mbi zbatimin e Konventës dhe mbi gjendjen e ruajtjes së pronave të Trashëgimisë Botërore. Diskutimet mbi mjetet më të përshtatshme për të vendosur këtë informacion të përditësuar kanë nisur në vitin 1982 dhe vazhdojnë që atëherë në seancat e Komitetit të Trashëgimisë Botërore, Asamblesë së Përgjithshme të Shteteve Palë në Konventë dhe Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s. Në vitin 1997, në përputhje me nenin 29 të Konventës, u arrit një konsensus që Shtetet Palë do të siguronin raporte periodike mbi zbatimin e Konventës dhe gjendjen e ruajtjes së pronave të Trashëgimisë Botërore.

Komiteti i Trashëgimisë Botërore, në sesionin e tij të njëzet e dytë të mbajtur në dhjetor 1998, miratoi një sërë vendimesh në lidhje me paraqitjen e raporteve periodike, për periodicitetin e

⁶⁴ Ligjin Nr. 27/2018 Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, Neni 4 - Pasuritë kulturore.

⁶⁵ Faqja zyrtare e UNESCO-s.

raportimit, përmbajtjen e raporteve dhe mënyrën në të cilën do të trajtojë raportet e Shteteve Palë. Në të njëjtën kohë, Komiteti miratoi formatin për raportimin periodik si dhe shënimet shpjeguese thelbësore.

Raportimi dhe monitorimi

Përsa më lartë, regjistrimi i një vendi në Listën e Trashëgimisë Botërore nuk është fundi i historisë. Autoritetet lokale duhet të punojnë vazhdimisht për menaxhimin, monitorimin dhe ruajtjen e pronave të Trashëgimisë Botërore.

Gjendja e ruajtjes

Shtetet Palë kanë detyrimin të përgatisin rregullisht raporte për gjendjen e ruajtjes dhe masat e ndryshme mbrojtëse të vendosura në vendet e tyre. Këto raporte i lejojnë Komitetit të Trashëgimisë Botërore të vlerësojë kushtet në secilin vend dhe në përfundim të vendosë mbi domosdoshmërinë e miratimit të masave specifike për zgjidhjen e problemeve të përsëritura. Një nga masat mund të jetë edhe përfshirja e një prone në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik.

Raportimi periodik

Procesi i Raportimit Periodik ofron një vlerësim të zbatimit të Konventës së Trashëgimisë Botërore nga Shtetet Palë si dhe mundëson informacion të përditësuar rreth vendeve për të regjistruar ndryshimet e mundshme në gjendjen e ruajtjes së tyre. Raportet Periodike të paraqitura nga vetë Shtetet Palë përgatiten në baza rajonale dhe shqyrtohen nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore bazuar në një cikël gjashtëvjeçar. Rezultatet përfshihen në raportin e Komitetit të Trashëgimisë Botërore në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s.

Qendra e Trashëgimisë Botërore publikon në faqen e saj të internetit dhe/ose në dokumentet e punës, dosjet e nominimeve të prodhuara nga Shtetet Palë me qëllim garantimin e transparencës, aksesit në informacion si dhe për të lehtësuar përgatitjet e analizave krahasuese nga Shtetet e tjera Palë. Publikimi i dosjes së nominimit, duke përfshirë hartat dhe emrat, nuk nënkupton shprehjen e ndonjë mendimi të Komitetit të Trashëgimisë Botërore ose të Sekretariatit të UNESCO-s në lidhje me historinë ose statusin ligjor të çdo vendi, territori, qyteti, zone, kufijve. Pra, përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e çdo dosjeje nominimi bie mbi shtetin palë në fjalë.

Në rastin e një siti të klasifikuar që i plotëson standardet e Trashëgimisë Botërore dhe bën pjesë në Listën e Trashëgimisë Botërore, pritet që vlerat dhe kushtet që i japin rëndësinë e tij universale, dhe të cilat e bëjnë të veçantë, të mirëmbahen në mënyrë të përhershme. Kjo do të thotë se veprimet të cilat do të zbehnin autenticitetin apo vlerat e sitit nuk janë të lejueshme dhe nuk duhet të ndodhin, pasi këto do të kishin penguar edhe kandidimin e tij në listë. Rrjedhimisht, dokumenti i vlerësimit mbi të cilin është bazuar emërimi si pjesë e Trashëgimisë Botërore shërben si një referencë e rëndësishme themeltare. Ky dokument, duhet të identifikojë sa më të qartë, dhe për të gjithë të interesuarit, ato vlera të sitit që kontribuojnë në rëndësinë e tij.


Bazuar në raportet periodike të dorëzuara nga shteti jonë në UNESCO por, dhe në vendimet dhe rekomandimet e komisioneve vlerësuese pranë tij, në mënyrë të përmbledhur rezulton se për:

Qytetet historike të Gjirokastrës dhe Beratit

Berati dhe Gjirokastra janë gdhendur si shembuj të rrallë të një karakteri arkitekturor tipik të periudhës osmane. Berati i vendosur në Shqipërinë qendrore, dëshmon për bashkëjetesën e komuniteteve të ndryshme fetare dhe kulturore ndër shekuj. Ai përmban një kështjellë, e njohur në vend si Kalaja, pjesa më e madhe e së cilës është ndërtuar në shekullin e 13-të, megjithëse

origjina e saj daton në shekullin e IV para Krishtit. Zona e kalasë numëron shumë kisha bizantine, kryesisht nga shekulli i 13-të, si dhe disa xhami të ndërtuara nën epokën osmane që filloi në 1417. Gjirokastra, shtrihet në luginën e lumit Drinos në Shqipërinë jugore, përmban një sërë shtëpish të jashtëzakonshme dykatëshe të cilat u zhvilluan në shekullin e 17-të. Qyteti ruan gjithashtu një pazar, një xhami të shekullit të 18-të dhe dy kisha të së njëjtës periudhë.

Vlera e jashtëzakonshme universale



Këto dy qendra historike të fortifikuara janë ruajtur jashtëzakonisht mirë, veçanërisht ndërtesat e tyre popullore. Ato kanë qenë të banuara vazhdimisht që nga kohërat e lashta e deri në ditët e sotme. Të vendosura në Ballkan, në Shqipërinë Jugore dhe afër njëra-tjetrës,

ato dëshmojnë për pasurinë dhe diversitetin e trashëgimisë urbane dhe arkitekturore të këtij rajoni. Berati dhe Gjirokastra dëshmojnë për një mënyrë jetese e cila është ndikuar për një periudhë të gjatë nga traditat e Islamit gjatë periudhës osmane, duke përfshirë në të njëjtën kohë ndikime më të lashta. Kjo mënyrë jetese ka respektuar traditat e krishtera ortodokse, të cilat kanë mundur të vazhdojnë zhvillimin e tyre shpirtëror dhe kulturor, veçanërisht në Berat. Gjirokastra u ndërtua nga pronarë të mëdhenj tokash. Rreth kalasë së lashtë të shekullit të 13-të, qyteti ka shtëpi me frëngji (*kule turke*) të cilat janë karakteristike për rajonin e Ballkanit. Gjirokastra përmban disa shembuj të shquar të shtëpive të këtij lloji, të cilat datojnë nga shekulli i 17-të, por edhe shembuj më të përpunuar që datojnë nga fillimi i shekullit të 19-të.

Berati dëshmon për një qytet që ishte i fortifikuar, por i hapur, dhe ishte i banuar për një kohë të gjatë nga zejtarë dhe tregtarë. Qendra e saj urbane pasqyron një traditë popullore banimi të Ballkanit, shembujt e së cilës datojnë kryesisht nga fundi i shekullit të 18-të dhe 19-të. Kjo traditë është përshtatur për t'iu përshtatur stileve të jetesës së qytetit, me shtëpi me nivele në shpatet, të cilat janë kryesisht horizontale në planimetri dhe përdorin me bollëk dritën e ditës.

Kriteri (iii): Berati dhe Gjirokastra japin dëshmi të jashtëzakonshme për diversitetin e shoqërive urbane në Ballkan dhe për mënyrat e gjata të jetesës që sot pothuajse janë zhdukur. Urbanistika dhe banesat e Gjirokastrës janë ato të një qyteti kala të ndërtuar nga pronarë të shquar tokash, interesat e të cilëve ishin të lidhura drejtpërdrejt me ato të pushtetit qendror. Berati mban gjurmën e një stili jetese më të pavarur, i lidhur me funksionet e tij artizanale dhe tregtare.

Kriteri (iv): Së bashku, dy qytetet e Gjirokastrës dhe Beratit japin dëshmi të jashtëzakonshme për lloje të ndryshme monumentesh dhe banesash urbane popullore gjatë periudhës klasike osmane, në vazhdimësi me kulturat e ndryshme mesjetare që i paraprinë asaj dhe në një gjendje bashkëjetese paqësore me një pakicë të madhe të krishterë, veçanërisht Berati.

Referuar raporteve dhe materialeve të UNESCO-s rezulton se: “Integriteti i përgjithshëm i dy qyteteve është i kënaqshëm, megjithëse i ndikuar **negativisht nga ndërtimet pa leje në fund të viteve 1990. Autenticiteti është gjithashtu i kënaqshëm, por menaxhimi i ruajtjes duhet të rritet dhe të zbatohet me kujdes, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.** Masat e planit të menaxhimit dhe autoriteti koordinues i krijuar kohët e fundit përgjegjës për zbatimin e planit duhet të inkurajojnë një politikë aktive të ruajtjes së vlerës universale të pronës, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e ndërtimit urban dhe objektet e vizitorëve”.

Përgjatë viteve autoritetet e UNESCO-s shprehen për faktorët që ndikojnë negativisht në pronë dhe që për të cilët shtetet palë duhet të marrin masa për t'i eliminuar me qëllim mos cenimin e

pasurisë me vlerë universale. Konkretisht nga viti 2009 deri në vitin 2024 janë evidentuar një sërë rreziqesh në lidhje me dy qendrat historike (Gjirokastrën dhe Beratit) dhe janë rekomanduar një sërë masash nga UNESCO për shtetin tonë, por ajo që bie në sy është që, jo vetëm që nuk janë marrë këto masa, por rreziqet që e ndikojnë pronën janë shtuar nga viti në vit, më konkretisht paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 1: Faktorët që ndikojnë pasuritë e regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore

Viti	2019	2021-2023-2024
Faktorët që ndikojnë pasuritë e regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore	Infrastruktura e transportit tokësor	Qeverisja
	Strehimi	Infrastruktura e transportit tokësor
	Veprimtari të paligjshme	Aktivitete kërkimore/monitoruese me ndikim të lartë
	Aktivitetet e menaxhimit	Strehimi
	Sistemet e menaxhimit/plani i menaxhimit	Veprimtari të paligjshme
	Kërcënime të tjera: Mungesa e aranzhimeve adekuate të shuarjes së zjarrit në zonën historike urbane.	Aktivitetet e menaxhimit
		Sistemet e menaxhimit/plani i menaxhimit
		Kërcënime të tjera: Mungesa e aranzhimeve adekuate të shuarjes së zjarrit në zonën historike urbane.

Burimi: Faqja zyrtare e UNESCO-s, përpunoi grupi i auditimit të KLSH-së.

Në raportin e fundit të Qendrës së Trashëgimisë Botërore dhe Organeve Këshillimore në vitin 2024 referohet se:

“Është bërë progres në përmirësimin e gjendjes së ruajtjes dhe mbrojtjes së pronës nëpërmjet nismës së Bonusit të Rivitalizimit dhe në përmirësimin e rregulloreve urbanistike. Megjithatë, është e rëndësishme të qartësohen lidhjet midis Peizazhit Historik Urban dhe planeve të menaxhimit, si dhe të sigurohen që të gjitha instrumentet e planifikimit dhe menaxhimit të punojnë së bashku për të ruajtur Vlerën e Jashtëzakonshme Universale (OUV) të pronës. Kjo duhet të arrihet duke qartësuar ndryshimet midis rregulloreve të mëparshme dhe planeve, duke siguruar referencë specifike ndaj OUV-së dhe duke specifikuar cilat politika janë të përshtatshme për mirëmbajtjen, përdorimin dhe zhvillimin e pronës në të ardhmen”.

Gjithashtu, rekomandohet që mjeti i integruar i ruajtjes dhe zhvillimit urban të zhvillohet në përputhje me zbatimin e Rekomandimit të UNESCO-s 2011 mbi Peizazhin Historik Urban. Komiteti inkurajon shtetin tonë që të vazhdojë përpjekjet për të kufizuar aktivitetet e ndërtimit të paligjshëm në këto pasuri.

Ajo që bie në sy është se UNESCO thekson se ne si shtet nuk mundëm të finalizojmë Planin e Menaxhimit të Integruar (PMI) (Integrated Management Plan, IMP) pa Asistencën Ndërkombëtare të ofruar nga Fondi i Trashëgimisë Botërore, si dhe kërkon që në vazhdim të kësaj të përgatitet **një draft i përditësuar i IMP si një çështje me urgjencë**, duke marrë parasysh komentet dhe rekomandimet e dhëna tashmë nga Organet Këshillimore, dhe me përfshirjen aktive të autoriteteve vendore të Beratit dhe Gjirokastrës.

Qendra e Trashëgimisë Botërore dhe Organet Këshillimore janë shprehur lidhur me faktin që ndërtimi i rrugës së bypass-it të Gjirokastrës ka përfunduar pa u dorëzuar një Vlerësim të Ndikimit në Trashëgimi (HIA) në Qendrën e Trashëgimisë Botërore siç kërkohet nga Komiteti. Rrjedhimisht, nuk mund të realizohet marrja e masave zbutëse për të shmangur ndikimin

negativ në OUV të pronës. Për këtë fakt Komiteti i rekomandon Shqipërisë që duhet të përfundojë **urgjentisht një HIA** të bypass-it të Gjirokastrës dhe më pas ta paraqesë në Qendrën e Trashëgimisë Botërore për shqyrtim nga Organet Këshillimore.

Ndikimet negative të bypass-it të Gjirokastrës dhe projekteve të ndryshme zhvillimore, në OUV të pronës nuk janë vlerësuar plotësisht. Nuk është zhvilluar një vizion afatgjatë për zhvillimin e të gjithë zonës, sikurse është kërkuar edhe në vendimin e mëparshëm të Komisionit. Prandaj, Komiteti rekomandon që duhet ndërmarrë një HIA e integruar që do të vlerësonte ndikimin e projekteve të shumta të infrastrukturës në ruajtjen e integritetit dhe autenticitetit të pronës.

Shqipëria edhe pse nënshkruese e konventës për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore / kulturore natyrore, nuk ka të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi detyrimin që çdo projekt që kryhet në shtet e trashëgimisë kulturore duhet më parë të marrë “Vlerësim të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)”.

Gjithashtu, rezulton se detajet e projekteve të zhvillimit që mund të kenë ndikim në OUV të pronës nuk janë dorëzuar në Qendrën e Trashëgimisë Botërore për shqyrtim nga Organet Këshillimore.

Shtetet palë nënshkruese të Konventës kanë detyrimin që raportimet dhe informacionet që dërgojnë pranë Komunitetit të jenë në një nga gjuhët zyrtare të UNESCO-s (gjuha Angleze ose gjuha Franceze). Në një nga Raportet e hartuar nga UNESCO në vitin 2023, për Qytetet historike të Gjirokastrës dhe Beratit,⁶⁶ rezulton se në 7 shtator 2022, shteti Shqiptar paraqiti projektin teknik të përditësuar për Bypass-in e Gjirokastrës dhe një projekt restaurimi për tre urat historike mbi përroin Zerzebili. Dokumentacioni i paraqitur përfshin miratimet për një ndryshim në rrugën e bypass-it të Gjirokastrës më datë 1 korrik 2022. **Informacioni i dorëzuar nuk ishte në një nga gjuhët zyrtare të Komitetit, anglisht apo frëngjisht.** Nga intervistat e zhvilluara me nëpunësit e MEKI u kthye përgjigje se projektet infrastrukturore nuk mund të përktihen nga stafi i Ministrisë. Argumentim ky që në gjykimin e grupit të auditimit nuk qëndron, pasi nuk na u vendos dokumentacion në dispozicion që të vërtetonte se nga ana e MEKI-t ishin bërë përpjekje për të bashkëpunuar me struktura të tjera (p.sh me MEPJ apo me Misionin tonë në UNESCO) ku të paktën projekti të shoqërohej me një përmbledhje në njërën nga gjuhët zyrtare të UNESCO-s.

Për të gjithë sa u trajtuar më sipër konstatohet një mungesë vëmendje nga ana e strukturave përgjegjëse të shtetit shqiptar në marrjen e masave ndaj zbatimit të rekomandimeve të UNESCO-s dhe kërkesave të tyre në funksion të ruajtjes dhe zhvillimit të pasurisë dhe trashëgimisë sonë me vlera universale.

Një situatë e ngjashme si më lartë paraqitet edhe për “**Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit (Pogradec)**”.

Në vitin 1979, Komiteti vendosi të regjistrojë Liqenin e Ohrit në Listën e Trashëgimisë Botërore sipas kriterëve natyrore (iii). Në vitin 1980, kjo pronë u zgjerua për të përfshirë zonën kulturore dhe historike dhe u shtuan kriteret kulturore (i)(iii)(iv).

Edhe në këtë rast, faktorët që ndikojnë në pronë (në 2024)⁶⁷ janë:

- Infrastruktura e transportit tokësor
- Strehimi
- Ndikimet e turizmit/vizitorit/rekreacionit

⁶⁶ <https://whc.unesco.org/en/soc/4363>

⁶⁷ <https://whc.unesco.org/en/soc/4622>

- Akomodimi i madh i vizitorëve dhe infrastruktura përkatëse
- Sistemet e menaxhimit/plani i menaxhimit

Analiza dhe përfundimet nga Qendra e Trashëgimisë Botërore dhe Organet Këshillimore në 2024 për Trashëgiminë natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit

Komiteti thekson se: Shqipëria duhet të përmirësojë statusin e SRP-së, (Strategic Recovery Plan) duke e miratuar nga qeveria, për të siguruar efektivitetin e zbatimit të tij.

Përforsimi i bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë funksionimin e rregullt të Komitetit të Menaxhimit të Pellgut Ujëmbledhës Ndërkufitar, dhe duke përfshirë përfaqësues të nivelit të lartë, do t'i siguronte Grupit të Punës Ndërkufitare mandatin e nevojshëm për të zbatuar dhe trajtuar sfidat urgjente ndërkufitare në kohë dhe në mënyrë efektive. Duhet angazhimi i të dy Shteteve Palë (Shqipëri, Maqedoni e Veriut) për të krijuar një faqe interneti publike që detajon progresin në SRP.

Gjithashtu, theksohet se studimi i fizibilitetit për rrugën alternative të Korridorit VIII, i cili nuk ka përparuar mjaftueshëm që nga viti 2023, duhet të përgatitet në vitin 2024 dhe se kontraktorit duhet t'i kërkohet të ndërmarrë një Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) dhe/ose një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (VNM) për të vlerësuar ndikimet e mundshme në OUV.

Komiteti thekson se gjendja e ruajtjes së pronës nuk është përmirësuar që nga viti 2020, pra kërcënimet kumulative për OUV-në e pronës vazhdojnë, ndërkohë janë shfaqur dhe kërcënime të reja që vazhdojnë ta bëjnë gjendjen e ruajtjes së pronës të cenueshme.

Lidhur me strukturat e paligjshme, të dy shteteve palë u rekomandohet të eliminojnë ndikimet negative të tyre në OUV të pronës.

Rruga e bypass-it mes Pogradecit, Tushemishtit dhe kufirit Verior Maqedonas-Shqiptar është planifikuar pranë daljes së Burimeve të Drilonit, me rrezik për rrjedhje. Masterplani për Parkun Ujor Drilon-Tushemisht përfshin zhvillim në tokë bujqësore që misioni i vitit 2020 rekomandoi se nuk duhet të zhvillohet, dhe nuk është përjashtuar përfundimisht infrastruktura rrugore dhe ndërtimi në zonën e Burimeve të Drilonit. Dispozitat për zhvillimin urban në Planin e Përgjithshëm Vendor të Pogradecit, të rekomanduara për heqje nga misioni 2020 janë akoma në fuqi. **Është e paqartë se si dhe kur do të trajtohet çështja kryesore e rrjedhjeve të pakontrolluara të ujërave të zeza. Nuk janë ndërmarr ende masa urgjente për adresimin e kërcënimeve ekzistuese dhe parandalimin e kërcënimeve të reja, siç kërkohet nga Komiteti.** Niveli i lartë i cenueshmërisë së pronës nuk pranohet nga vendimmarrësit kryesorë duke çuar në një situatë të mbartur dhe të njëjtat risqe që e cenojnë pronën janë që nga viti 2019.

Nga pyetëtorët që grupi i auditimit i drejtoi MEKI-t një serë pyetjesh të cilat lidheshin me marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të UNESCO nuk morën përgjigje. Nga intervistat e zhvilluara rezultoi se Ministria nuk ka hartuar një plan për zbatimin e rekomandimeve të UNESCO-s në kuadër të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore universale, nuk rezulton të hartohet një plan pune me detyra konkrete për institucionet përgjegjëse apo nuk merren fare masa për zbatimin e tyre, duke bërë që shtetit shqiptar t'i tërhiqet disa herë vëmendja në lidhje me masat urgjente që duhet të merren për adresimin e kërcënimeve ekzistuese dhe parandalimin e kërcënimeve të reja.

Iso-Polifonia (labe)

Referuar faqes zyrtare të UNESCO-s, muzika tradicionale polifonike shqiptare mund të ndahet në dy grupe të mëdha stilistike të interpretuara nga gegët e Shqipërisë veriore dhe toskët që jetojnë në pjesën jugore të vendit. Termi iso, lidhet me isonin e muzikës kishtare bizantine dhe i referohet dronit që shoqëron këndimin polifonik. E interpretuar kryesisht nga këngëtarë

meshkuj, muzika tradicionalisht shoqëron një gamë të gjerë ngjarjesh shoqërore, si dasma, funerale, festa të korrjeve, festime fetare dhe festa të tilla si festivali i mirënjohur folklorik shqiptar në Gjirokastrë.

Isopolifonia shqiptare karakterizohet nga këngët e përbërë nga dy pjesë solo, një melodi dhe një kundërmelodi me dron koral. Struktura e pjesëve solo ndryshon sipas mënyrave të ndryshme të interpretimit të dronit, i cili ka një larmi të madhe strukturash, veçanërisht në stilin popullor të adoptuar nga të gjitha grupet që performojnë këtë muzikë. Gjatë dekadave të fundit, rritja modeste e turizmit kulturor dhe interesi në rritje i komunitetit studiues për këtë traditë unike popullore kanë kontribuar në ringjalljen e iso-polifonisë shqiptare. Megjithatë, tradita ndikohet negativisht nga varfëria, mungesa e mbrojtjes ligjore dhe mungesa e mbështetjes financiare për praktikuesit, duke kërcënuar transmetimin e repertorit të gjerë të këngëve dhe teknikave. Eksodi rural i të rinjve në qytetet më të mëdha dhe jashtë vendit në kërkim të punës e shton këtë rrezik. Nisur nga këto kushte, në kohën e sotme, transmetimi i kësaj tradite mbahet më shumë përmes artistëve profesionistë të popullit, sesa brenda strukturës familjare.⁶⁸

Faktorë kërcënues për Iso-Polifoninë janë:

- praktikues të moshuar,
- burime të pamjaftueshme financiare, dhe
- migrimi rural-urban.

Një nga kriteret kërcënuese për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jo materiale me vlerë universale është **vazhdimësia dhe faktorët kërcënues të identifikuar deri tani lidhen drejtpërdrejt me të.**

Faktorët e qëndrueshëm të riskut ndaj pasurisë.

Për periudhën e auditimit janë identifikuar disa faktorë që cenojnë pasuritë, mos adresimi i këtyre faktorëve në një afatgjatë mund të sjelli kalimin e këtyre pasurive apo elementeve në risk, ky kalim (në risk) dhe mos marrja e masave për uljen e këtyre faktorëve do sillte si pasojë daljen nga UNESCO, fakt ky i vërtetuar të ketë ndodhur me shtete të tjera si p.sh. Gjermania për të cilën në vitin 2006 Komiteti i Trashëgimisë Botërore me qëllim që të shmangë planet e bashkisë së Dresdenit për të ndërtuar një urë mbi Elbë vendosi në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik, peizazhin kulturor të Luginës së Elbës së Dresdenit.

Xhubleta⁶⁹ është një veshje e punuar me dorë e veshur nga gratë dhe vajzat malësore në Shqipërinë e Veriut, e karakterizuar nga forma e saj e valëzuar e ziles. Kryesisht e zezë me motive të qëndisura shumëngjyrëshe, procesi i përpunimit përfshin përgatitjen e shajakut, prerjen, qepjen dhe qëndisjen e figurave simbolike. Xhubleta dikur përdorej në jetën e përditshme që nga moshë e pubertetit, duke treguar statusin social dhe ekonomik të mbajtësit. Megjithatë, përdorimi dhe prodhimi i tij ka qenë në rënie gjatë dekadave të fundit për arsye socio-politike dhe ekonomike. Politikën e reja të vendosura në vitet 1960 ndryshuan modelet tradicionale kulturore, duke sjellë ndryshime në jetën e përditshme të komuniteteve malore dhe përdorimin dhe prodhimin e Xhubletës, Xhubleta nuk ishte më praktike për jetën e përditshme. Për më tepër, kolektivizimi shtetëror çoi në mungesën e lëndëve të para për prodhimin e saj. Sot, pak gra posedojnë njohuri për të gjithë procesin dhe transmetimi tradicional i bazuar në familje është i rrallë. Megjithatë, veshja ka ruajtur domethënien e saj shoqërore dhe shpirtërore dhe ende konsiderohet pjesë përbërëse e identitetit malësor⁷⁰.

Faktorë kërcënues për Xhubletën janë:

- Praktikues të moshuar

⁶⁸ <https://ich.unesco.org/en/RL/albanian-folk-iso-polyphony-00155>

⁶⁹ Shkruar në 2022 (17.COM) në listën e trashëgimisë kulturore jomateriale në nevojë për mbrojtje urgjente

⁷⁰ <https://ich.unesco.org/en/USL/xhubleta-skills-craftsmanship-and-forms-of-usage-01880>

- Stërvitje e mundimshme
- Zvogëlimi i pjesëmarrjes
- Mungesa materialeve
- Përdorimi i materialeve moderne

Edhen në rastin e Xhubletës një nga kriteret kërcënuese për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jo materiale me vlerë universale është **vazhdimësia dhe autenticiteti dhe faktorët kërcënues të identifikuar deri tani lidhen drejtpërdrejt me ta.**

Autenticiteti⁷¹ është një aspekt kyç i vlerësimit të burimeve të trashëgimisë. Në terma të përgjithshme, burimi i trashëgimisë është autentik kur materiali me të cilin është ndërtuar është origjinal apo i mirëfilltë, dhe i vjetruar nga koha.

Në lidhje me një monument apo sit historik që konsiderohet si vepër arti, të qenit ‘autentik’ mund të kuptohet në raport me procesin krijues që e prodhoi atë si një produkt origjinal të kohës së tij, dhe përfshin edhe efektet e kalimit të tij nëpër rrjedhën e historisë. (Të qenit ‘autentik’ nuk duhet të ngatërrohet me të qenit ‘identik’; p.sh.: rindërtimi modern mund të jetë identik me formën historike, por nuk është autentik.) Dokumenti i Nara-s mbi Autenticitetin, i vitit 1994, thekson nevojën që burimet e informacionit për vlerësimin e autenticitetit të jenë të besueshme dhe të vërteta, si dhe nënvizon se larmia e kulturave dhe trashëgimisë mund të kuptohet si një burim i pazëvendësueshëm i pasurisë shpirtërore dhe intelektuale për tërë njerëzimin.

Autenticiteti rrjedh nga përkufizimi i burimit. Kështu që, autenticiteti mund të kuptohet në mënyra të ndryshme në varësi të kontekstit dhe rëndësisë së tij historike.

Në rastin e burimit të trashëgimisë, autenticiteti i tij historik duhet që në përgjithësi të reflektojë etapat e rëndësishme të ndërtimit dhe shfrytëzimit përgjatë rrjedhës historike të tij.

Autenticiteti mund të rrezikohet me prishjen e shtresave historike, zëvendësimin e elementeve origjinale me elemente moderne (sidomos nëse kjo bazohet në supozime) dhe shtimin e elementeve të reja. Një burim trashëgimie që e ka kaluar provën e autenticitetit, e ruan integritetin e tij origjinal, ashtu siç është krijuar apo siç ka evoluar gjatë rrjedhës historike. Megjithatë aspekte të ndryshme të burimit të trashëgimisë duhet të analizohen për të përcaktuar shkallën e autenticitetit, është e rëndësishme që të merret një vendim gjithëpërfshirës, d.m.th. nuk mjafton të merret parasysh vetëm njëri prej aspekteve. Për t’u emëruar në Listën e Trashëgimisë Botërore, burimi i trashëgimisë duhet të ketë një integritet të paprekur në raport me këto katër⁷² aspekte të autenticitetit. Nëse, për shembull, burimi origjinal është shkatërruar, kopja e tij nuk do t’i përmbushte kriteret pasi do të humbiste autenticiteti i materialit. Autenticiteti i materialeve është një kriter parësor në përcaktimin e autenticitetit të projektimit dhe punës, të cilat së bashku me autenticitetin e kontekstit përkufizojnë burimin e trashëgimisë kulturore. Nga ana tjetër, dhe në të njëjtën kohë, shumica e burimeve historike ndryshojnë për shkak të përdorimit të tyre dhe si pasojë ndikimeve të ushtruara nga forcat natyrore. Këto ndryshime janë pjesë e shtresëzimit historik të burimit.⁷³

Gjetje nga auditimi:

1. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk ka hartuar dhe miratuar ende 46% të akteve nënligjore në zbatim të neneve 263-277 të ligjit “Për trashëgiminë

⁷¹ https://chwbkosova.org/wp-content/uploads/2014/09/Publication_2010_7.pdf

⁷² Sipas Udhëzuesit për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore Botërore, duhet të merren parasysh katër aspekte të autenticitetit:

- autenticiteti i projektimit (“design”)
- autenticiteti i materialeve
- autenticiteti i punës së aplikuar
- autenticiteti i mjedisit

⁷³ Udhëzues për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore Botërore

kulturore dhe muzetë”, i cili është miratuar në vitin 2018. Mungesa e akteve nënligjore ka sjellë mos zbatim të kërkesave të ligjit në funksion të qëllimit të tij, si dhe paqartësi dhe pengesa në realizimin e detyrave nga institucionet përgjegjëse. Gjithashtu, konstatohet hartim apo miratim jashtë afateve edhe për Planet e Menaxhimit të Pasurive të Regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore. Konkretisht, nuk janë miratuar ende Planet e Menaxhimit të Qendrave Historike të Beratit dhe Gjirokastrës.

2. Gjetje nga auditimi: Në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk ka një strukturë specifike me detyra për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale të vendit tonë në UNESCO. Organizimi strukturor i MEKI-t për periudhën objekt auditimi, nuk e përcakton qartë se cila strukturë është përgjegjëse për koordinimin e të gjithë punës midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor, për hartimin e dokumentacionit të dosjeve të kandidimit, për misionet dhe për rekomandimet e UNESCO-s, për koordinimin ndërmjet institucioneve deri në përcjelljen e dosjeve për në UNESCO, koordinimin dhe rakordimin e punëve për zbatimin e rekomandime të komisioneve, përkthimin e materialeve në mënyrë sa më profesionale, arkivimin e dosjeve etj.

3. Gjetje nga auditimi: Shqipëria edhe pse nënshkruese e dy konventave bazë për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore / kulturore natyrore dhe pasurive kulturore jomateriale, nuk ka të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi detyrime që derivojnë nga këto Konventa, si p.sh., çdo projekt që kryhet në sitet e trashëgimisë kulturore duhet të marrë më parë “Vlerësim të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)”. Konkretisht, Shteti Shqiptar për projektin infrastrukturor të Bypass-it të Gjirokastrës ka vijuar zbatimin pa bërë “Vlerësimin e Ndikimit në Trashëgimi” të tij, si dhe pa konsideruar rekomandimet që janë bërë vit pas viti nga Komiteti i UNESCO-s duke riskuar integritetin e përgjithshëm të këtij qyteti dhe cenuar këtë pasuri me vlerë universale.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se informacionet që dërgohen rast pas rasti në Komitetin e UNESCO-s, nuk kanë qenë gjithmonë të përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të përcaktuara (gjuha Angleze ose gjuha Franceze). Konkretisht, Shteti Shqiptar ka paraqitur projektin teknik të përditësuar për bypass-in e Gjirokastrës dhe një projekt restaurimi për tre urat historike mbi përroin Zerzebili në korrik të vitit 2022 në Gjuhën Shqipe, në kundërshtim me përcaktimet e Konventës. Nga dokumentacioni i shqyrtuar si dhe nga intervistat e zhvilluara në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nuk rezulton të jetë bërë asnjë komunikim midis institucioneve (MEKI, MEPJ dhe Misionin tonë në UNESCO) apo përpjekje që projekti i restaurimit të shoqërohej të paktën me një përmbledhje në njërën nga gjuhët zyrtare të UNESCO-s. Ky fakt është theksuar edhe në raportin e UNESCO-s për Shqipërinë në vitin 2023.

5. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nuk merr asnjë masë konkrete për të adresuar zbatimin e rekomandimeve që lënë misionet e UNESCO-s për pasuritë pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore (p.sh. Qendrat Historike të Beratit dhe Gjirokastrës, Trashëgimia kulturore dhe natyrore e Liqenit të Ohrit). Rekomandimet nuk adresohen për ndjekje dhe zbatim nga asnjë strukturë specifike në institucionet publike, nuk koordinohet puna midis institucioneve përgjegjëse, nuk ka një plan masash për zbatim, si dhe nuk ka informacion se çfarë bën dhe duhet të bëjë secila strukturë për zbatimin e rekomandimeve të UNESCO-s.

6. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkia Pogradec, nuk kanë marrë masa për të adresuar dhe reduktuar faktorët që rrezikojnë pasurinë natyrore kulturore të Liqenit të Ohrit, të cilat të kombinuara me shkallën e lartë të projekteve infrastrukturore që zhvillohen në të, rrezikojnë që kjo pasuri të regjistrohet në “Listën e Pasurive Botërore në Rrezik”. Këto institucione në vijimësi kanë shpërfillur rekomandimet e Komitetit të UNESCO-s i cili që nga viti 2019 e në vijim, thekson se duhet të merren masa urgjente dhe të mobilizohen të gjitha palët dhe aktorët për të reduktuar kërcënimet dhe për të bërë të mundur ruajtjen e Vlerave të Jashtëzakonshme Universale të Liqenit të Ohrit.

Gjithashtu, projekti i Parkut Ujor Drilon – Tushemisht ka vijuar, pa marrë në konsideratë rekomandimet e Komitetit që nga viti 2020 e në vijim.

Konkluzione:

1. Konkluzion: Mungesa e akteve nënligjore, kufizon zbatimin e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë duke bërë që të rrezikohet integriteti i pasurive kulturore të paluajtshme, dëmtimi dhe zhdukja e zonave arkeologjike, pasurive kulturore, si dhe duke dëmtuar imazhin apo identitetin kombëtar.

2. Konkluzion: Mungesa e një strukture specifike në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me objekt koordinimin e punës midis institucioneve të niveleve të ndryshme lidhur me përfaqësimin në UNESCO, ndikon drejtpërsëdrejti në efektivitetin e punës që bëhet për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive dhe vlerave të vendit tonë me rëndësi universale. Mungesa e strukturës koordinuese ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e materialeve kandiduese që paraqiten, në cilësinë e raportimeve periodike, në nivelin e zbatimit të rekomandimeve etj.

3. Konkluzion: Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgimi është i detyrueshëm bazuar në përcaktimet e Udhëzuesit të UNESCO-s për të gjitha projektet që zhvillohen në pasuritë e trashëgimisë kulturore. Ky vlerësim së bashku me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis etj., duhet të shërbejnë për të identifikuar alternativat e zhvillimit, si dhe për ndikimet e mundshme pozitive dhe negative në vlerën e jashtëzakonshme universale të pronës dhe për të rekomanduar masa zbutëse kundër degradimit ose ndikimeve të tjera negative në trashëgiminë kulturore ose natyrore brenda pronës ose mjedisit të saj më të gjerë. Kjo do të sigurojë ruajtjen afatgjatë të vlerës së jashtëzakonshme universale dhe forcimin e qëndrueshmërisë së trashëgimisë ndaj fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike.

4. Konkluzion: Zbatimi i rekomandimeve të UNESCO-s përfshin disa struktura në nivel qendror apo vendor prandaj është e rëndësishme hartimi i një plani, ndjekja dhe koordinimi i punës nga një strukturë e posaçme pranë MEKI-t. Mos zbatimi i rekomandimeve, në të ardhmen mund të sjellë risqe serioze për pasuritë pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore, që mund të sjellin kalimin e tyre në Listën e Pasurive në Rrezik apo në rastin më ekstrem edhe në nxjerrjen nga Lista.

Rekomandime:

1.1 Rekomandim: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me institucionet e varësisë, ministritë e linjës apo me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të marrë masa për të hartuar dhe miratuar të gjithë kuadrin nënligjor dhe rregullator për zbatimin e plotë të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

Brenda datës 30.06.2025

1.2 Rekomandim: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me institucionet e varësisë, dhe me bashkitë përkatëse të marrë masa për të ndjekur me prioritet miratimin e Planeve të Menaxhimit të Qendrave Historike të Beratit dhe Gjirokastrës dhe në vijimësi të kryejë monitorimin e tyre.

Menjëherë

2.1 Rekomandim: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të krijojë një strukturë të specializuar dhe përgjegjëse me detyra të përcaktuara, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale të vendit tonë në UNESCO, koordinimin e punës në nivel ndërinstitutional, koordinimin e punës për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit, përgatitjen e dosjeve të kandidimit etj.

Menjëherë

3.1 Rekomandim: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, të marrin masa për të hartuar dhe bërë të mundur përfshirjen në

kuadron ligjor / nënligjor vendas, detyrimin që projektet të cilat do të zhvillohen në sitet e trashëgimisë kulturore t'i nënshtrohen "Vlerësimi të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)".

Brenda datës 31.12.2025

3.2 Rekomandim: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastrë, të zbatojë rekomandimin e misionit të UNESCO-s, që projektit të bypass-it të Gjirokastrës t'i kryhet Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgimi (HIA).

Menjëherë

4.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrë masat, si dhe të bashkëpunojë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Misionin tonë në UNESCO, për të siguruar që çdo informacion i kërkuar nga Komiteti, të jetë në përputhje me përcaktimet e Konventave apo udhëzuesve përkatës, përfshirë këtu edhe përkthimin në një nga gjuhët zyrtare të UNESCO-s.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të hartojë plane masash me strukturat përgjegjëse, për zbatimin e rekomandimeve të misioneve të UNESCO-s, të koordinojë punën për ndjekjen e zbatimit të tyre, si dhe të raportojë ecurinë.

Brenda datës 30.06.2025 dhe në vijimësi

6.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkinë Pogradec, të marrin masa të menjëhershme për të adresuar të gjitha faktorët që kërcënojnë Vlerat e Jashtëzakonshme Universale të Liqenit të Ohrit. Gjithashtu, të gjitha projektet infrastrukturore që prekin sipërfaqen e pasurisë apo zonën buferike, të dërgohen për vlerësim nga Strukturat Këshillimore të Komitetit.

Brenda datës 30.06.2025

6.2 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkinë Pogradec, të marrin masa të menjëhershme për të dërguar pranë Komitetit të gjithë dokumentacionin e duhur me qëllim që projekti i Parkut Ujor Drilon – Tushemisht të shqyrtohet nga Strukturat Këshillimore.

Menjëherë

5.1.2 A kanë siguruar institucionet përgjegjëse mbështetjen e duhur dhe bashkëpunimin për ruajtjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë?

Bashkëpunimi midis institucioneve objekt auditimi në nivel qendror dhe vendor, nuk është në nivelet e duhura.

Sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJQV-të)⁷⁴ në fushën e kulturës ndër të tjera janë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve që lidhen me, zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve⁷⁵. Në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore⁷⁶.

⁷⁴ Subjektet objekt auditimi bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec

⁷⁵ Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 25.

⁷⁶ Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025, Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore.

NJQV-të kryejnë funksionet e ruajtjes e të mbrojtjes, të parashikuara në ligjin për trashëgiminë kulturore, të cilat nuk i përkasin pushtetit qendror, në bazë të marrëveshjeve specifike me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore⁷⁷.

NJQV-të duhet ti kryejnë funksionet administrative dhe të mbrojtjes së pasurive kulturore të peizazhit në bashkëpunim me pushtetin qendror, në zbatim të parashikimeve të ligjit për trashëgiminë kulturore, duke siguruar një qeverisje uniforme dhe të përshtatshme me synimet që kërkohen të arrihen⁷⁸.

Për të siguruar ruajtjen e vlerave kulturore materiale krijohet “Fondi kombëtar i kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, në formën e një fondi financiar publik, që mbështet politikën kombëtare të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore materiale⁷⁹.

Për të garantuar marrjen e masave efikase dhe aktive për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tij, çdo shtet palë në Konventë duhet të marrë masat e duhura ligjore, shkencore, teknike, administrative dhe financiare të nevojshme për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin e kësaj trashëgimie⁸⁰.

Gjithashtu, duhet të organizojnë aktivitete kulturore për promovimin e identitetit kombëtar e lokal. Referuar temës të auditimit përveç përgjegjësisë së përgjithshme që kanë të gjitha NJQV-të, secila bashki objekt i auditimit ka përgjegjësi dhe funksione specifike në menaxhimin, ruajtjen, promovimin etj., të vlerave dhe pasurive kombëtare që administrohen në territorin e tyre. Nga pyetësorët drejtuar NJQV dhe intervistave zhvilluar në disa prej tyre rezulton se, nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm dhe efektiv midis institucioneve të specializuara në nivel qendror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore. Në disa NJQV si në rastin e Bashkisë Durrës nuk ka patur fare bashkëpunim, apo edhe në rastin e Bashkisë Gjirokastrë ku kjo e fundit shprehet se nuk ka dijeni për kërkesat e UNESCO-s për sa i përket HIA-s së bypassit të këtij qyteti. Shpesh herë institucionet kanë vështirësi në kanalizimin e komunikimeve midis tyre, ndërkohë që kjo ka pasoja thelbësore, për pasuritë pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore, pasi mund të sjelli kalimin e tyre në Listën e Pasurive në Rrezik apo në rastin më ekstrem edhe në nxjerrjen nga Lista.

Në përfundim të procesit të decentralizimit dhe delegimit të një sërë kompetencash nga niveli qendror në nivelin vendor përfshinë edhe fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, mjedisit etj., bashkëpunimi midis institucioneve të niveleve të ndryshme rezulton të jetë jo efektiv.

Bashkëpunimi midis MEPJ-së dhe MEKI-t lidhur me përfaqësimin e vendit tonë në UNESCO për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave dhe pasurive kombëtare me vlera të jashtëzakonshme universale ka konsistuar në:

- Përcjellje të Vendimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore/UNESCO;
- Përcjellje të korrespondencave nga QTB/UNESCO në lidhje me gjendjen e konservimit, vlerësimin teknik mbi propozime të shtetit pale për projekte në zona trashëgimi botërore;
- Pjesëmarrje në mbledhje të Komitetit të Trashëgimisë Botërore nëpërmjet Misionit të Përhershëm të Shqipërisë pranë UNESCO-s;
- Pjesëmarrje në takime të kërkuara nga QTB apo shteti palë me ndërmjetimin, praninë dhe pjesëmarrjen e Misionit të Përhershëm të Shqipërisë pranë UNESCO.

⁷⁷ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë, neni 14.

⁷⁸ VKM nr. 737, datë 17.09.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale” pika 2, 3, 4, 5.

⁷⁹ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë, neni 19, neni 20.

⁸⁰ Konventa lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, neni 5.

MEKI (ish Ministria e Kulturës) ka nënshkruar në vitin 2020 një memorandum bashkëpunimi me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) për përgatitjen e dosjeve të aplikimit dhe regjistrimit të katër dukurive të trashëgimisë jo materiale shqiptare në listën përfaqësuese të dukurive jo materiale të njerëzimit. Gjithashtu, me AADF kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe disa bashki (Durrës, Berat) për të mbështetur disa nga projektet, konkretisht si vijon:

1. Memorandum mirëkuptimi për dizajnin për zonën qendrore të amfiteatrit, forumit bizantin, termat romake dhe shtigjet urbane.
2. Marrëveshje bashkëpunimi midis AADF, MK dhe Bashkia Berat për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të destinacionit për projektin për ngritjen dhe përmirësimin e aktiviteteve kulturore dhe turistike në Kalanë e Beratit.
3. Memorandum Mirëkuptimi midis AADF, MK dhe Bashkia Durrës për planin e menaxhimit të Integruar të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit 2021-2027 si dhe krijimin e TID Durrës midis Bashkisë Durrës dhe AADF.
4. Marrëveshje Shërbimi ndërmjet AADF, Ministria e Kulturës, Bashkia Durrës dhe “E. C. G.” shpk.
5. Marrëveshje Bashkëpunimi midis AADF, MK dhe Bashkisë Durrës për kompaninë e projektit TID Durrës.
6. Marrëveshje Bashkëpunimi midis MK, AADF për themelimin e fondacionit për menaxhimin e Butrintit.
7. Memorandum Mirëkuptimi midis MK, AADF për regjistrimin e 4 dukurive të trashëgimisë jomateriale shqiptare në “Listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të Njerëzimit.
8. Etj..

Institucionet nën auditim nuk kanë planifikuar fonde buxhetore të adresuara për pasuritë e trashëgimisë kulturore të regjistruara në UNESCO apo ato pjesë e listës tentative.

Përsa i takon përcaktimit të fondeve për financime në fushën e trashëgimisë kulturore, duke u fokusuar specifikisht te financimet për pasuri kulturore të vendit tonë pjesë e UNESCO, jemi bazuar te Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025 hartuar dhe miratuar nga Ministria e Kulturës, Ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, si dhe të dhënat e analizuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, lidhur me planifikimin dhe realizimin e fondeve buxhetore të viteve 2020 – 2024 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI). Në kuadër të auditimit, përsa i takon mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave dhe pasurive të trashëgimisë kulturore, janë analizuar gjithashtu dhe shpenzimet/fondet e planifikuara dhe realizuara, të pasqyruara në buxhetet e Bashkive Berat, Gjirokastrë, Pogradec, Durrës, Rrogozhinë dhe Fier.

Periudhën 2020 – 2024 veprimtaria e secilit prej institucioneve të përzgjedhura, bazuar te funksionimi i tyre dhe të dhënat përkatëse të shqyrtuara, paraqitet si vijon:

❖ *Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit*

Përsa i takon financimit dhe fondeve buxhetore të targetuara për trashëgiminë kulturore, fokusi kryesor që përcaktohet edhe te Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025, është se kjo e fundit ka për qëllim përqendrimin e vëmendjes te arti dhe kultura, përmes transformimit të këtij sektori në industri kulturore dhe krijuese, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social. Nëpërmjet politikave kulturore, ndërsektoriale dhe veprimeve të drejtpërdrejta në ngritjen e kapaciteteve njerëzore të këtij sektori, synohet krijimi i kushteve të favorshme për rritjen e stimujve për sektorin kulturor dhe kreativ, si dhe inkurajimi i investimeve private në art, kulturë, trashëgimi kulturore dhe industri kreative.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025, parashikimi i PBA-së për periudhën 2020 – 2022 mbi vlerat e investimeve, paraqitet si vijon:

Tabela 2: Parashikimet e PBA 2020-2022 (Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025)

Viti	Shuma	Përqindja % ndaj totalit	Si % e PBB
2020	2,015,000,000	34,6%	0,12%
2021	2,025,000,000	32%	0,11%
2022	2,026,500,000	33,4%	0,11%
TOTALI	6,066,500,000		

Burimi: Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025

Dokumenti strategjik ka si synim vazhdimësinë e investimeve në zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e artit dhe trashëgimisë kulturore.

Në Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025, përcaktohet se për realizimin e masave dhe objektivave të paraqitura, përveç buxhetit të Ministrisë së Kulturës janë parashikuar jo vetëm financimet nga buxhetet e institucioneve qendrore dhe vendore, veprimtaria e të cilave ndikon direkt apo indirekt në sektorin e kulturës, por edhe financimet nga Bashkimi Evropian dhe donatorët e ndryshëm. Parashikimet e përmbledhura në tabelën nr. 3 paraqesin periudhën dhe koston e zbatimit të planit të veprimit për periudhën 2019 – 2025 të ndara sipas objektivave specifike:


Tabela 3: Periudha dhe kosto e zbatimit të planit të veprimit sipas objektivave specifike, vitet 2019 – 2025

Objektivat Specifikë	Kosto Totale	Buxheti	Donatorët	Hendeku
	lekë '000	lekë '000	lekë '000	lekë '000
TOTALI	9,608,638	6,088,965	3,041,439	478,234
1. Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës	233,199	72,643	70,074	90,482
2. Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara	4,461,982	1,588,014	2,581,445	292,523
3. Promovimi i vlerave të artit dhe të trashëgimisë kulturore	621,769	318,885	299,885	3,000
4. Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, të produkteve, si dhe të cilësisë artistike	4,244,403	4,062,139	90,035	92,229
5. Ndërtimi i publikut / zhvillimi i audiencës	47,285	47,285		

Burimi: Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025

Ndërsa vlerat e planifikuara dhe realizuara të shpenzimeve totale për Ministrinë e Kulturës, duke evidentuar përqindjet e realizimit (fakti) ndaj totalit të planifikuar për secilin vit paraqiten në grafikun në vijim.


Grafiku nr.1: Buxheti i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për periudhën 2020 -2024



Burimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përpunoi grupi i auditimit të KLSH-së

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar pjesë e MEKI, kemi vetëm vlerën totale të fondeve buxhetore të planifikuara dhe realizuara për trashëgiminë kulturore, sipas viteve të paraqitura në vijim.

Grafiku nr.2: Fondet buxhetore Plan - Fakt "Për trashëgiminë kulturore", Ministria e Kulturës, periudha 2020 – 2024



Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MEKI, përpunoi grupi i auditimit të KLSH-së.

Financimi për trashëgiminë kulturore⁸¹ që përfshin fondet për hulumtimin, dokumentimin, përzgjedhjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin, ekspozimin, prezantimin dhe përhapjen e trashëgimisë kulturore sigurohen nëpërmjet buxhetit të shtetit, buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo burim tjetër i ligjshëm nga persona juridikë apo fizikë, vendas ose të huaj, përfituar në formën e donacioneve ose sponsorizimeve. Është përgjegjësi e Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore të vlerësojë projektet e propozuara, të paraqitura nga institucionet e fushave përkatëse, ndërsa MEKI është përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e këtyre projekteve, në baza proporcionale, nga buxheti i saj.

Gjithashtu, për të siguruar ruajtjen e vlerave kulturore materiale pranë MEKI-t duhet të krijohet "Fondi kombëtar i kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale"⁸², në formën e një fondi financiar publik, që mbështet politikën kombëtare të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore materiale. Burimet e financimit të këtij fondi janë:

- të ardhurat e krijuara nga vendet e artit e të kulturës, në kuptim të këtij ligji, si dhe muzetë;
- financime vendase apo të huaja për këtë qëllim, të cilat burojnë në mënyrë të ligjshme nga organizata publike, private ose persona fizikë;
- buxheti i shtetit.

Ligji për trashëgiminë kulturore⁸³ i miratuar më 17.05.2018, ka parashikuar që disa nga aktet nënligjore për zbatimin e tij të miratohen brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, konkretisht, Këshilli i Ministrave duhet të miratojë Vendimin për përcaktimin e rregullave të administrimit të Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore Materiale. Rezulton se, Vendimi i Këshillit të Ministrave, është miratuar më datë 17.09.2020, i ndryshuar më 26.01.2022⁸⁴, dhe Fondi me zë për objektin e auditimit është planifikuar dhe realizuar vetëm për vitin 2023-2024.

Na auditimi konstatohet se, MEKI nuk ka të dhëna lidhur me vlerën e zërave përbërës të Fondit, nuk është detajuar se sa është përqindja e të ardhurave të krijuara nga arti dhe kultura, financimet vendase apo të huaja si dhe përqindja nga buxheti i shtetit. Nga ky fond është identifikuar si vlerë e lidhur me objektin e auditimit vetëm bonusi i rijetëzimit i trajtuar në vijim.

Nga sa paraqitur më sipër rezulton se, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar pjesë e MEKI, zotëron vetëm vlerat totale plan dhe fakt të buxheteve për vitet 2020 – 2024 (të

⁸¹ Ligji 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 20.

⁸² Ligji 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 19.

⁸³ Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", neni 263 germa c.

⁸⁴ VKM nr. 737, datë 17.09.2020 "Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale", e ndryshuar me VKM nr. 61, datë 26.1.2022.

siguruara nga SIFQ), si dhe vetëm vlerën totale të fondeve buxhetore të planifikuara dhe realizuara për trashëgiminë kulturore (jo në mënyrë të detajuar). Bazuar në këto të dhëna vlera totale plan dhe fakt, nuk identifikohen⁸⁵ në mënyrë të detajuar (me zëra specifikë), se në cilat fusha janë adresuar shpenzimet buxhetore, referuar projekteve dhe investimeve për trashëgiminë kulturore. Si rrjedhojë e mos pasqyrit të të dhënave buxhetore me zëra të detajuara për fushën e pasurive dhe vlerave të trashëgimisë kulturore, rezulton se është e vështirë të identifikohen fondet e planifikuara në këtë fushë, për pasuritë e regjistruara në UNESCO dhe për ato në listën tentative.

Për sa i takon nivelit të të ardhurave të krijuara, nga ofrimi i shërbimeve dhe përdorimi i pasurive kulturore në administrim të MEKI-t ose institucioneve të specializuara në varësi të saj, për trashëgiminë kulturore gjatë periudhës 2020 – 2024, rezulton se nuk është i pasqyruar në buxhetin⁸⁶ e MEKI-t ky zë, sipas detajimeve përkatëse. Të ardhurat e krijuara nga vendet e artit e të kulturës, në kuptim të këtij ligji, si dhe muzetë, janë një nga burimet e financimit të fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale⁸⁷. Ky fond krijohet pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe administrohet sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, rezulton se nuk ka të dhëna lidhur me % (përqindjen) e të ardhurave⁸⁸ që janë përdorur në favor të trashëgimisë kulturore gjatë periudhës 2020 – 2024.

Nga ana tjetër rezulton se, parashikimet e PBA 2020 – 2022, lidhur me financimet në fushën e kulturës dhe objektivat e përcaktuara për to, të paraqitura te Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025, janë të pamatshme dhe të pa monitorueshme⁸⁹, si rrjedhojë e mos identifikimit të këtyre financimeve në buxhetin e Ministrisë së Kulturës.

Përsa i takon projekteve të lidhura specifikisht me fushën e trashëgimisë kulturore në aspektin e përgjithshëm, si dhe pasuritë e vendit tonë të regjistruara në UNESCO, vlera totale e tyre (në lekë) të targetuara për trashëgiminë kulturore në aspektin e përgjithshëm rezulton të jetë **4,179,492,591 lekë**. Nga kjo vlerë, investimet në projekte të targetuara për pasuritë e regjistruara në UNESCO, rezultojnë **2,930,648,838 lekë** (70% e vlerës totale të projekteve të trashëgimisë kulturore). Ndërsa pjesa tjetër e investimeve prej **1,248,843,753 lekë** (30% e vlerës totale të projekteve të trashëgimisë kulturore), është përdorur për projekte të trashëgimisë kulturore jo të regjistruara në UNESCO. Gjithashtu, vlen për tu theksuar se, përveç projekteve të trashëgimisë kulturore në monedhën lekë (ALL), janë edhe 2 (dy) projekte të tjera në monedha të huaja, si vijon (115,023 EUR dhe 213,260 USD), të cilat janë për pasuri jo të regjistruara në UNESCO. Të dhëna më të detajuara lidhur me investimeve në projekte të targetuara për trashëgiminë kulturore në aspektin e përgjithshëm paraqiten në (Aneksi nr.1) dhe nga ana tjetër investimet në projekte të targetuara vetëm për pasuritë e regjistruara në UNESCO paraqiten në (Aneksi nr.2).

⁸⁵ VKM nr. 737, datë 17.09.2020, ndryshuar me VKM nr. 61, datë 26.01.2022; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025; dhe Ligji 9936/2008.

⁸⁶ Ligji 27/2018, Neni 19, pika 2.a) dhe Neni 20, pika 4; VKM nr. 737, datë 17.09.2020, pika 2 dhe 3, ndryshuar me VKM nr. 61, datë 26.01.2022; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025.

⁸⁷ Ligji 27/2018, Neni 19, pika 2/a.

⁸⁸ Ligji 27/2018, Neni 19, pika 2.a) dhe Neni 20; pika 4; VKM nr. 737, datë 17.09.2020, ndryshuar me VKM nr. 61, datë 26.01.2022; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025.

⁸⁹ Ligji 27/2018, Neni 20; VKM nr. 737, datë 17.09.2020, ndryshuar me VKM nr. 61, datë 26.01.2022, Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025, Pjesa III: Zbatimi, Përgjegjësia e Institucioneve, Llogaridhënia, Raportimi dhe Monitorimi; si dhe Ligji 9936/2008.

○ **Bonusi i Rijetësimit - Fondi Kombëtar i Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale**

Bonusi i rijetësimit, pjesë e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale⁹⁰, është një nisëm e përvitshme e Ministrisë së Kulturës/ Qeverisë Shqiptare për restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve në qendra historike në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin. Kjo nismë është një ndihmë në formë granti, për të gjithë ata individë që janë pronarë të një objekti në qendrat historike të qyteteve dhe kanë iniciativën për ta zhvilluar më tej atë duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal⁹¹. Përfitimi i bonusit bazohet në Rregulloren e hartuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Për përcaktimin e procedurave të aplikimit, kriteret e vlerësimit për administrimin e Bonusit të Rijetësimit, pjesë e Fondit Kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”.

Përfitues për mbështetjen financiare, janë shtetasit shqiptarë pronarë/ posedues të ligjshëm/ qiramarrës të pasurive të paluajshme, projekti i të cilëve është miratuar nga KKTKM dhe është shpallur fitues i nismës “Bonusi i Rijetësimit”. Përfitues i kësaj nisme mund të jetë edhe aplikuesi, i cili plotëson të gjitha kriteret në këtë rregullore, pavarësisht nëse në momentin e shpalljes fitues ka nisur apo jo punimet.

Procedura e aplikimit për të përfituar nga programi “Bonus për rijetëzim” kryhet online në sistemin e-Albania⁹², shërbimi e-leje “Aplikim për leje ndërhyrje në pasuritë kulturore materiale dhe Bonus Rijetësimi”. Fazat që ndiqen janë si vijon:

- Aplikimet vijnë në vijim të shpalljes së thirrjes nga MEKI.
- Aplikimet e bëra, paraqiten në sistemin e-lejet të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) për tu administruar (regjistruar të dhënat e aplikantëve në databazën përkatëse), e më pas kalojnë për shqyrtim dhe miratim në KKTKM.
- Në përfundim të afatit të thirrjes vijohet me shqyrtimin dhe miratimin e aplikimeve.
- Aplikimet të cilat miratohen në KKTKM, përcillen pranë MEKI për vijim të procedurave.
- Në MEKI krijohet struktura përgjegjëse Ad – Hoc, me Urdhër të Ministrit të Kulturës, e cila shqyrton aplikimet për përfitimin e bonusit të rijetëzimit.
- Struktura ad-hoc në rast se konstaton mungesë të dokumentacionit të aplikimit, por jo më shumë se 50% e tij, brenda 5 (pesë) ditëve pune bën me dije aplikuesin për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Dokumentacioni i munguar duhet të dorëzohet nga aplikuesi brenda 5 (pesë) diteve pune. Nëse aplikuesi nuk e sjell të plotësuar dokumentacionin të plotë, humbet të drejtën për të qenë pjesë e “Bonusit të Rijetësimit”, por e vazhdon procesin për marrjen e lejes sipas procedurave të zakonshme të ofrimit të këtij shërbimi.
- Struktura ad-hoc brenda 45 ditësh nga data e përfundimit të afatit të Thirrjes bën vlerësimin e aplikimit referuar dokumentacionit shoqërues dhe projektit të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.
- Pas kësaj i paraqet për miratim ministrit listën me emrat e aplikuesve fitues dhe vlerën e financimit për mbështetje nga “Bonusi i Rijetëzim”, bën njoftimin e aplikuesve të përzgjedhur on-line⁹³, si dhe shpalljen e fituesve në faqen zyrtare online të Ministrisë së Kulturës.

Struktura përgjegjëse për të shqyrtuar aplikimet për përfitimin e bonusit të rijetëzimit ka qenë struktura Ad - Hoc e krijuar për secilin vit, bazuar respektivisht në Urdhër nr.101, datë 25.02.2022, nr. 1087 prot., “Për krijimin e strukturës Ad - Hoc për menaxhimin e fondit

⁹⁰ Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Neni 19 dhe 20; dhe VKM nr. 737, datë 17.09.2020, ndryshuar me VKM nr. 61, datë 26.01.2022.

⁹¹ <https://meki.gov.al/newsroom/shpallja-e-thirrjes-bonusi-i-rijetesimit-2/>

⁹² https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13702&simple_master=Y

⁹³ <https://e-albania.al/>

kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, si dhe Urdhër nr.193, datë 23.03.2023, nr. 1942/2 prot., “Për krijimin e strukturës Ad - Hoc për menaxhimin e fondit kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”.

Në vitin 2022 është kryer thirrja e parë e Bonusit të Rijetëzimit, ku bazuar në databazën e të dhënave të aplikantëve, rezultojnë gjithsej **95** aplikime, nga të cilat evidentohet se kanë aplikuar **92** aplikantë. Pjesa e mbetur prej 3 aplikimeve të tjera, pjesë e të dhënave në databazë, rezultojnë dublikime.

Në rregullore përcaktohet se përfitues për mbështetjen financiare janë individët, personat fizikë ose juridikë. Objekt i financimit janë ndërhyrjet si më poshtë:

- Ndërhyrje të *mirëmbajtjes dhe konservuese* në pasuritë e paluajtshme në pronësi private, të cilat ndikojnë në vlera dhe unitetin kompozicional të ansamblit historik urban/qendrave historike të tilla si: mirëmbajtje, restaurim çatie, fasada, muraturë, porta, dritare **deri në 1.000.000 lekë**.
- Ndërhyrje për restaurim/ rijetëzim të pjesshëm osë të plotë në pasuritë e paluajtshme, në pronësi private që janë pjesë përbërëse e ansambleve historike urbane, qendrave historike, zonave arkeologjike, ose kanë status pasuri kulturore si objekte të veçanta jashtë këtyre zonave ku mund të përfshihen edhe: instalimet elektrike, sanitare, mekanike, të mbrojtjes ndaj zjarrit, **deri në 5.000.000 lekë**.

Aplikimet për financim me karakter rijetëzues, mund të jenë, por pa u kufizuar si: guest house/ hotele, dyqan souvenir/ artizanati/ antikuari/ bizhuterish, librari, videoteka, galeri arti dhe mjete pune, punishte, gastronomi për produktet vendase, pikë informacioni për turistët, agjenci turistike.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për masat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potenciale për të përfituar nga mbështetja financiare e nënprogramit “Bonusi i Rijetëzimit”.

Gjatë periudhës 2022 – 2023 bazuar në vendimin e komisionit Ad – Hoc nr. 1087/11 prot., datë 29.07.2022 janë shpallur fitues 40 individë gjithsej. Ndërsa në urdhrin e nxjerrë nga Ministri i Kulturës në vitin 2022 janë financuar si fitues 39 individë gjithsej, bazuar në Urdhër nr. 511, datë 02.08.2023, nr. 1087/12 prot., “Për financimin me fonde publike të projekteve fituese të nismës Bonusi i Rijetëzimit për vitin 2022”. Vlera totale e financimit për përfituesit e bonusit të rijetëzimit për vitin 2022, e përcaktuar në urdhrin e mësipërm, ka qenë në vlerën **95,467,964 lekë**.

Nga 39 individë fitues gjithsej, për qytetet që janë të regjistruara në UNESCO si Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec janë shpallur fitues **21 individë** për rijetësimin e banesave dhe **2 individë** kanë përfituar bonus për dy projektet respektive “Qendra interaktive” dhe “Bujtina Agron Alikaj”.

Në vitin 2023 është kryer thirrja e dytë e Bonusit të Rijetëzimit, ku bazuar në databazën e të dhënave, rezultojnë gjithsej **173** aplikime, nga të cilat evidentohet se kanë aplikuar **168** aplikantë. Në pesë aplikimet e tjera, pjesë e të dhënave në databazë, rezultojnë **4** dublikime dhe **1** test.

Nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për vitin 2023 objekti i financimit është përcaktuar në Rregulloren “Për procedurat e aplikimit dhe kriteret e vlerësimit për administrimin e Bonusit të Rijetëzimit 2023 - 2024, pjesë e Fondit Kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, bazuar në ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Vendimin nr. 737, datë 17.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore”, i ndryshuar. Objekt i financimit kanë qenë ndërhyrjet si më poshtë:

- Ndërhyrje të *mirëmbajtjes dhe konservuese* në pasuritë e paluajtshme në pronësi private, të tilla si: mirëmbajtje, restaurim çatie, fasada, muraturë, porta, dritare, të cilat ndikojnë në vlera dhe unitetin kompozicional të ansamblit historik urban dhe qendrave historike financohen deri në **1.000.000 lekë (një milion)**.
- Ndërhyrje për restaurim/ rijetëzim të pjesshëm ku përfshihen edhe: instalimet elektrike, sanitare, mekanike, të mbrojtjes ndaj zjarrit, ose të plotë në pasuritë e paluajtshme, në pronësi private, që janë pjesë përbërëse e ansambleve historike urbane, qendrave historike (QH), zonës së mbrojtur në kufi me QH, që ka ndikim domethënës në peisazhin historik urban të saj, lagjeve të banuara brenda mureve rrethues të kalave, ose kanë statusin pasuri kulturore si objekte të veçanta jashtë këtyre zonave, financohen **deri në 6.000.000 lekë/vit**.

Gjatë periudhës 2023 – 2024 janë shpallur fitues dhe janë financuar 58 individë gjithsej, bazuar në Urdhër nr. 478, datë 31.07.2023, nr. 1342/11 prot., “Për miratimin e listës përfundimtare të aplikantëve të kualifikuar fitues në kuadër të programit bonusi i rijetësimi, thirrja II” dhe Urdhër nr. 506, datë 22.08.2023, nr. 4405 prot., “Për financimin me fonde publike të projekteve fituese në kuadër të programit bonusi i rijetësimi thirrja II”. Vlera totale e financimit për përfituesit e bonusit të rijetësimi, thirrja II është përcaktuar gjithsej **198,469,730 lekë**. Kjo vlerë është e ndarë në dy vite, për vitin 2023 vlera totale e financimit është përcaktuar në vlerën **142,513,529 lekë**; dhe për vitin 2024 vlera totale e financimit është përcaktuar në vlerën **55,956,200 lekë**.

Nga 58 individë fitues gjithsej, për qytetet që janë të regjistruara në UNESCO si Berat, Gjirokastrë janë shpallur fitues **29 individë** për rijetësimin e banesave.

Njëri prej aplikantëve është tërhequr nga përfitimi i bonusit të rijetëzimit. Ndërsa një aplikant tjetër është tërhequr nga përfitimi i bonusit të rijetëzimit pasi i është bërë pagesa 30% e fazës së parë. Si pasojë e paraqitjes së kërkesës për të hequr dorë nga përfitimi i bonusit të rijetëzimit, nga ana e Ministrisë së Kulturës është kërkuar që aplikanti të bëjë kthimin e vlerës prej 1,650,000 lekë, bazuar në Faturë për Arkëtim nr. 37, datë 04.11.2024.

Nga auditimi i **25 dosjeve** të përzgjedhura për periudhën 2022 – 2023 të individëve që janë shpallur fitues të bonusit të rijetëzimit, është konstatuar mungesë dokumentacioni si procesverbalet e punimeve, tabela e lëvizjes së volumeve, libri i kantjerit/ akt konstatime, leja e bashkisë, akti i dorëzimit të objektit, pasuri kulturore materiale, nga investitori tek zbatuesi i punimeve, librezat e masave, certifikata e cilësisë së materialeve të produkteve të përdorura, deklarata teknike e zbatuesit të punimeve etj., në **20 dosje, duke mos përmbushur kërkesat e duhura të dokumentacionit**⁹⁴, që dosja e aplikantit të përzgjedhur si fitues të bonusit të rijetëzimit, duhet të ketë.

Nga auditimi i **12 dosjeve** të përzgjedhura të periudhës 2023 – 2024, është konstatuar se në **12 dosje** kanë qenë pjesë të dokumentacionit vetëm tabela e prezantimit të aplikantit, vendimi i miratimit të KKTKM, relacioni teknik dhe shkresë projekt restaurimi/ mirëmbajtje/ rijetësimi banese.

Nr. total i dosjeve, për të dyja periudhat	260	
Nr. i dosjeve të përzgjedhura	54	
Periudha	2022 - 2023	2023 - 2024
Nr. dosjeve të përzgjedhura dhe të kërkuara	27	27
Nr. dosjeve paraqitur grupit të auditimit	25	12
Fitues të bonusit	18	12
Jo fitues (të pa miratuar)	7	-
Dosje me mungesë dokumentacioni	20	12

⁹⁴ Rregullorja “Për procedurat e aplikimit dhe kriteret e vlerësimit për administrimin e Bonusit të Rijetëzimit, pjesë e Fondit Kombëtar të kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale”, Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM nr. 737, datë 17.09.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore”, ndryshuar me VKM nr. 61, datë 26.01.2022.

❖ *Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore*

Detyra themelore e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Në funksion të përmbushjes së misionit të saj, IKTK merr të gjitha masat që sigurojnë gjurmimin, hulumtimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK-ja, aktivitetin e saj e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e saj.

Për vitin 2020 vlera totale faktike prej **190,174,800 lekë** e cilësuar si “Shpenzime kapitale rindërtimi” pjesë e llogarisë së investimeve 230, është detajuar duke përcaktuar përdorimin e këtij fondi si vijon:

- Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 4 objekte kulti pasuri kulturore", në vlerën **4,600,000 lekë**.
- Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 8 objekte pasuri kulturore dhe muze në Bashkinë Durrës", në vlerën **34,000,000 lekë**.
- Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 5 objekte pasuri kulturore", në vlerën **73,000,000 lekë**.
- Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 9 objekteve institucione publike në Bashkinë Tiranë", **29,422,600 lekë**.
- Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 12 objekteve në Bashkinë Tiranë, Krujë, Lezhë, Kavajë, Mirditë", **23,700,000 lekë**.
- Hartimi i Raporteve të Vëzhgimit Arkeologjik në 24 Zonat e Reja të Zhvillimit, në vlerën **7,983,500 lekë**.
- Kryerja dhe Hartimi i Raporteve të Sondazheve Arkeologjike në 2 Zonat e Reja të Zhvillimit, në vlerën **17,468,700 lekë**.

Vlera totale faktike prej **11,633,155 lekë** e cilësuar si “Shpenzime kapitale” pjesë e llogarisë së investimeve 231 është detajuar duke përcaktuar përdorimin e këtij fondi konkretisht si vijon:

- Restaurim i Kishës së Shën e Premtes në fshatin Vlash, Faza II, Gjinar, Elbasan në vlerën **3,874,024 lekë**.
- Restaurim i kishës së Shën Ilias Stegopull në vlerën **7,759,131 lekë**.

Vlera totale faktike prej **1,484,280 lekë** e cilësuar si “Shpenzime kapitale Projekti MoNa” pjesë e llogarisë së investimeve 231 është detajuar duke përcaktuar përdorimin e këtij fondi konkretisht si parafinancim për projektin IPA “MoNa”, Realizimi i punimeve të konservimit dhe drenazhimit në Portës me kulla dhe Nimfeu, qyteti antik Butrint në vlerën **1,484,280 lekë**.

Për vitin 2021 vlera totale faktike prej **31,600,000 lekë** e cilësuar si “Investime gjithsej” pjesë e llogarisë së investimeve 230, që përfaqëson projekte të financuara nga buxheti i shtetit, është detajuar duke përcaktuar përdorimin e këtij fondi konkretisht si vijon:

- Hartim projekti “Plani i konservimit, Ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në objektin Muri i Kalasë Durrës (pa Kullën C por me Kullën Veneciane Durrës)”, në vlerën **7,800,000 lekë**.

- Hartim projekti “Plani i konservimit, Ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në objektin Kalaja e Prezës (përfshirë Xhaminë në Kalanë e Prezës, duke përfshirë 2 Kullat dhe murin verilindor të kalasë)”, në vlerën **22,000,000 lekë**.
 - Hartim projekti "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në objektet "2 (dy) objekte banimi brenda Kalasë së Krujës, brenda Zonës Arkeologjike “A” të qytetit të Krujës vlerësuar me nivel dëmi DS4 (Nr. 54 dhe Nr. 66)", në vlerën **1,800,000 lekë**.
- Vlera totale faktike prej **4,981,953 lekë** e cilësuar si “Investime gjithsej” pjesë e llogarisë së investimeve 231 është detajuar duke përcaktuar përdorimin e këtij fondi konkretisht si vijon:
- Parafinancim për projektin IPA “MoNa”, Realizimi i punimeve të konservimit dhe drenazhimit në Portës me kulla dhe Nimfeu, qyteti antik Butrint, në vlerën **1,375,843 lekë**.
 - Restaurim “Kisha e Shën e Premtes” Lukovë, në vlerën **3,606,110 lekë**.

Për vitin 2022 vlera totale faktike prej **1,025,570 lekë** e cilësuar si “Shpenzime nga sponsorizimet donacionet” pjesë e llogarisë 602 për “Plani i menaxhimit Berat, Gjirokastrë UNESCO (2021), është realizuar në nivelin 62%, referuar vlerës së planifikuar prej **1,655,285 lekë**.

Për vitin 2023 vlera totale prej **41,661,848 lekë**, që përfaqëson projekte që përfshijnë, restaurime, rikonstrukcione, të financuara nga Buxheti i Shtetit pjesë e llogarisë së investimeve 231, është detajuar duke përcaktuar përdorimin e këtij fondi si vijon:

- Projekt restaurimi "Kisha e Ungjillizimit në Kozare", në vlerën **14,846,040 lekë**.
- Projekt restaurimi "Shën Kolli Shelcan" (faza e parë), në vlerën **3,960,000 lekë**.
- Projekt restaurimi "Shën Mëhilli, Mingul" Lunxhëri - Gjirokastrë, në vlerën **9,046,320 lekë**.
- Projekt restaurimi "Kisha e Shën Mërisë", Barmash – Ersekë, në vlerën **6,443,087 lekë**.
- Projekt Restaurimi "Ura në fshatin Postenan", në vlerën **3,395,952 lekë**.
- Projekt konservimi dhe restaurimi i kullave dhe kurtinave midis tyre, Kalaja e Beratit (segmenti 12-12), në vlerën 3,970,449 lekë.

Përsa i takon të dhënave nga realizimi i shpenzimeve për investime (pjesë e llogarisë së investimeve 231) nga ana e IKTK-së, për periudhën Janar – Dhjetor 2023, nga të cilat vlera e planifikuar paraqitet **34,222,772 lekë** dhe vlera e investimeve të realizuara (fakti) paraqitet **30,141,670 lekë**. Përqindja e realizimit rezulton në nivelin **88.1%**.

Në Aneksin nr. 3 paraqiten emërtimet e disa projekteve të financuara nga donatorët (vetëm për qendrat historike pjesë në UNESCO), pa pasur një specifikë për vlerën monetare të tyre. Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, gjatë viteve 2020 – 2023, ka arritur këto nivele të realizimit të investimeve:

- Gjatë vitit 2020 ka arritur një realizim të shpenzimeve për investime jo materiale në nivelin 80% dhe 100% investime materiale.
- Gjatë vitit 2021 ka arritur një realizim të shpenzimeve për investime jo materiale në nivelin 69% dhe investime materiale në nivelin 95%.
- Gjatë vitit 2022 ka arritur një realizim të shpenzimeve për investimin Plani i menaxhimit Berat, Gjirokastrë UNESCO, në nivelin 62%.
- Gjatë vitit 2023 ka arritur një realizim të shpenzimeve për investime në nivelin 88.1%.


❖ **Bashkia Berat**

Në buxhetin e Bashkisë Berat, për vitet 2020 – 2024, nuk ka pasur fonde të planifikuara⁹⁵ për vlerat dhe pasuritë pjesë e trashëgimisë kulturore të regjistruara në UNESCO.

⁹⁵ Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Neni 20; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025; Ligji nr. 139/2015, Neni 25 dhe Ligji 9936/2008.

- Bashkia Berat për vitin **2020** ka pasur vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore” prej **40,085 mijë lekë**, nga të cilat totali i realizimit (fakti) ka rezultuar në vlerën prej **24,541 mijë lekë**. Përqindja e realizimit për këtë zë ka qenë në vlerën **61%** krahasuar me planifikimin.
- Bashkia Berat për vitin **2021** ka pasur vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore” prej **45,646 mijë lekë**, nga të cilat totali i realizimit (fakti) ka rezultuar në vlerën prej **23,680 mijë lekë**. Përqindja e realizimit për këtë zë ka qenë në vlerën **52%** krahasuar me planifikimin.
- Bashkia Berat për vitin **2022** ka pasur vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore” prej **58,553 mijë lekë**, nga të cilat totali i realizimit (fakti) ka rezultuar në vlerën prej **36,761 mijë lekë**. Përqindja e realizimit për këtë zë ka qenë në vlerën **63%** krahasuar me planifikimin.
- Bashkia Berat për vitin **2023** ka pasur vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore” prej **57,036 mijë lekë**, nga të cilat totali i realizimit (fakti) ka rezultuar në vlerën prej **46,905 mijë lekë**. Përqindja e realizimit për këtë zë ka qenë në vlerën **82%** krahasuar me planifikimin.

Grafiku nr.3: Plani dhe fakti i “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore”, vitet 2020 – 2023 (në 000/lekë)



Burimi: Bashkia Berat, përpunoi grupi i auditimit të KLSH-së.

Bashkia Berat për vitin **2024** ka pasur vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Turizmi, Kultura dhe Sportet” prej **101,566,920 lekë**. Vlera totale e planifikimit të buxhetit për këtë vit rezulton **812,805,959 lekë**. Zëri “Turizmi, Kultura dhe Sportet” përbën **12.5%** të vlerës totale të planifikimit buxhetor për vitin 2024.

❖ **Bashkia Gjirokastrë**

Në buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë, për vitet 2020 – 2024, nuk ka pasur fonde të planifikuara⁹⁶ për vlerat dhe pasuritë pjesë e trashëgimisë kulturore të regjistruara në UNESCO. Për vitet **2020, 2021 dhe 2023** nuk ka të dhëna të detajuara për sa i takon fondeve buxhetore të planifikuara për pjesën e trashëgimisë kulturore. Vlera totale e realizimit faktik të buxhetit të vitit **2020** ka qenë **779,481,074 lekë**.

Bashkia Gjirokastrë për vitin **2023** ka pasur në buxhet vlerën totale të planifikuar për zërin “Turizmi, trashëgimia, arti, kultura dhe sportet” prej **190,859,124 lekë**, nga të cilat vlera totale e realizimit ka rezultuar në vlerën prej **111,300,655 lekë**. Përqindja e realizimit për këtë zë ka qenë në vlerën **58%** krahasuar me planifikimin.

Bashkia Gjirokastrë për vitin **2024** ka pasur vlerë buxheti të planifikuar për zërin “Turizmi, trashëgimia, arti, kultura dhe sportet” prej **73,847 mijë lekë**. Vlera totale e planifikimit të

⁹⁶ Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Neni 20; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025; Ligji nr. 139/2015, Neni 25 dhe Ligji 9936/2008.

buxhetit për këtë vit rezulton **809,275 mijë lekë**. Zëri “Turizmi, trashëgimia, arti, kultura dhe sportet” përbëjnë 9.13% të vlerës totale të planifikimit buxhetor për vitin 2024.

Përsa i takon projekteve të financuara nga institucione si FSHZH dhe Ministria e Kulturës, për qytetin e Gjirokastrës, paraqitur në Aneksin nr.4, nuk ka vlera të specifikuar se sa pjesë e fondit është përdorur për zërat që paraqiten në tabelën vijuese për secilin vit, por është paraqitur vetëm vlera totale e kontratës.

Gjatë periudhës 2020 - 2024 është realizuar në nivelin 100% objekti “Rikonstruksion i rrugës “Kapo Baco” në vlerën **6,652,728 lekë**, e cila është pjesë e zonës së mbrojtur. Financimet nga donatorë të huaj apo vende të Bashkimit Evropian, që ka përfituar Bashkia Gjirokastrë për periudhën gjatë viteve 2020 – 2024, kanë qenë në vlerën 78,000 EUR nga UNESCO.

❖ **Bashkia Pogradec**

Në buxhetin e Bashkisë Pogradec, për vitet 2020 – 2024, nuk ka pasur fonde të planifikuara⁹⁷ për vlerat dhe pasuritë pjesë e trashëgimisë kulturore të regjistruara në UNESCO. Gjatë kësaj periudhe, Bashkia Pogradec ka qenë përfituese e fondeve të Bashkimit Evropian në fushën e kulturës, turizmit dhe trashëgimisë kulturore nga një projekt ndërkufitar, Programi i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Republikës së Shqipërisë, nën instrumentin e para anëtarësimit (IPA II), alokimi për vitet 2018 - 2020⁹⁸.

Projekti emërtohet "Struga & Pogradeci për promovimin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore COOLTOUR". Fokusi i projektit ka qenë zhvillimi i potencialit turistik për promovimin e trashëgimisë dhe vlerave kulturore. Vlera totale e tij rezulton 253,182 EUR, nga të cilat Bashkia e Pogradecit ka qenë bashkë financuese për vlerën 77,894.52 EUR. Fillimi i implementimit të projektit ka qenë data 01.01.2022 me një kohëzgjatje prej 36 muaj.

Një ndër aktivitetet kryesore të projektit, është edhe rivitalizimi i mureve të kalasë së qytetit të Pogradecit, e cila është një procedurë e ndjekur nga Bashkia Pogradec, bazuar në marrëveshjen e grantit për zbatimin e procedurave të PRAG. Siç përshkruhet në kontratën e grantit IPA/2021/429-005, kostot totale të pranueshme përlogariten në vlerën 955,760.94 EUR, nga të cilat autoriteti kontraktor merr përsipër të financojë një shumë maksimale prej 799,971.91 EURO. Gjithashtu, është realizuar mirëmbajtja e Muzeut të qytetit, në vlerën **993,228 lekë**.

Punime në të cilat DRTK Korçë ka investuar me projekt të miratuar mirëmbajtje, është ndërhyrja në Bazilikën e Linit, e realizuar gjatë vitit 2020, në vlerën **231,108 lekë**.

Lidhur me planifikimin buxhetor të vitit **2024**, nga situacioni evidentohet se ka vetëm një zë të buxhetit “Trashëgimia kulturore në fokusin e të rinjve” në vlerë prej **120,000 lekë**. Vlera totale e planifikimit të buxhetit për vitin 2024 rezulton në vlerën prej **806,190,160 lekë**. Zëri “Trashëgimia kulturore në fokusin e të rinjve” përbën vetëm 0.015% të vlerës totale të planifikuar të buxhetit vjetor.

❖ **Bashkia Durrës, Rrogozhinë, Fier**

Në buxhetin e Bashkisë Durrës, Rrogozhinë dhe Fier, për vitet 2020 - 2024 nuk kanë fonde të planifikuara⁹⁹ për vlerat dhe pasuritë e vendit tonë pjesë e listës tentativë.

Në përfundim të analizimit të të dhënave rezulton se:

⁹⁷ Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Neni 20; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025; Ligji nr. 139/2015, Neni 25 dhe Ligji 9936/2008.

⁹⁸ Grant Contract - External Actions of the European Union - Contract Nr: IPA/2021/429-005.

⁹⁹ Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Neni 20; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025; Ligji nr. 139/2015, Neni 25 dhe Ligji 9936/2008.

- Në buxhetin e Bashkive Berat/ Gjirokastrë/ dhe Pogradec, për vitet 2020 – 2024, nuk ka pasur fonde të planifikuara për vlerat dhe pasuritë pjesë e trashëgimisë kulturore të regjistruara në UNESCO.
- Në buxhetin e Bashkisë Durrës/ Rrogozhinë/ dhe Fier, për vitet 2020 - 2024 nuk kanë fonde të planifikuara për vlerat dhe pasuritë e vendit tonë pjesë e listës tentativë.

Gjetje nga auditimi:

7. Gjetje nga auditimi: Bashkëpunimi midis Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore objekt auditimi, nuk është në nivelet e duhura. Bashkitë objekt auditimi përgjithësisht nuk kanë fare informacion lidhur me rekomandimet e UNESCO-s apo çështje të tjera që prekin pasuritë kulturore / kulturore natyrore në territorin e tyre. Nuk dokumentohet të ketë komunikime të vazhdueshme midis strukturave, për problematika që kanë të bëjnë me pasuritë pjesë e listave të UNESCO-s apo pjesë e listës tentative dhe adresimin e tyre.

8. Gjetje nga auditimi: Fondi Kombëtar i Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale që duhej të krijohet pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në vitin 2019, është krijuar në vitin 2022. MEKI nuk ka të dhëna lidhur me vlerën e zërave përbërës të Fondit, konkretisht nuk është detajuar se sa është përqindja e të ardhurave të krijuara nga arti dhe kultura, financimet vendase apo të huaja, si dhe përqindja nga buxheti i shtetit. Nga ky fond është identifikuar që për mbrojtjen e pasurive kulturore me rëndësi universale është përdorur vetëm “bonusi i rijetëzimit” në vlerën 95,467,964 lekë për vitin 2022 dhe 198,469,730 lekë për vitet 2023-2024.

9. Gjetje nga auditimi: Në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për periudhën 2020 – 2024, nuk rezultojnë të planifikuara fonde për mbrojtjen e pasurive dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të regjistruara në UNESCO dhe pasurive në listën tentative. Gjithashtu, në buxhet nuk është i pasqyruar niveli i të ardhurave të gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve dhe përdorimi i pasurive kulturore, në administrim të Ministrisë së Kulturës ose institucioneve të specializuara në varësi të saj. Për më tepër, nuk është i identifikuar as niveli i përdorimit të këtyre të ardhurave për pasuri dhe vlera të trashëgimisë kulturore.

10. Gjetje nga auditimi: Në buxhetet vjetore të Bashkisë Berat/ Gjirokastrë/ Pogradec, për periudhën 2020 – 2024, nuk rezultojnë të planifikuara fonde buxhetore të adresuara për pasuritë e trashëgimisë kulturore të qyteteve respektive, të cilat janë të regjistruara në UNESCO.

11. Gjetje nga auditimi: Në buxhetet vjetore të Bashkisë Durrës/ Rrogozhinë/ dhe Fier, për periudhën 2020 – 2024, nuk rezultojnë të planifikuara fonde buxhetore të adresuara për pasuritë e trashëgimisë kulturore të qyteteve respektive, të cilat janë pjesë e listës tentative.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të aplikantëve për përfitimin e bonusit të rijetëzimit, të përzgjedhura për dy periudha 2022 – 2023 dhe 2023 – 2024, rezultoi se:

- Në 25 dosje që i janë paraqitur grupit të auditimit (nga 27 të përzgjedhura/ kërkuara) për periudhën 2022 – 2023, të individëve që janë shpallur fitues të bonusit të rijetëzimit, është konstatuar mungesë dokumentacioni (procesverbalet e punimeve, tabela e lëvizjes së volumeve, libri i kantierit/ akt konstatime, leja e bashkisë, akti i dorëzimit të objektit, pasuri kulturore materiale, nga investitori tek zbatuesi i punimeve, librezat e masave, certifikata e cilësisë së materialeve të produkteve të përdorura, deklarata teknike e zbatuesit të punimeve etj.), duke mos përmbushur kërkesat e duhura të dokumentacionit, që dosja e çdo aplikanti fitues duhet të ketë.

- Në 12 dosje që i janë paraqitur grupit të auditimit (nga 27 të përzgjedhura/ kërkuara) për periudhën 2023 – 2024, është konstatuar se kanë qenë pjesë të dokumentacionit vetëm tabela e prezantimit të aplikantit, vendimi i miratimit të KKTKM, relacioni teknik dhe shkresë projekt restaurimi/ mirëmbajtje/ rijetësimi banese, duke mos përmbushur kërkesat e duhura të dokumentacionit, që dosja e çdo aplikanti duhet të ketë.

Konkluzione:

5. Konkluzion: Mungesa e bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore, nëse nuk është e koordinuar dhe e programuar, cenon efektivitetin e masave që duhet të merren në zbatim të legjislationit, që synojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale.

6. Konkluzion: Politikat kombëtare të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore materiale nuk kanë mbështetjen financiare të nevojshme. Parashikimet në Strategjinë Kombëtare të Kulturës apo në kuadrin ligjor për ruajtjen e vlerave kulturore materiale, nuk garantojnë marrjen e masave efikase dhe aktive për mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Institucionet në nivel qendror dhe vendor nuk kanë fonde të planifikuara direkt për pasuritë kulturore dhe kulturore natyrore materiale dhe jomateriale me rëndësi universale, si për ato të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore dhe ato në Listën Tentative.

Rekomandime:

7.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrë masa për të krijuar një bashkëpunim më efektiv me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore që kanë pasuri kulturore / kulturore natyrore në territorin e tyre pjesë e listave të UNESCO-s, duke dokumentuar komunikimin për çdo çështje, problematikë apo rekomandime të UNESCO-s që i përkasin pasurive me vlera të jashtëzakonshme universale.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrë masa që të krijojë Fondin Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe të dokumentojë në mënyrë të detajuar zërat përbërës të tij, si dhe të identifikojë e monitorojë përdorimin e këtij fondi në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore materiale.

Brenda datës 31.12. 2025 dhe në vijimësi

9.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit - Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që të planifikojë në buxhetin vjetor fonde të cilat të identifikohen si zëra specifikë, duke u adresuar për financime dhe investime të trashëgimisë kulturore në tërësi, si dhe pasurive që janë pjesë e UNESCO-s dhe atyre në listën tentative.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1 Rekomandimi: Bashkia Berat/ Gjirokastrë/ dhe Pogradec të marrë masa që të planifikojë në buxhetin vjetor fondet të cilat të identifikohen si zëra specifikë, duke u adresuar për financime dhe investime për pasuritë e trashëgimisë kulturore, që ndodhen në territorin e secilit prej këtyre qyteteve dhe që janë të regjistruara në UNESCO.

Në vijimësi

11.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës/ Rrogozhinë/ dhe Fier të marrë masa që të planifikojë në buxhetin vjetor fondet të cilat të identifikohen si zëra specifikë, duke u adresuar për financime dhe investime për pasuritë e trashëgimisë kulturore, që ndodhen në territorin e secilit prej këtyre qyteteve dhe janë pjesë e listës tentative.


Në vijimësi

12.1 Rekomandim: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrë masa që, dosjet e individëve, të cilët aplikojnë për përfitim të bonusit të rijetësimi, si dhe ata që shpallen përfitues të bonusit, duhet të përmbushin kërkesat e duhura dhe të nevojshme të dokumentacionit, bazuar në Rregulloren që vetë MEKI ka hartuar për procedurën e aplikimit dhe vlerësimit të bonusit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2 A janë marrë masa që synojnë përfshirjen e vlerave dhe pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s?

Figura nr.3: Pasuritë e regjistruara në listat tentative



K'cimi i Tropojës, regjistruar në dhjetor 2024¹⁰⁰.

Vendi ynë duke njohur rëndësinë që ka ruajtja, mbrojtja apo konservimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale, si dhe duke marrë parasysh ndërvlerësinë midis trashëgimisë kulturore jomateriale dhe trashëgimisë materiale kulturore dhe natyrore apo rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, si përmbledhëse e diversitetit kulturor, ka ratifikuar dy konventa ndërkombëtare:

3. *Konventa lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore*, e cila ka si objektiv ruajtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të klasifikuara si të njëjti interes i jashtëzakonshëm dhe si rezultat është e nevojshme të ruhen si pjesë e trashëgimisë botërore të njerëzimit dhe si një e tërë.
4. *Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Paris 2003*, e cila ka si objektiv, ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, respektimin e trashëgimisë kulturore jomateriale të bashkësive, të grupeve dhe të individëve të prekur, si dhe sensibilizimin në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe të vlerësimit të saj të ndërsjellë.

Parë në këndvështrimin e detyrimeve që ka Shqipëria si shtet palë që ka ratifikuar këto dy konventa, në vijim do të trajtohet nëse janë marrë masat e duhura nga strukturat përgjegjëse për përfshirjen në Listën e Trashëgimisë Botërore të pasurive që janë në Listën Tentative, apo për të hartuar listat e elementëve për përfshirjen e pasurive të tjera kombëtare kulturore në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore.

¹⁰⁰ <https://meki.gov.al/>

Por, pse është e rëndësishme për një vend që të regjistrojë, pasuritë, vlerat, ritet etj., në listat e UNESCO-s?! Në momentin që një pasuri kulturore ose natyrore materiale ose jo materiale regjistrohet në Listën e Trashëgimisë Botërore, si fillim ndihmon në ndërgjegjësimin e institucioneve dhe të qytetarëve për rëndësinë që ka ruajtja e vlerave universale të kësaj trashëgimie kombëtare. Duke u ndërgjegjësuar strukturat shtetërore dhe komuniteti, kjo do të çonte në rritjen e përgjithshme të nivelit të mbrojtjes dhe ruajtjes. Gjithashtu, do të sillte një rritje të ndihmës financiare edhe nga organizmat ndërkombëtare. Ky zinxhir përfitimesh do të vijonte me një rritje të numrit të turistëve në këto rajone dhe me një rritje të ekonomisë së komunitetit përkatës.

Të vlerësosh trashëgiminë e një vendi me vlera të jashtëzakonshme universale nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e saj por lidhet edhe me konservimin e kësaj trashëgimie për njohje nga brezat e ardhshëm me qëllim që ato ta njohin, të krenohen dhe ta mbrojnë atë.

5.2.1 A janë marrë masat e duhura për përfshirjen në Listën e Trashëgimisë Botërore të pasurive që janë në Listën Tentative?

Për 4 (katër) pasuritë e regjistruara në Listën Tentative të UNESCO-s, Varret Ilire të Selcës (1996), Amfiteatri i Durrësit (1996), Qyteti Antik i Apollonisë (2014) dhe Kalaja e Bashtovës (2017), nuk ka një planifikim se kur do të paraqiten dosjet për kandidim në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore

Referuar Konventës për *Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore*, aktualisht vendi ynë ka të regjistruara në Listën Tentative të UNESCO-s 4 (katër)¹⁰¹ pasuri, ku 3 (tre) janë pasuri kulturore dhe 1 (një) është pasuri mikse (kulturore-natyrore) përkatësisht:

1. Kalaja e Bashtovës – 22.05.2017
2. Qyteti Antik i Apollonisë – 03.04.2014
3. Varret Ilire të Selcës – 11.10.1196
4. Amfiteatri i Durrësit – 11.10.1996

¹⁰¹ <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/?action=listtentative&state=al&order=states>

KALAJA E BASHTOVËS



Data e dorëzimit: 22.05.2017

Kriteri: (iv) "të jetë një shembull i jashtëzakonshëm i një lloji ndërtimi, një tërësi arkeologjike, teknologjike ose peizazhi që ilustron një fazë (disa faza) domethënëse në historinë njerëzore".

Kategoria: Kulturore

Paraqitur nga: Delegacioni i Përbërshëm i Shqipërisë në UNESCO

QYTETI ANTIK I APOLLONISË



Data e dorëzimit: 03.04.2014

Kriteri: (ii), (iii), (x)

(ii) "shfaqin një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore, në një hark kohor ose brenda një zone kulturore të botës, mbi zhvillimet në arkitekturë ose teknologji, artet monumentale, urbanistikën ose dizajnin e peizazhit";

(iii) "japin një dëshmi unike ose të paktën të jashtëzakonshme për një traditë kulturore ose për një qytetërim që jeton ose që është zhdukur";

(x) "përmbajnë habitatet natyrore më të rëndësishme dhe domethënëse për ruajtjen in-situ të diversitetit biologjik, duke përfshirë ato që përmbajnë specie në zhdukje me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja e shkencës ose e ruajtjes".

Kategoria: Mikse (kulturore-natyrore)

Paraqitur nga: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (ish Ministria e Kulturës)

Vendndodhja: Dërmenas, Fier

Nr. Referencës: 5885

Kalaja e Bashtovës¹⁰² është shumë e veçantë për disa arsye, ajo jo vetëm që kontrollonte bregdetin e Adriatikut të Shqipërisë qendrore, por edhe luginën e lumit Shkumbin. Kjo luginë kishte një rëndësi të madhe për shkak të rrugës antike "Via Egnatia", e cila kalonte pikërisht aty dhe lidhte perëndimin me lindjen. Kjo kështjellë është ndërtuar për të kontrolluar dhe ndoshta për të frenuar sulmet e Perandorisë Osmane kundër botës mesjetare perëndimore.

Qyteti Antik i Apollonisë¹⁰³, përfaqëson një nga qytetet më të rëndësishme të botës mesdhetare dhe të pellgut të Adriatikut, i ruajtur në një gjendje jashtëzakonisht të paprekur. Monumentet e shumta brenda kufijve të tij origjinalë përbëjnë një dëshmi të jashtëzakonshme të kulturës greko-romake të qytetit. Qyteti u themelua nga kolonistët grekë nga Korfuzi dhe Korinti, të cilët gjetën në territorin e tij një vendbanim të mëparshëm lokal me elementet e veta unike kulturore. Prania e kësaj kulture vendase përcaktohet nga zbulimi i objekteve arkeologjike të epokës së hekurit, trakteve nga një fortifikim arkaik ekzistues, tempulli i Artemidës si dhe nekropoli tumular pranë territorit të qytetit antik të Apollonisë. Bashkëjetesa midis dy kulturave të ndryshme dhe shkrirja e tyre e pashmangshme prodhoi një fizionomi unike të kulturës apoloniane, e cila e ktheu Apolloninë në një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike të botës

së lashtë mesdhetare.

¹⁰² <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/6259/>

¹⁰³ <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/5885/>

VARRET ILIRE TË SELCËS



Data e dorëzimit: 11.10.1996

Kriteri: (iii) "japin një dëshmi unike ose të paktën të jashtëzakonshme për një traditë kulturore ose për një qytetërim që jeton ose që është zhdukur".

Kategoria: Kulturore

Paraqitur nga: Instituti i Monumenteve të Kulturës

Vendndodhja: Selcë, Pogradec

Nr. Referencës: 909

AMFITEATRI I DURRËSIT



Data e dorëzimit: 11.10.1996

Kriteri: (iv) "të jetë një shembull i jashtëzakonshëm i një lloji ndërtimi, një tërësi arkeologjike, teknologjike ose peizazhi që ilustron një fazë (disa faza) domethënëse në historinë njerëzore".

Kategoria: Kulturore

Paraqitur nga: Instituti i Monumenteve të Kulturës

Vendndodhja: Durrës

Nr. Referencës: 910

Varret Ilire të Selcës¹⁰⁴ janë zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike të kryera në vitet 1964-1972, në një kodër ngjitur me fshatin Selcë në Mokër të Pogradecit. Ky habitat është projektuar gjatë periudhës së bronzit dhe ka vazhduar të jetë i tillë pa ndërprerje, edhe gjatë periudhës së hekurit. Gjatë shekullit VI-V para Krishtit, qyteti u zhvillua si qendër urbane në rrugën përgjatë Lumit Shkumbin. Varret Ilire të Selcës përbëhen nga katër varre monumentale princërisht të gdhendur në shkëmb. Në njërin prej këtyre varreve është zbuluar një inventar i pasur armësh, bizhuteri ari si dhe emblema që përfaqësojnë skena luftarake mitologjike.

Amfiteatri i Durrësit¹⁰⁵, është amfiteatri më i madh dhe më i rëndësishëm në Ballkan i ndërtuar në fillim të shekullit I-rë, i cili përmban vlera të shquara arkitekturore funksionale dhe konstruktive, i vetmi i këtij lloji i zbuluar në Shqipëri. Amfiteatri është në formën e një elipsi me diametër 136 m. Lartësia e shpellës duke filluar nga baza është 20 m.

Kapaciteti i tribunave ishte nga 15,000 deri në 20,000 spektatorë. Madhështia dhe arritja teknike e këtij amfiteatri dëshmon për lulëzimin e qytetit të Durrësit gjatë shekujve të parë të erës sonë. Pas ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike pas shekullit të IV-t, amfiteatri i Durrësit pushoi së funksionuari si i tillë. Në një nga galeritë e tij është ndërtuar në shekullin e X-të, një kishëz bizantine,

muret e së cilës janë zbukuruar me mozaikë që përfaqësojnë figura të ndryshme.

¹⁰⁴ <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/909/>

¹⁰⁵ <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/910/>

Regjistrimi në Listën e Trashëgimisë Botërore për pasuritë kulturore dhe natyrore¹⁰⁶

Bazuar në përcaktimet e udhëzuesit përkatës dhe rregullave të UNESCO-s që një pasuri të regjistrohet në Listat e Trashëgimisë Botërore duhet të kalojë në disa faza:

1. Regjistrimi në Listën Tentative

Procesi i nominimit për të regjistruar një pasuri kulturore apo natyrore në Listën e Trashëgimisë Botërore fillon me regjistrimin e pasurive në Listën Tentative. Hapi i parë që një shtet nënshkruet i konventës duhet të ndërmarrë është të bëjë inventarin e siteve më të rëndësishme kulturore dhe natyrore të territorit të tij. Ky lloj inventari mund të konsiderohet si Lista Tentative që përbën një planifikim lidhur me pasuritë që një shtet palë mund të vendosë të dorëzojë për regjistrim në 5 apo 10 vitet e ardhshme. Kjo listë mund të përditësohet vazhdimisht. Kjo fazë e procesit të nominimit është e rëndësishme pasi Komiteti i Trashëgimisë Botërore nuk e merr në shqyrtim nominimin e një pasurie për regjistrim në Listën e Trashëgimisë Botërore nëse pasuria nuk ka qenë e përfshirë në Listën Tentative të shtetit palë.

2. Përgatitja e dosjes së nominimit

Dosja e nominimit përgatitet për pasuritë e regjistruara në Listën Tentative pra duke përzgjedhur për regjistrim pasuri nga kjo listë. Lista tentative i shërben shtetit palë për të planifikuar se kur do të paraqesë një dosje për kandidim/nominim. Dosja e nominimit duhet të jetë e plotë në dokumentacion dhe shteruese. Nominimi i dorëzohet Qendrës së Trashëgimisë Botërore për shqyrtim dhe për të kontrolluar nëse është i plotë. Pasi përfundon ky proces, Qendra e Trashëgimisë Botërore ia dërgon dosjen organeve përkatëse këshillimore për vlerësim.

3. Organet Këshillimore

Dosja e nominimit të një pasurie të caktuar vlerësohet në mënyrë të pavarur nga dy Organe Këshillimore të mandatuara nga Konventa e Trashëgimisë Botërore: Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Vendet (ICOMOS) dhe Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), të cilët respektivisht i ofrojnë Komitetit të Trashëgimisë Botërore vlerësimet e objektet kulturore dhe natyrore të nominuara. Struktura e tretë këshilluese është Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurive Kulturore (ICCROM), një organizatë ndërqeveritare e cila i ofron Komitetit këshilla të ekspertëve për ruajtjen e vendeve kulturore, si dhe për aktivitetet e trajnimit.

4. Komiteti i Trashëgimisë Botërore

Pasi një pasuri/site është emëruar dhe vlerësuar, i takon Komitetit Ndërqeveritar të Trashëgimisë Botërore të marrë vendimin përfundimtar për regjistrimin. Një herë në vit, Komiteti mbledhet për të vendosur se cilat vende do të përfshihen në Listën e Trashëgimisë Botërore. Ai gjithashtu mund të shtyjë vendimin e tij dhe të kërkojë informacione të mëtejshme mbi pasuri/site nga shtetet palë.

5. Kriteret e përzgjedhjes

Për t'u përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore, pasuritë/sitet duhet të jenë me vlerë të jashtëzakonshme universale dhe të plotësojnë të paktën një nga dhjetë kriteret e përzgjedhjes. Këto kriteret shpjegohen në Udhëzimet Operacionale për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore.

Shqipëria si shtet palë nënshkruet i Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore¹⁰⁷ ka pranuar se përgjegjësia për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe transmetimin tek brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që

¹⁰⁶ <https://whc.unesco.org/en/nominations/>

¹⁰⁷ Konventë lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, Data e hyrjes në fuqi të konventës: 17.12.1975, Data e ratifikimit: 10.07.1989, Data e hyrjes në fuqi për Shqipërinë: 10.10.1989, neni 4.

ndodhet në territorin e saj, i përket kryesisht Shtetit Shqiptar. Regjistrimi i këtyre pasurive në Listën Tentative të UNESCO-s janë vetën hapat e para të punës që vendi ynë duhet të bëjë për të arritur në regjistrimin përfundimtar të tyre.

Referuar udhëzuesit të UNESCO-s¹⁰⁸, Shtetet Palë që kanë ratifikuar Konventën lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, inkurajohen të paraqesin listat e tyre tentative, për prona të cilat ata i konsiderojnë si trashëgimi kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale dhe për këtë arsye të përshtatshme për t'u regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Shtetet Palë duhet të paraqesin Listat Provuese, të paktën një vit përpara paraqitjes së çdo nominimi dhe inkurajohen të rishqyrtojnë dhe të riparaqesin listën e tyre tentative të paktën çdo dhjetë vjet.

Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale

Referuar Konventës për *Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale*, vendi ynë ka të regjistruar në listat përfaqësuese të UNESCO-s 2 (dy) elementë të trashëgimisë kulturore jomateriale:

1. **“K’cimi i Tropojës”**¹⁰⁹ (K’cimi Dancing of Tropojë), propozuar për regjistrim në Listat Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit, më 25 shtator 2023, **regjistruar në dhjetor 2024**¹¹⁰.

K’cimi i Tropojës, është një vallëzim karakteristik i zonës së Tropojës, i cili interpretohet në një shumëllojshmëri vallëzimesh, si vallet e dasmës, vallja e grave, vallja e burrave, vallja e nuseve të reja, vallëzimi e vajzave, vallja e shqiponjës dhe të tjera. K’cimi i Tropojës është një vallëzim festiv që praktikohet gjatë gjithë vitit, dhe veçanërisht gjatë ceremonive festive tradicionale, të tilla si dasma, fejesa, ditëlindje, festa fshati dhe raste të tjera shoqërore. Ritmi i tij është i shpejtë dhe i gëzueshëm. Njerëzit nuk e prekin njëri-tjetrit gjatë kërcimit, por kërcëjnë ballë për ballë. Lëvizjet janë vertikale, dhe kërcimtarët shpesh bëjnë kërcim-hedhje me një farë lartësie nga toka, duke i ngritur krahët lart dhe duke i shtrirë ata anash, ndërsa lëvizin rreth njëri-tjetrit në një hapësirë të kufizuar, duke mbajtur pozicionin ballë për ballë.

2. **“Arti i të luajturit, të kënduarit dhe bërjes së lahutës”**¹¹¹, propozuar për regjistrim në Listat e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Nevojë Urgjente për Ruajtje, më 28 mars 2024. Të kënduarit me lahutë është traditë muzikore e rrënjësuar thellë në jetën e komuniteteve që jetojnë në rajonet veriore dhe veriperëndimore të vendit, konkretisht në Lezhë, Shkodër, Tropojë e Malësi e Madhe. Këndimi është monofonik, i thellë, i ngjashëm me tonin e vajtimit duke ju dhënë këngëve një karakter të caktuar epik. Lahuta si traditë ka tre dimensione kyçe, luajtja e instrumentit, këndimi me të dhe bërja e saj, dhe në shumicën e rasteve praktikuesit i bëjnë të treja. Këngët që këndohen me lahutë zakonisht mbartin kuptime të forta dhe rrëfimet epike këndohen ekskluzivisht me shoqërimin e lahutës.

Regjistrimi në Listën e Trashëgimisë Botërore Jomateriale

1. Identifikimi

Shteti palë duhet të identifikojë dhe përcaktojë elementet e ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij, me pjesëmarrjen e bashkësive, të grupeve dhe të organizatave joqeveritare përkatëse.

2. Inventarët e trashëgimisë kulturore jomateriale

Shteti palë për të siguruar identifikimin me synim ruajtjen, harton një ose shumë inventarë të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij. Këta inventarë janë objekt i një përditësimi të rregullt.

¹⁰⁸ Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention, II.C Tentative List.

¹⁰⁹ <https://ich.unesco.org/en/files-2024-under-process-01303>

¹¹⁰ <https://meki.gov.al/>

¹¹¹ <https://ich.unesco.org/en/files-2025-under-process-01347>

3. Përgatitja e dosjes së nominimit

Shteti palë përgatit dosjen e nominimit për regjistrim të elementëve të trashëgimisë kulturore jomateriale në një nga listat e Ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Shkallë Botërore, konkretisht në:

- *Listën përfaqësuese të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit.*
Në dosjet e nominimit, kërkohet që shteti palë të demonstrojnë se një element i propozuar për regjistrim në këtë listë i plotëson të gjitha kriteret e vendosura.
- *Listën e trashëgimisë kulturore jomateriale që ka nevojë urgjente për ruajtje.*
Në rast urgjence ekstreme, Byroja e Komitetit mund të ftojë shtetin palë të paraqesë një element të caktuar për nominim në listën e trashëgimisë kulturore jomateriale në nevojë urgjente ruajtja në një afat më të përshpejtuar.

Nuk janë hartuar dhe miratuar plane masash apo plane zhvillimi për plotësimin e kriterëve për regjistrimin e pasurive kulturore materiale të Listës Tentative në Listën e Trashëgimisë Botërore.

- **Kalaja e Bashtovës** është përfshirë në projektin EU4Culture i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Programi synon rinovimin dhe rijetësimin e objekteve kryesore të trashëgimisë kulturore të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019 dhe përfaqëson një nga programet më të mëdha të trashëgimisë kulturore të financuar nga Bashkimi Evropian.

Në kuadër të këtij projekti për Kalanë e Bashtovës është:

- realizuar restaurimi i saj, stabilizimi dhe riparimi strukturor, konservimi dhe stabilizimi i platformave të ecjes, hyrja e kontrolluar nga një portë, dizajni i rrethimit mbrojtës, peizazhi urban përreth zonës, planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, sistemi elektrik, sistemi i mbikëqyrjes dhe sigurisë, qendër vizitorësh;
- hartuar Planin i Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë për Kalanë e Bashtovës dhe Planin i Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Planin i Biznesit.

- **Amfiteatri i Durrësit** është pjesë e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Albanian-American Development Foundation (AADF), MEKI-t dhe Bashkisë Durrës, për dizajnimin e projekteve për zonën qendrore të amfiteatrit, forumin bizantim-termat romake dhe shtigjet urbane, projekt i cili është në proces. Gjithashtu, Amfiteatri i Durrësit është pjesë e Planit të Menaxhimit të zonave arkeologjike A dhe B të Durrësit të miratuar me VKM nr. 831, datë 28.12.2023 “*Për miratimin e planit të menaxhimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit 2023-2030*”. Duke filluar që nga viti 2019 e në vijim në Amfiteatrin e Durrësit janë bërë investime për mirëmbajtje, konkretisht në vitin 2019 në vlerën 120,338 lekë, ndërsa për vitet 2020-2023, janë bërë shërbime vetëm për pastrim bari dhe mbeturinash me vlerat si vijon:

- Viti 2020 – 119,500 lekë
- Viti 2021 – 113,480 lekë
- Viti 2022 – 117,204 lekë
- Viti 2023 – 222,980 lekë

- **Qyteti Antik i Apollonisë** aktualisht është pjesë e projektit “Hyrja për në Parkun Arkeologjik të Apollonisë dhe Landscape brenda kufirit të parkut arkeologjik” me zhvillues Bashkinë Fier i miratuar me Vendim nr. 136, datë 31.05.2024 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Nga dokumentacioni dhe përgjigjet e pyetësorëve konstatohet se për periudhën 2020-2024, në Parkun Arkeologjik të Apollonisë kryhen periodikisht disa shërbime që konsistojnë në,

mirëmbajtje dhe riparime, shërbime elektrike dhe hidraulike për parqet, shërbime interneti për biletarinë, shërbime administrim faqe interneti, fletëpalosje etj.

Konstatohet që gjatë vitit 2019 janë realizuar restaurimi i mozaikut në “Vila e Athinasë” në Parkun Arkeologjik të Apolonisë në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimi midis ish Ministrisë së Kulturës, Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Fondacionit Flaminia, Itali, mirëmbajtje e murit rrethues të Manastirit, projekt restaurimi i Temenos.

- **Varret Ilire të Selcës** gjatë periudhës 2020-2024 me fonde të mirëmbajtjes nga DRTK, janë kryer mirëmbajtje, pastrime dhe sistemime territori.

Në referencë të sa trajtuar më sipër konstatohet se katër pasuritë rezultojnë të regjistruara në Listën Tentative duke filluar që nga viti 1996, Varret Ilire të Selcës dhe Amfiteatri i Durrësit, viti 2014 Qyteti Antik i Apolonisë dhe viti 2017 Kalaja e Bashtovës. Për periudhën objekt auditimi 2020-2024, në këto pasuri janë ndërmarrë disa projekte apo disa masa që lidhen me pastrime dhe sistemime territori, hartim planesh menaxhimi, apo restaurime. Nuk konstatohet që MEKI dhe strukturat vendore të kenë hartuar dhe miratuar plane masash apo plane zhvillimi me synim plotësimin e kriterëve për regjistrimin e këtyre pasurive kulturore materiale në Listën e Trashëgimisë Botërore. Fakti që këto katër pasuri kulturore materiale janë regjistruar në Listën Tentative tregon se Shteti Shqiptar i ka regjistruar ato në inventarin e pasurive kulturore të rëndësishme në territorin e tij. Regjistrimi në Listën Tentative është vetëm hapi i parë që duhet të ndiqet për të finalizuar regjistrimin përfundimtar, ajo përbën një planifikim lidhur me pasuritë që shteti palë mund të vendosë të dorëzojë për regjistrim në 5 apo 10 vitet e ardhshme dhe mund të përditësohet vazhdimisht.

Sikurse paraqitet edhe më sipër për të vijuar me regjistrimin e një pasurie Shqipëria duhet të përgatisë dosjen e nominimit duke përzgjedhur nga pasuritë e regjistruara në Listën Tentative. Nominimi i dorëzohet Qendrës së Trashëgimisë Botërore për shqyrtim dhe për të kontrolluar nëse është i plotë. Pasi përfundon ky proces, Qendra e Trashëgimisë Botërore ia dërgon dosjen organeve përkatëse këshillimore për vlerësim.

Gjetje nga auditimi:

13. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Fier dhe Pogradec, nuk kanë marrë asnjë masë konkrete për plotësimin e kriterëve për regjistrimin në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, të pasurive kulturore materiale që janë në Listën Tentative që nga vitet 1996-2017 (Varret Ilire të Selcës, Amfiteatri i Durrësit, Qyteti Antik i Apolonisë dhe Kalaja e Bashtovës). Masat e marra nga institucionet në nivel qendror apo në nivel vendor për periudhën 2020-2024 lidhur me këto katër pasuri, kanë konsistuar kryesisht në pastrime dhe sistemime territori, apo restaurime.

14. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk ka asnjë planifikim se kur do të paraqesë dosjet për kandidim/nominim për 4 (katër) pasuritë e regjistruara në Listën Tentative të UNESCO-s, Varret Ilire të Selcës (1996), Amfiteatri i Durrësit (1996), Qyteti Antik i Apolonisë (2014) dhe Kalaja e Bashtovës (2017). Konkretisht, nuk rezulton se për asnjërën nga katër pasuritë kulturore materiale të ketë filluar puna për përgatitjen e dosjes së nominimit.

Konkluzione:

7. Konkluzion: Regjistrimi i pasurive kulturore materiale kombëtare në Listën Tentative të UNESCO-s është një hap i rëndësishëm i procesit të regjistrimit në Listën e Trashëgimisë Botërore, por është vetëm fillimi. Puna që duhet të bëhet më tej për përgatitjen e dosjes së nominimit, është domethënëse për të finalizuar procesin. Regjistrimi i këtyre pasurive në Listën

Tentative që nga viti 1996, 2014 apo 2017 dhe mos marrja e asnjë mase në vijim për të avancuar në procesin e nominimit, tregon se nga institucionet shtetërore nuk është bërë aq sa duhet lidhur me ruajtjen e vlerave universale të këtyre trashëgimive kombëtare.

Rekomandime:

13.1 Rekomandim: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me NJQV-të të marrë masa për të hartuar dhe miratuar plane zhvillimi/menaxhimi si dhe për plotësimin e kriterëve për regjistrimin e pasurive kulturore materiale pjesë e Listës Tentative, në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Brenda datës 31.12.2025

14.1 Rekomandim: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të hartojë planin e masave të paraqitjes së dosjeve për nominim për pasuritë e regjistruara në Listën Tentative të UNESCO-s.

Brenda datës 31.12.2025

5.2.2 A janë hartuar listat e elementëve për përfshirjen e pasurive kombëtare kulturore në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s?

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk ka hartuar raportet për vlerësimin e nivelit të zbatimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Kulturën.

Trashëgimia kulturore e një vendi¹¹² përfshin pasurinë kulturore materiale dhe jomateriale, si një tërësi vlerash kulturore, mbartëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar, që kanë rëndësi shkencore ose kulturore. Vlerat kulturore janë “pasuri publike” dhe gëzojnë mbrojtje nga strukturat e qeverisjes qendrore e vendore në interesin më të mirë të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Për mbrojtjen e tërësisë së vlerave kulturore materiale dhe jomateriale është hartuar kuadri ligjor përkatës si dhe janë miratuar politika dhe strategji. Konkretisht Strategjia Kombëtare për Kulturën (SKK) 2019-2025, është e përqendruar në pesë qëllime dhe objektiva strategjike që lidhen me, trashëgiminë materiale dhe jomateriale kulturore, me përfaqësimin e vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë në aktivitete ndërkombëtare, mbështetjen e veprimtarive kulturore dhe artistike etj.

Më konkretisht, në qëllimet dy dhe tre të SKK përcaktohen:

- ✓ Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore, rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara;
- ✓ Nxitja, përfaqësimi dhe promovimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave më të mira.
 - a. 3.1 “Ndërkombëtarizimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore”;
 - b. 3.2.1 “Kandidimi në listat përfaqësuese të UNESCO-s”.

Disa nga aktivitetet që janë planifikuar të kryhen me synim realizimin e dy qëllime janë, zbatimi i projekteve të rijetëzimit të qendrave historike dhe qendrave muze, inventarizimi, katalogimi, digjitalizimi, etj., i pasurive kulturore të luajtshme apo të paluajtshme, si dhe

¹¹² Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë, neni 4.

përfshirja e pasurive kombëtare kulturore në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Nga auditimi konstatohet se nuk është bërë monitorimi i SKK, për të vlerësuar nivelin e arritjes së objektivave strategjike. Referuar SKK-së, Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave, Grupi Tematik për Kulturën dhe Turizmin është përcaktuar si struktura raportuese, monitoruese dhe vlerësuese për dokumentin strategjik. Kjo strukturë duhet që çdo gjashtë muaj, të përpilojë raportet për vlerësimin e nivelit të zbatimit të dokumentit strategjik me informacione për indikatorët e përcaktuar, arritjet, problematikat etj. Bazuar në raportet e monitorimit, duhet të rishikohet dhe përditësohet plani ekzistues për vitet e strategjisë me një frekuencë tre vjeçare. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor ka detyrën e sekretarisë për Komitetin Ndërmnistror për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën, i cili duhet të mbledhet çdo dy muaj për të raportuar dhe njoftuar për nivelin e zbatimit të masave.

SKK është në vitin e fundit të zbatimit dhe MEKI nuk ka një vlerësim mbi arritjen e objektivave të vendosura për periudhën 2019-2025. Treguesit që do të shërbenin si matës të arritjes së objektivit nr. 3 “*Nxitja, përfaqësimi dhe promovimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave më të mira*”, 3.1 “*Promovimi i trashëgimisë jomateriale kulturore*”, 3.1 “*Ndërkombëtarizimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore*”, 3.2.1 “*Kandidimi në listat përfaqësuese të UNESCO-s*” nuk janë vlerësuar dhe si rezultat nuk mund të konkludohet për matjen e nivelit të përmbushjes së objektivit/ave strategjike.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk ka hartuar listat e elementëve me të cilët mund të kandidohet në listat e UNESCO-s, si dhe nuk ka një listë të pasurive kulturore dhe natyrore materiale të klasifikuara si të njëjti interesi të jashtëzakonshëm.

Kuadri ligjor në fuqi parashikon një sërë masash që duhet të merren në vijimësi lidhur me atë që është objekt i temës së auditimit - përfshirja e vlerave kulturore materiale dhe jomateriale të vendit tonë në listat e UNESCO-s. Konkretisht, MEKI¹¹³ duhet të marrë masa për njohjen në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale, si dhe për regjistrimin, ndryshimin e emërtesave të këtyre vlerave në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s. Ky proces duhet të realizohet pasi të jetë bërë miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të propozimeve për regjistrimin e këtyre dukurive, mbështetur në kriteret e parashikuara nga konventa “Për ruajtjen e vlerave kulturore jomateriale”.

Pasuritë e regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore përfaqësojnë diversitetin dhe zhvillimin e historisë së njerëzimit në mijëvjeçarë. UNESCO ka identifikuar tre kategori të trashëgimisë kulturore dhe natyrore materiale - *pasuri kulturore* (tempull, amfiteatër, kala etj.), *pasuri natyrore* (si pyjet), *pasuri mikse* ku elementë të kulturës dhe natyrës ekzistojnë në një pasuri.

Ndërsa për trashëgiminë kulturore jomateriale UNESCO ka identifikuar këto kategori - dialektet dhe gjuhët e pakicave; artet performuese, muzika, vallëzimi dhe teatri; ritualet, festat dhe ceremonitë; njohuri dhe praktika në lidhje me natyrën dhe universin; njohuritë teknike dhe aftësitë e përdorura për prodhimin e zanateve tradicionale.

Është detyrë e MEKI-t¹¹⁴ që të propozojë për regjistrim në Listat e Trashëgimisë Botërore vlerat materiale dhe jomateriale të trashëgimisë kulturore kombëtare, që të ndërmarrë nisma për njohjen në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale duke hartuar listat e

¹¹³ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, neni 17.

¹¹⁴ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, neni 13, neni 17, Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025, faqe 29.

elementeve, me të cilat mund të kandidohet në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Shtetet Palë që kanë ratifikuar Konventën lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, inkurajohen të paraqesin listat e tyre tentative, për prona të cilat ata i konsiderojnë si trashëgimi kulturore dhe/ose natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale dhe për këtë arsye të përshtatshme për t'u regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore¹¹⁵. Shtetet Palë duhet të paraqesin Listat Provuese, të paktën një vit përpara paraqitjes së çdo nominimi dhe inkurajohen të rishqyrtojnë dhe të riparaqesin listën e tyre tentative të paktën çdo dhjetë vjet.

Për të siguruar identifikimin me synim ruajtjen, çdo shtet palë, në përputhje me gjendjen e tij, harton një ose shumë inventarë të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij. Këta inventarë janë objekt i një përditësimi të rregullt¹¹⁶.

Aktivitetet për përfaqësimin e vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë

Në kuadër të përmbushjes së qëllimit strategjik për nxitjen dhe përfaqësimin e vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave më të mira, për periudhën objekt auditimi 2020-2024 rezulton që të jenë marrë disa nisma si dhe të jenë kryer disa aktivitete si për shembull:

- Pjesëmarrje me pavijone përfaqësuese në Bienalet Ndërkombëtare të Arkitekturës dhe të Artit, në mënyrë të alternuar në edicionet e viteve 2021, 2022, 2024 (Bienale e Artit) dhe 2021, 2023 (Bienale e Arkitekturës);
- Aktivitete të ndryshme në kuadër të ditëve ndërkombëtare të monumenteve të kulturës dhe siteve arkeologjike të diversitetit kulturor apo të ditëve Evropiane të trashëgimisë kulturore;
- Aktivitete në kuadër të thirrjeve të hapura të MEKI-t për projekte në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, janë ndërmarrë një sërë aktivitetsesh të tjera të llojit si:

- Konferenca “Shqipëria – 60 vjet në UNESCO”.
- Ekspozita ikonografike “A Window in Albanian Medieval Art”, në UNESCO, Paris me 21 ikona nga më përfaqësueset e trashëgimisë sonë kulturore kombëtare.
- Botime promocionale në gjuhën angleze, si:
 - o Broshura “Albania 60 years in UNESCO”;
 - o Katalogu i ikonave “A window in the Albanian Medieval Art”
- Aktivitete në kuadër të Ditëve Ndërkombëtare
 - o “Dita ndërkombëtare e monumenteve të kulturës dhe siteve arkeologjike”
 - o “Dita ndërkombëtare e Muzeve”
 - o “Dita ndërkombëtare e Diversitetit Kulturor”
 - o “Ditët Evropiane të Trashëgimisë Kulturore dhe Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore”.

Në qoftë se do t’ju referohemi tipologjisë së aktiviteteve të përmendura më sipër, mund të shikojmë se ato nuk vijnë konkretisht në përmbushje të qëllimit strategjik për përfaqësimin e

¹¹⁵ Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention, fq.27.

¹¹⁶ Ligji nr. 9490, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e konventës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, Paris 2003”, neni 12/1.

vlerave kulturore materiale dhe jomateriale të trashëgimisë kombëtare, në aktivitete ndërkombëtare përjashtuar pjesëmarrjet në bienalet ndërkombëtare.

Lidhur me hartimin e listave të elementëve për përfshirjen e pasurive kombëtare kulturore në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s, sipas konventës së UNESCO-s dhe ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, elementet e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të cilat synohen të përfshihen në listat e UNESCO-s duhet të jenë fillimisht pjesë e Listës Kombëtare të Kryevlerave dhe Regjistrit të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. Propozimet kalojnë në Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale (QKVT) dhe më pas shqyrtohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale.

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, regjistrimi i pasurive kulturore në bazën e të dhënave, është kryer në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të cilat posedojnë objekte pasuri kulturore, ndërmjet plotësimit nga këto institucione të formularëve të aplikimit. “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore” (RKPK) përmban pasuritë kulturore që ruhen nga rrjeti muzeor i vendit, nga galeritë e artit, nga personat privatë, nga institucionet e specializuara vendore e kombëtare dhe nga bashkësitë fetare.

Regjistrimi i pasurive kulturore

Ndër vite në RKPK rezultojnë të regjistruara 484 152 pasuri kulturore të klasifikuara si:

- Trashëgimi Kulturore të luajtshme: 480 804 objekte
- Trashëgimi Kulturore të paluajtshme: 3 348 objekte
- Trashëgimi Kulturore jomateriale: 100 dukuri

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, regjistri duhet të jetë objekt i përditësimit dhe plotësimit të rregullt e të vazhdueshëm nga institucionet e specializuara të fushës. Për vitet 2021-2024 është kryer përditësimi (fotografik/gjendjes fizike /përmasave) për 125 833 objekte. Vetëm për vitin 2024 rezulton që numri total i objekteve të përditësuara në RKPK të jetë 14 369.

Lidhur me Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore rezulton se ende nuk janë marrë masa nga IKTK pasi nuk janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, neni 56 pika 2, neni 286 germa b.

Nga sa trajtuar më sipër rezulton se, Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore është hartuar dhe përditësuar, por nuk janë hartuar listat e përfaqësimit që duhet të rrjedhin nga këto regjistra, pra nuk janë hartuar listat e elementeve, me të cilat mund të kandidohet në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Lidhur me pasuritë kulturore dhe natyrore materiale për t’u regjistruar në Listën Tentative të UNESCO-s, propozimi i fundit që ka bërë vendi ynë ka qenë në vitin 2017 me regjistrimin e Kalasë së Bashtovës. Ndërsa në vitin 2019 me vendimin 43 COM 8B.9, Komiteti i Trashëgimisë Botërore, miratoi zgjerimin e Pronës së Trashëgimisë Botërore “*Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit*” duke përfshirë edhe rajonin shqiptar të Liqenit të Ohrit.

Trashëgimia Kulturore Jomateriale nuk ka Listë Tentative por ka regjistrim në Listat Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit dhe Listat e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Nevojë Urgjente për Ruajtje. Më pas vijon procesi për regjistrim përfundimtar në Listën Botërore të Trashëgimisë Jomateriale.

Kuadri ligjor për trashëgiminë kulturore¹¹⁷ parashikon që me Urdhër të Ministrit të MEKI-t pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, IKTK-së dhe QKVT-së të ngrihet një Komision Këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale. Mënyra e funksionimit të këtij komisioni rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Anëtarët e komisioneve zgjidhen nga lista e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, të krijuar pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së.

Nga auditimi konstatohet se, në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Kulturës, nr. 665, datë 23.10.2023, *“Për miratimin e kriterëve dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale”*, IKTK ka publikuar më datë 05.06.2024, thirrjen për *“Ekspert vlerësues të vlerave kulturore, të pasurive të paluajtshme”*, me qëllim përzgjedhjen e ekspertëve vlerësues të fushës së trashëgimisë kulturore për identifikimin dhe vlerësimin e vlerave kulturore të pasurive kulturore të paluajtshme, në Komisionin e Vlerësimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore.

Deri në nëntor 2024 procesi është në fazën e përzgjedhjes nga Ministri të ekspertëve vlerësues në bazë të parashikimeve të Udhëzimit të Ministrit të Kulturës, nr. 666, datë 23.10.2023, ku pritet të përzgjidhen 5 anëtarë nga lista e përcjellë nga IKTK.

Gjithashtu, referuar udhëzimit të sipërcituar IKRTK ka shpallur thirrjen për listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme më datë 11.06.2024.

Për sa trajtuar më sipër rezulton se, ligji për trashëgiminë kulturore¹¹⁸ **i miratuar më 17.05.2018**, ka parashikuar që disa nga aktet nënligjore për zbatimin e tij **të miratohen brenda 12 muajve** nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, konkretisht Ministri për trashëgiminë kulturore duhet:

- të miratojë udhëzimin për mënyrën e funksionimit të Komisionit Këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe në pasuritë jomateriale;
- të miratojë udhëzimin për kriteret dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, të krijuar pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së.

Rezulton se, Udhëzimi i Ministrit të Kulturës, për miratimin e kriterëve dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale **është miratuar më datë 23.10.2023**, dhe **procesi ka filluar më datë 05.06.2024** me thirrjen për *ekspertë vlerësues të vlerave kulturore, të pasurive të paluajtshme*, dhe deri në muajin nëntor 2024 nuk është mbyllur. Ndërsa lidhur me ekspertët vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme thirrja është **shpallur më datë 11.06.2024** dhe po ashtu ende nuk është mbyllur procesi.

Komisioni Këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, ka për detyrë që të marrë vendime ku të specifikohen ndër të tjera edhe pasuritë kulturore të paluajtshme, të luajtshme, pasuritë kulturore jomateriale me rëndësi universale që të mund të regjistrohen në listat e UNESCO-s.

Rezulton se, është hartuar Regjistri i Vlerave të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, i cili përmban 100 dukuri, por nuk është hartuar lista e elementëve me të cilët mund të kandidohet dhe në bazë të së cilës do të duhet të punohet dosja e kandidimit, në bashkëpunim me ekspertët e fushës.

¹¹⁷ Ligji nr. 27/2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”*, neni 59.

¹¹⁸ Ligji nr. 27/2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”*, neni 258 pika dh, e.

Konkretisht, për periudhën objekt auditimit 2020-2024 Shqipëria ka regjistruar dhe dërguar për regjistrim në UNESCO vlerat si vijon:

- 2022 – “**Xhubleta**” regjistrohet në Listën e Trashëgimisë Botërore Jomateriale;
- 2023 – “**Shtegtimi i bagëtive (Transhumance)**” regjistrohet në Listën e Trashëgimisë Botërore Jomateriale;
- 2023 – “**K’cimi i Tropojës**”, propozuar për regjistrim në Listat Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit, **regjistruar në dhjetor 2024**¹¹⁹;
- 2024 – “**Arti i të luajturit, të kënduarit dhe bërjes së lahutës**”, propozuar për regjistrim në Listat e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Nevojë Urgjente për Ruajtje.

Pra numri i vlerave kulturore jo materiale të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore Jomateriale është 4 (katër), ku 2 (dy) janë të regjistruara (Xhubleta dhe Shtegtimi i bagëtive) dhe 2 (dy) pritet të regjistrohen (K’cimi i Tropojës dhe Arti i të luajturit, të kënduarit dhe bërjes së lahutës). Ndërsa lidhur me pasuritë kulturore dhe kulturore natyrore materiale për periudhën 2020-2024 nuk kemi patur asnjë regjistrim në Listën Tentative si dhe asnjë regjistrim në Listën e Trashëgimisë Botërore. Për pasuritë kulturore dhe kulturore natyrore materiale regjistrimi i fundit në Listën e Trashëgimisë Botërore është bërë në vitin 2019 (Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit) ndërsa në Listën Tentative regjistrimi i fundit është bërë në vitin 2017 (Kalaja e Bashtovës).

Gjetje nga auditimi:

15. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nuk ka informacion lidhur me nivelit e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Kulturën, pasi nuk është bërë monitorimi, si dhe nuk janë hartuar raportet periodike për vlerësimin e zbatimit të objektivave strategjikë. Si rezultat, nuk ka informacione për indikatorët e përcaktuar, për nivelin e realizimit të aktiviteteve të vendosura në planin e veprimit, problematikat që kanë lindur etj. Gjithashtu, nuk është përditësuar as Plani i Veprimit, bazuar në nivelin e zbatimit të masave të përcaktuara.

16. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nuk ka hartuar dhe miratuar ende Udhëzimin për mënyrën e funksionimit të “Komisionit Këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe në pasuritë jomateriale”. Ndërsa Udhëzimi për “Kriteret dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale”, është miratuar në tetor 2023 ndërsa procesi ka filluar në qershor 2024 dhe nuk është mbyllur deri në nëntor 2024. Gjithashtu, nuk është hartuar dhe miratuar Udhëzimi për “Përpilimin e Katalogut Kombëtar të Pasurive Kulturore” në të cilin do të bëhej katalogimi i vlerave kulturore materiale e jomateriale. Udhëzimet e sipërcituara duhej të miratoheshin deri më muajin maj të vitit 2019.

17. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit / Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore nuk ka hartuar “Listën e elementëve” me të cilët mund të kandidohet në Listat e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të UNESCO-s, listë e cila shërben si bazë që në bashkëpunim me ekspertët e fushës të hartohen dosjet e kandidimit. Aktualisht, është hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore vetëm “Regjistri i Vlerave të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, i cili përmban 100 dukuri të regjistruara.

18. Gjetje nga auditimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk ka një listë/regjister të pasurive kulturore dhe natyrore materiale të klasifikuara si të një interesi të jashtëzakonshëm dhe si rezultat të merren masa që të ruhen si pjesë e trashëgimisë botërore. Për periudhën 2020-2024, nuk kemi patur asnjë regjistrim në Listën Tentative si dhe asnjë regjistrim në Listën e Trashëgimisë Botërore. Për pasuritë kulturore dhe kulturore natyrore materiale regjistrimi i fundit në Listën e Trashëgimisë Botërore është bërë në vitin 2019

¹¹⁹ <https://meki.gov.al/>

(Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit) ndërsa në Listën Tentative regjistrimi i fundit është bërë në vitin 2017 (Kalaja e Bashtovës).

Konkluzione:

8. Konkluzion: Për periudhën 2020-2024, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka punuar në drejtim të hartimit dhe të përditësimit të regjistrave kombëtar të pasurive dhe vlerave kulturore të vendit tonë, por duhet të bëhet më shumë për promovimin e vlerave në nivel ndërkombëtar, nëpërmjet përfshirjes së pasurive kombëtare kulturore në listat përfaqësuese të trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Mos miratimi i akteve nënligjore dhe rregullatore ka sjellë pamundësi të marrjes së vendimeve lidhur me pasuritë kulturore të paluajtshme, të luajtshme, pasuritë kulturore jomateriale me rëndësi universale që të mund të regjistrohen në listat e UNESCO-s.

Rekomandime:

15.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, të marrë masat për të kryer një vlerësim të nivelit të realizimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Kulturën dhe në vijim të përditësojë Planin e Veprimit të saj për vitin 2025.

Brenda datës 31.03.2025

16.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të marrë masa për të hartuar udhëzimin për mënyrën e funksionimit të Komisionit Këshillimor, udhëzimin për përpilimin e Katalogut Kombëtar të Pasurive Kulturore, dhe të përfundojë procesin e përzgjedhjes së listës së ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale.

Brenda datës 31.03.2025

17.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit / Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, referuar Regjistrin të Vlerave të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, në bashkëpunim me ekspertët e fushës të hartojë listat e elementëve me të cilët mund të kandidohet në listat e UNESCO-s, dhe bazuar në këto elementë të bëhet një plan për plotësimin e dosjeve të kandidimit me ekspertët e fushës.

Brenda datës 31.06.2025

18.1 Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit referuar Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore të marrë masa për të hartuar listën e pasurive kulturore dhe natyrore materiale, të cilat klasifikohen me një interes të jashtëzakonshëm dhe të nevojshme të ruhen si pjesë e trashëgimisë botërore.

Brenda datës 31.12.2025

6. Anekse

Aneksi nr.1

Projekte të targetuara për Trashëgiminë Kulturore (2020 - 2024)					
Nr.	Emërtimi i Projektit	Viti (Periudha)	Fusha që ka mbuluar projekti	Financuesi	Vlera e financimit
1	Projekti Elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë e Gjirokastrës	2020	Ndërtimi i rrjetit ndriçues të jashtëm të Kalasë Gjirokastër	Ministria e Kulturës	22,239,536
2	Restaurim Kisha Shën Ilias Stegopull	2020	Punime restaurimi dhe shpëtimi	Ministria e Kulturës	7,759,131
3	Rikonstruksion i banesës së "Avni Rustemi" Monument Kulture Kategoria I-rë. (Projekt Interreg)	2020	Punime restaurimi dhe shpëtimi	Projekt INTERREG	5,300,000
4	Restaurimi i Urës Antiko-Mesjetare mbi lumin Vjosë, nën Kalanë e Tepelenës.	2020	Punime restaurimi dhe shpëtimi	Qeveria Shqiptare	39,850,000
5	Rikonstruksion i Urës së Dragotit	2020	Punime restaurimi dhe shpëtimi	Qeveria Shqiptare	9,200,000
6	Rikonstruksion i Urës së Leklit	2020	Punime restaurimi dhe shpëtimi	Qeveria Shqiptare	8,870,000
7	Rikonstruksion banesa "S. M." (Donacion nga komuniteti)	2020	Rikonstruksion dhe rikthim në gjendjen fillestare	Donacion I komunitetit	9,950,000
8	Sistemimi i muzeve Gjirokastër, restaurimi dhe rikonceptimi i Muzeut Etnografik, Muzealizimi i Banesës K., itinerari "Eduart Lir" dhe udhëtarët "itinerari Kronikë në Gur"	2020-2021	Rikonstruksion I Muzeut Etnografi dhe Banesës K., si dhe Rikonstruksion I rrugëve , pjesë e itinerarit të Eduart Lir.	Qeveria Shqiptare	12,924,694
9	Identifikimi, dizenjimi i masave prioritare, për të adresuar shqetësimet urgjente, për sigurinë dhe parandalimin e humbjes së strukturave historike në Kalanë e Gjirokastrës	2021-2022	Ndërhyrje mbrojtëse, restauruese dhe shpëtuese në strukturat e Kalasë Gjirokastër	Qeveria Shqiptare	174,900,930
10	Zhvillimi i integruar urban dhe turistik, Bashkia Përmet	2021-2022	Restaurimi i rrugëve dhe shesheve në Qendrën Historike Përmet	Qeveria Shqiptare	398,547,169
11	Rikualifikim i Odeonit Gjirokastër "Bashtea e Teqesë" Loti parë.	2022	Sistemim i tualeteve dhe ambienteve te skenës te ODEONI	Bashkia Gjirokastër	2,978,985
12	Dizenjimi dhe rivitalizimin e Sheshit "Çerçiz Topulli" dhe parkimin nëntokësor, në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës	2022	Ndërtim I parkimit nëntokësor dhe rindërtim I sheshit Cerciz Topulli	Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare	532,045,934
13	Ndërtimi i By Passit në Qendrën Historike Gjirokastër (Ura e Nanxës - Ura e Madhe e Dunavatit)	2022	Ndërtim I ByPassit të ri	Bashkia Gjirokastër	396,646,812
14	Restaurimi i xhamisë në lagjen Cfake, Gjirokastër	2022	Rikonstruksion total I objektit	Komunitetit mysliman	10,200,000
15	Bonusi i Rijetëzimit - Rikonstruksion banese 2 kate, Lagjia Kala, K. C.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	1,040,945
16	Bonusi i Rijetëzimit - Restaurim banesa e Tarate lagjia Palorto, D. P.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	1,166,281
17	Bonusi i Rijetëzimit - Banesa E. P.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	931,497
18	Bonusi i Rijetëzimit - Rikonstruksion dhe rijetëzim i plote i banesës F. C.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	4,325,000
19	Bonusi i Rijetëzimit - Rijetëzimi i objektit 2 kate dhe bodrum sistemimi jashtëm dhe mur rrethues, H. Sh.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	3,822,046
20	Bonusi i Rijetëzimit - Projekt restaurimi, rrethimi truall i dhe sistemim oborri, ne banesën M. L.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	3,511,653
21	Bonusi i Rijetëzimit - Restaurim dhe rijetësim Banesa B.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	3,698,393
22	Bonusi i Rijetëzimit - Restaurim ne Banesën J. B.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	796,374
23	Bonusi i Rijetëzimit - Projekt restaurimi objekti S. K.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	719,767
24	Bonusi i Rijetëzimit - Projekt restaurimi cati rrase guri + restaurim tavani dekorativ ne banesën B.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	452,415
25	Bonusi i Rijetëzimit - Restaurim ne Banesën A. A.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	4,325,000
26	Bonus Rijetëzimi qendra interaktive, E. K.	2022	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	Ministria e Kulturës	2,429,109
27	Rivitalizimin e Sheshit "Çerçiz Topulli", në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës	2023-2024	Rivitalizim dhe mobilim i Sheshit "Çerçiz Topulli"	Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare	117,858,065
28	Projekti për integrimin urban dhe zhvillimin e turizmit në qytetin e Gjirokastrës - LOT I	2023-2024	Restaurim i disa rrugëve në Qendrën Historike	Banka Botërore	315,377,703
29	Mobiliteti dhe azhurnimi i integruar urban në qytetin e Gjirokastrës - LOT II (Zona Historike)	2023-2024	Restaurim I disa rrugëve në Qendrën Historike	Banka Botërore	306,132,115
30	Rijetëzimi dhe përmirësimi i vlerave në Kalanë Tepelenë	2023-2024	Rikonstruksion i ambienteve të brendshme dhe objekteve në Kalanë Tepelenë.	Qeveria Shqiptare	458,521,135
31	Rikonstruksion i Akueduktit të Bëncës , Tepelenë.	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi dhe shpëtimi	Qeveria Shqiptare	7,352,815
32	Ndërhyrje Restauruese në Kishën e Shën Marisë ne Mingul, Lunxheri Gjirokastër.	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi dhe shpëtimi	MEKI	9,046,320
33	Bonus Rijetëzimi, Nderim catie Sh. Gj.	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	1,000,000
34	Bonus Rijetëzimi, Restaurim banesa e A. Z., Lagje Palorto Gjirkaster	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	676,100
35	Restaurim i pjesshëm/ rijetëzim i objektit 3 Harqet, brenda Qendrës Historike, Gjirkaster	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	5,500,000
36	Bonus Rijetëzimi, Restaurim banese dhe shtese me ndryshim funksioni	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	5,000,000
37	Bonus Rijetëzimi, Bujtina G. Zh.	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	5,000,000

38	Bonus Rijetëzimi, Projekti "Restaurimi I Banesës R. C. (Kategoria II), Partizani, Gjirokastër	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	4,500,000
39	Rikonstruksion/ rijetesim me ndryshim funksioni	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	4,500,000
40	Bonus Rijetëzimi, Restaurimi dhe rikonceptimi i objektit H. V.	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	3,973,198
41	Bonus Rijetëzimi, Restaurim banesa G. L.	2023	Punime mirëmbajtje, restaurimi, shpëtimi dhe rivitalizimi.	MEKI	4,000,000
